



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 3, 4 DHE 11 TETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 3. 4. I 11. OKTOBRA 2012. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2012**

Rendi i ditës

Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Dnevni red

Parlamentarna rasprava, prema zahtevu poslanika Visar Ymeri u vezi sa procesom privatizacije na Kosovu

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë punës.

Sot e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri dhe grupit të deputetëve nënshkrues, lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Gjithashtu, ky debat zhvillohet edhe mbi bazën e petitionit të 64 000 qytetarëve që e kanë nënshkruar, kështu që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione ka kërkuar që të radhitet në rend dite.

Do të thotë, në ndërkohë Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur e ka shqyrtuar petitionin e parashtruar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar që lidhur me këtë çështje të zhvillohet debat.

Pra, i kemi dy kërkesa dhe debati që po e bëjmë sot zhvillohet mbi bazën e këtyre dy kërkesave.

E ftoj deputetin Visar Ymeri, që në emër të Grupit të deputetëve nënshkrues të propozuesit ta marrë fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
E kemi bërë këtë kërkesë për ta diskutuar procesin e privatizimit në përgjithësi në Kosovë, për dy arsye thelbësore.

Një, që ky proces është një prej proceseve që kanë ndodhur pas luftës e që është më i diskutueshmi dhe i cili ka ngrë dyshimet më të mëdha për sa u përket zhvillimeve në të dhe këto dyshime janë ngrë edhe për shkak të mungesës së transparencës së plotë nga ky proces, dhe në anën tjetër për shkak se jemi vazhdimisht duke diskutuar jo vetëm pasojat që i ka sjellë procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, po veçanërisht pasojat të dëmshme për ekonominë e Kosovës, që do t'i sjellë vazhdimi i procesit të privatizimit dhe zgjerimi i tij në ndërmarrjet publike që po e vazhdon aktualisht Qeveria e Kosovës.

Procesi i privatizimit në Kosovë kishte filluar në vitin 2001 me një arsytim të këndshëm për veshin tonë, pra privatizimi - shitja, na shitej atëherë si mundësia e vetme e zhvillimit ekonomik.

Në ligjërimin politik të atëhershëm të UNMIK-ut dhe i IPVQ-ve, theksi natyrisht që vihej te zhvillimi ekonomik, si qëllim, e jo te shtija që atëherë na shitej si mjet. Por me ligjërim, e vërteta e vendimeve politike për privatizimin ishte kthyer me kokë teposhtë.

Sot po e shohim qartë që shitja paska qenë qëllim e premtimi për zhvillimin ekonomik vetëm mjet për ta arsyetuar shitjen.

Në vitin 1999 e pastaj në vitin 2000 dhe deri në vitin 2001, kur fillon privatizimi, të gjitha ndërmarrjet në Kosovë kanë qenë në pronësi shoqërore dhe publike.

Kosova, atëherë kishte ndërmarrjet e veta gati në gjithë sektorët e industrisë, të shërbimeve, bujqësisë, agro-industrisë, minierave, metalurgjisë e tjerë. Sipas një ankete të publikuar nga Instituti "Riinvest", në vitin 2001, pjesa dërrmuese apo 86% e ndërmarrjeve të anketuara ishin aktive. Në vitin 1999 aktive ishin 55 deri në 60%. Aktiviteti ekonomik në vitin 2000, në krahasim me vitin 1999 është dyfishuar. Prodhimtaria e këtyre ndërmarrjeve kryesisht 99% e tyre, është e orientuar në tregun e brendshëm, natyrisht që këto ndërmarrje kishin qenë atëherë seriozisht të dëmtuara gjatë viteve të 90-ta gjatë menaxhimit të dhunshëm, plaçkitjes dhe mos investimit në to, që ishin bërë nga regjimi fashist i Millosheviqit, si dhe gjatë luftës, ku shkatërrimi kishte qenë i qëllimshëm dhe i drejtpërdrejtë.

Mirëpo, në të njëjtin raport të Riinvestit thuhet se këto ndërmarrje kishin filluar të rimëkëmbën. Krahasuar me vitin 1999, në vitin 2000, realizimi në këto ndërmarrje kishte qenë për 2.72% më i madh, që nënkupton se ka pasur rritje të prodhimit dhe rritje të realizimit të hyrave. Ndërkohë, krahasuar me vitin 1988, në vitin 2000, shpenzimet e ndërmarrjeve kishin rënë nga 74% në 46%, sa kishin qenë në vitin 1988, pra në njërën anë ka pasur rritje të prodhimit, në anën tjetër ka pasur zvogëlim të shpenzimeve për këto ndërmarrje, që nënkupton rritje të efikasitetit.

Fitimi në këto ndërmarrje ishte rritur në vitin 2000, krahasuar me vitin 1999, për 3.5%. Kapitali fiks i këtyre ndërmarrjeve atëbotë vlerësohej në 3.5 miliardë marka gjermane, ndërkohë që shkalla e amortizimit vlerësohej të jetë 55 deri 60%.

Në këtë situatë, kur ekonomia e Kosovës vazhdonte të lëngonte nga goditjet e qëllimshme të Serbisë, për ta shkatërruar atë dhe kur e tërë prona ishte shoqërore, përgjigja që vjen nga UNMIK-u ishte privatizimi. Pra, jo rimëkëmbja e ndërmarrjeve, jo ndihma në rritjen e prodhimeve të punësimit, jo mbrojtja e tregut të vendit për prodhuesit e vendit. Përgjigja ishte hapja e tregut për prodhimet e huaja dhe ndalimi i qëllimshëm i rimëkëmbjes së prodhuesve vendorë për t'i dërguar këta në shitje.

Një ekonomi me potencial prodhimi dhe shitjeje të prodhimeve, u shndërrua sakaq në ekonomi që shet vetëm prona shoqërore, nëpërmjet spin off-eve të organizuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Privatizimi është vendim politik. Ai është një prej mjeteve që shtetet e përdorin në raste të caktuara dhe kushte të caktuara, kur vlerësohet se një ndërmarrje do t'i shërbente më shumë mirëqenies po qe se është e privatizuar. Privatizimi asnjëherë nuk mund të jetë mjete i vetëm e aq më pak shënjeshtër kryesor i strukturës ekonomike siç ka ndodhur këtu në Kosovë. Në kohën kur ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës u thuhej se do të privatizohen ato kishin halle tjera. Në anketën e "Riinvestit", të cituar më lart, ndërmarrjet e anketuara flisnin për pengesat fiskale që ata i kishin. Ata kërkonin lehtësira si heqja e doganës në lëndë të parë, vendosja e tarifave doganore për prodhimet finale që vinin nga jashtë, qasje më të madhe në kapital për investime e kështu me radhë. Ndërkohë që pushteti u thoshte se do t'i privatizojnë dhe se kjo ishte zgjidhja për ta. Pra, përgjigja ishte shumë e thjeshtë, shumë e qartë – privatizimi.

Por a ishte vërtet kjo zgjidhja? Shumica e ndërmarrjeve e kanë ndryshuar destinimin ekonomik si pasojë e privatizimit. Potenciali prodhues që kishte Kosova thuaja se është shkatërruar tërësisht, prapë si pasojë e drejtpërdrejtë e privatizimit. Do t'i përmend vetëm disa shembuj, edhe pse këtu nuk mund të përmbliidhen, natyrisht të gjithë. Edhe sot e kësaj dite, dy minierat e magnezitit, një në Kamenicë dhe një në komunën e Lipjanit, janë jo funksionale. Pra, edhe pse janë të privatizuara qysh në vitin 2006 ato vazhdojnë të mos prodhojnë. Të dyja këto miniera nuk kanë përmbushur as 10% të investimeve për të cilat ishin zotuar. Zotimi kishte qenë atë botë se do të punësohen 238 punëtorë, ndërkohë që sot ka shumë pak punëtorë në të, të cilët nuk prodhojnë por vetëm mbahen aty sa për të thënë se janë duke punuar.

Ish-prodhuesi më i madh i tjerres në Kosovë, "Kosova-Teksi", në Prishtinë, tani nuk është duke punuar fare.

Ndërmarrja e vreshtarisë dhe bodrumi i verave "Suhareka" në Suharekë, e privatizuar në vitin 200 , po ashtu, nuk është duke prodhuar fare.

Kemi raste pastaj tjera të spin off-eve speciale, që quhen, siç është për shembull dhe ta zëmë "Feronikeli", i cili në momentin e privatizimit i kishte 2 000 të punësuar, sot i ka 1 000 dhe ata është duke i larguar vazhdimisht nga puna, ndërkohë që i tërë potenciali përfitues që e ka ajo ndërmarrje i shkon sot kapitalit privat që e ka privatizuar atë.

Kemi raste të shumë fabrikave tjera, të cilat sot nuk janë funksionale fare dhe të cilave u është ndryshuar destinimi. Për shembull kemi raste të fabrikave, ku nga fabrika janë shndërruar në godina hoteliere, në depo për deponimin e mallit dhe ka të tilla kur janë rrënuar fare ndërtesat dhe këto objekte janë shndërruar në sheshe ndërtimi, pra është ndërtuar banesa në to, në vend të fabrikës që ka qenë. Dhe e tërë kjo ka rezultuar në një gjendje shumë të rëndë ekonomike për Kosovën e veçanërisht për punëtorët e Kosovës.

Drejtpërdrejt si pasojë e privatizimit, 76 000 punëtorë e kanë humbur vendin e punës. Këta të gjithë janë rrjedhje e asaj që u tha më lartë, pra shkatërrimit të kapaciteteve

prodhuese dhe ndryshimit të destinimit ekonomik të ndërmarrjeve prodhuese, por jo vetëm të tyre.

Të gjitha ndërmarrjet e privatizuara e kanë reduktuar numrin e punëtorëve në minimumin e domosdoshëm, duke rritur kështu eksploatimin e punëtorëve dhe keqpërdorimin dhe shfrytëzimin e këtyre punëtorëve.

E kemi rastin edhe të ndërmarrjeve publike, pra e kemi një rast të ndërmarrjes publike, të dhënë me konsension, siç është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, i cili kur është dhënë me konsension, është trumbetuar se do të jetë mjet i fuqishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, ndërkohë që sot, në të njëjtin aeroport po shohim se për çdo ditë e më shumë jo vetëm që po largohen punëtorët nga puna, por po largohen edhe kompanitë të cilat deri dje kanë afaruar në Kosovë, dhe këto avio-kompani shumë të rëndësishme.

Çmimet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me privatizimin janë rritur për 600% në disa raste. Pra çmimet për operatorë tjerë privat që i përdorin hapësirat e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Pra, ky konsensionim i kryer nga kjo Qeveri e Kosovës, e një ndërmarrjeve publike e cila në momentin kur është privatizuar ose kur është dhënë me konsension, më falni, ka qenë profitabile, sot e ka rënduar tejet shumë ekonominë e Kosovës dhe nuk kemi kurrfarë raporti për të mirat që po i sjell kjo ekonomisë së vendit, e aq më pak buxhetit të vendit, siç është trumbetuar se do të bëhet.

Në vitin 2001, siç e dini, është krijuar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Krijimi i kësaj Agjencie nga UNMIK-u, të pranuar edhe nga politikanët vendorë ka qenë një ndër krimet më të mëdha ekonomike që i ka ndodhur Kosovës, për shkak se e tërë prona e Kosovës, prona shoqërore, fabrikat, tokat bujqësore dhe të gjitha kapacitetet tjera prodhuese, agjentët ekonomikë të Kosovës i janë venë në dispozicion një agjencie e cila ka qenë absolutisht jashtë kontrollit të çfarëdo institucioni vendor. Pra, një agjencie të përbërë nga shumica e anëtarëve të bordit nga ndërkombëtarë, ku ka pasur edhe vendorë, natyrisht dhe e cila i ka pasur vendimet ekskluzive për krejt pronën e Kosovës dhe për shfrytëzimin e asaj prone, destinimin e asaj prone, shitjen apo mos shitjen e asaj prone. Dhe, siç e dini të gjithë, edhe pse kjo flitet publikisht, por natyrisht zyrtarisht nuk është pranuar kurrë, ka qenë pikërisht kjo Agjenci Kosovare e Mirëbesimit, e cila jo vetëm që nuk i ka ndihmuar ndërmarrjet shoqërore që të rimëkëmbën, por në disa raste ka intervenuar drejtpërsëdrejti për ta ndaluar rimëkëmbjen e këtyre ndërmarrjeve nga punëtorët. Kemi raste të shumta ku vetë punëtorët janë kthyer në vendin e punës dhe kanë filluar t'i gjallërojnë ndërmarrjet e tyre me punën vullnetare të tyre. Dhe çfarë ka bërë, me krijimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e tërë kjo punë është ndërprerë, punëtorëve u është ndaluar të punojnë, punëtorëve u është ndaluar të prodhojnë, për shkak se përgjigja ka qenë shumë e qartë: ne do të ju privatizojmë. Pra, qëllimi i AKM-së ka qenë ta shkatërrojë pronën që ta shesë sa më lirë, jo ta zhvillojë ekonominë e vendit që pastaj ndoshta edhe do të vendoset të privatizohet, por do të privatizohet nëpërmjet një procesi që do t'i shërbente të mirës së përgjithshme e jo nëpërmjet një procesi që i shërben të mirës partikulare të politikanëve të kësaj në të.

Po çka ndodh pastaj? Në vitin 2008, pra pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, e cila na thoshte se tash jemi vend sovran dhe do t'i marrim vendimet vetë, çfarë bëjmë me procesin e privatizimit? Jo vetëm që nuk e hap një proces të hetimit dhe të rishikimit të procesit të privatizimit, por e vazhdon me avazin e njëjtë aty ku e kishte lënë AKM-ja, e vazhdon me AKP-n që vazhdon të privatizojë dhe e nisë një proces tjetër të privatizimit, të pronës publike, që e zhvillon Qeveria e Kosovës. Pra, në vend të hapjes së pistave të hetimit për atë se çka kishte ndodhur në procesin e privatizimit, hapen pista të reja të privatizimit.

Dhe, tash jemi në momentin kur po kërcënohet e tërë prona publike që të privatizohet nga kjo Qeveri. Pra, po kërcënohet të privatizohet rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike, po kërcënohet të privatizohet Posta dhe Telekom i Kosovës, në fakt vetëm Telekom i Kosovës, pra profiti dhe po kërcënohet të privatizohet apo të likuidohet edhe "Trepça", proces ky që është duke u mbikëqyrur dhe vazhduar nga AKP-ja.

Natyrisht se të jesh kundër këtij privatizimi dhe të jesh kundër privatizimit të pronës publike, nuk nënkupton automatikisht që të jesh kundër sektorit privat dhe Lëvizja Vetëvendosje e mbështet sektorin privat dhe mendon që sektori privat është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në zhvillimin e vendit.

Pra, kur thuhet që jemi për tregun e lirë, një treg ku agjentët e ndryshëm tregtarë kanë mundësi të hyjnë dhe afarojnë të lirë nga Qeveria, kjo nuk nënkupton që duhet të jemi automatikisht edhe për lirinë e tregut, pra një treg i cili është i lirë që të na hyjë në të gjitha ato shërbime ekskluzive që duhet të jenë dhe të domosdoshme për jetën e qytetarit.

Prandaj, prona publike është po aq e rëndësishme dhe po aq e shenjtë sa edhe prona private dhe për ta ndihmuar sektorin privat në Kosovë, siç e përmenda edhe momentin në vitin 2000, nevojat e sektorit privat në Kosovë sot janë të njëjta me ato që i kanë pasur atëherë. Pra, u duhet lehtësira fiskale, u duhen mbrojtje të tregut dhe u duhen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para se të filloj të flas për procesin e reformës strukturale ekonomike për ndërmarrjet publike dhe në përgjithësi për tërë sektorin, dua të bëj një dallim dhe një njoftim për deputetët dhe për publikun se në kërkesën e cila i ka shkruar Kryesisë për debat, është bërë kërkesë për procesin e privatizimit. Dhe, unë e kam njoftuar Kuvendin që për procesin e privatizimit që ka të bëjë me AKM-në dhe AKP-në, e cila është shndërruar në vitin 2008, duhet ta thërrasin AKP-në dhe Kuvendi është organi më i lartë i cili merret me

këtë proces. Prandaj, në këtë kontekst unë nuk do të flas as për AKM-në, as për AKP-në, sepse vendi i cili duhet të debatohet dhe është dashur të thirret këtu AKP-ja për të diskutuar për këto procese.

Unë mund të flas për politikat qeveritare, të cilat mundësojnë një zhvillim ekonomik, si filozofi ekonomike, si koncept ekonomik dhe normalisht Qeveria e Kosovës është e përkushtuar konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në harmoni me vizionin e vet të qëndrueshëm ekonomik për zhvillimin, për reformë strukturale, për funksionalizim të ekonomisë së tregut, për fuqizim të sektorit privat, për vendosje të normave të larta profesionale dhe institucionale të cilat janë në funksion të rritjes ekonomike dhe ky zhvillim i qëndrueshëm, të nderuar deputetë, nënkupton në vete jo vetëm zhvillimin ekonomik, por edhe kohezionin socio-ekonomik dhe atë të ruajtjes së ambientit. Ky është koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Qeveria e Kosovës është shumë e përkushtuar për të vazhduar me reformën edhe në sektorin energjetik, edhe në sektorin e telekomunikacionit dhe në sektorë tjerë të cilat janë pjesë e drejtpërdrejtë e funksionimit të obligimeve qeveritare, sepse ne besojmë fuqishëm që kjo reformë dhe funksionimi i shtetit shkon në drejtim të krijimit të parakushteve të cilat duhet t'i ketë sektori privat. Në asnjë rrethanë në ekonomi të tregut nuk është sektori i shtetit i cili e bën ekonominë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe është bartës i zhvillimit ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Zhvillimin ekonomik e bën sektori privat. Zhvillimi ekonomik duhet të përkrahet nga shteti në politika të mira, me infrastrukturë dhe me proces të vazhdueshëm të funksionimit të rendit dhe ligjit dhe kjo është detyrë. Këto punë nuk mund t'i bëjë sektori privat, këto punë i bën shteti dhe këto punë ne jemi përcaktuar për t'i bërë.

Prandaj, kur flasim për reformë strukturale, parimi i transtransparencës, konkurrentshmërisë, trajtimit të barabartë të gjitha kompanive, diskutimi i hapur me të gjithë aktorët, pavarësisht se nganjëherë po pretendohet të thuhet që nuk ka pasur debate publike dhe dialog, janë angazhime konkrete të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat kanë bërë punë profesionale, valorizim maksimal të resurseve njerëzore dhe natyrore të Republikës së Kosovës dhe normalisht eliminon të gjitha ato veprime të cilat kanë bërë që ekonomia e Kosovës të jetë në këtë fazë.

Pra, edhe një herë them, nuk flas për AKM-në e AKP-në dhe të nderuar deputetë, është dashur edhe një herë ta themi konform kërkesës sonë, këtu AKP-në për të folur për ato procese, sepse këtë proces nuk e ka nisur kjo Qeveri. Këtë proces e ka nisur Kuvendi më herët dhe dihen konstilacionet politike çfarë kanë qenë dhe këtë AKM-ja e ka transformuar në vitin 2008, ky Kuvend në AKP dhe para disa ditësh ky Kuvend, do të thotë që para disa muajsh, do të thotë, ka aprovuar edhe ligje të reja për AKP-në, të cilat e kanë funksionalizuar dhe kanë mundësuar funksionimin e këtyre sektorëve.

Nëse flasim për transparencë gjatë procesit, sepse shpesh është diskutuar, të nderuar, dua të bëj një definicion të transparencës. Transparenca është gatishmëri dhe obligim

shtetëror i një qeverie për të ndarë informacionin ndaj institucioneve, por është njëkohësisht gatishmëri për të marrë dhe për të kuptuar atë informacion dhe për të pasur qasje të drejtpërdrejtë lidhur me këto.

Pra, këto procese të cilat janë në vijim, sepse ende nuk kemi privatizuar asgjë nga asetet publike, jemi në proces të privatizimit, dhe besoj se jemi duke bërë me transparencën maksimale, me angazhim të plotë të shoqërisë civile të profesionistëve, të sindikatave dhe ka një pjesëmarrje jashtëzakonisht të gjerë dhe nëse flasim tani për, edhe një herë t'i kthehemi ekonomisë së tregut, ne në asnjë rrethanë të nderuar deputetë, nuk besojmë që sektori privat është shkatërruesi i shtetit. Absolutisht, në asnjë rrethanë, se është sektori i kriminalizuar, i cili po pretendohet gjatë këtyre ditëve të tregohet si i tillë.

Ky sektor punëson më shumë se 80% të punonjësve të Republikës së Kosovës. Ky sektor është kontribuuesi më i fuqishëm në buxhetin e Kosovës, buxhet i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë krijon mundësinë e pagave për të gjithë punëtorët tanë, mundësinë e ndërtimit të shkollave të reja, të universiteteve të reja, të infrastrukturës, e cila po i bën qytetarët tanë të denjë në mënyrë të drejtpërdrejtë të jenë aspirues për Bashkimin Evropian.

Ne si pjesëmarrës aktivë edhe të zhvillimeve historike dhe politike duhet të jemi racionalë në paraqitjen e realitetit ekonomik pas luftës dhe të qartësojmë përfundimisht se nuk është privatizimi ai që e ka shkatërruar dhe po e shkatërron ekonominë e vendit. Kosova është shkatërruar ekonomikisht nga politika okupuese dhe shkatërruese serbe dhe nga lidhja e ekonomisë së Kosovës në atë kohë me politikën e Serbisë dhe me politikën e gabuara të zhvillimit ekonomik.

Në vitet e '90-ta, kur Kosova ishte pjesë e ekonomisë së planifikuar të ish-Jugosllavisë, asnjë ndërmarrje shoqërore nuk është menaxhuar në bazë të parimit ekonomik. Të gjitha ndërmarrjet shoqërore dhe publike për dhjetë vjet të tëra janë keq menaxhuar, janë shkatërruar gjatë luftës, kanë humbur tregjet dhe ato kanë nevojë për kapital të freskët.

Por, edhe në atë kohë, do të thotë, pa përkrahje institucionale, hapat e parë drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut i bëri sektori privat, i cili në atë kohë financonte në mënyrë të drejtpërdrejt të gjitha institucionet paralele të cilat janë ndërtuar në atë kohë, për drejtim, për krijimin e një ambienti më të mirë më të qartë, më perspektiv për vendin tonë.

Dhe, unë jam i bindur, shumë i bindur se të gjithë ata njerëz të cilët nuk e përkrahin ekonominë e tregut, të cilët propagandojnë ekonomi të planifikuar dhe të centralizuar, të gjithë ata të cilët fatkeqësisht po pengojnë ardhjen e investitorëve të huaj, të gjithë ata të cilët po dezinformojnë popullin dhe po bëjnë fushatë politike, këtë po e bëjnë në dëm të zhvillimit ekonomik, në dëm të qytetarëve të vendit, në dëm të mirëqenies së tyre, në dëm të ardhmërisë së fëmijëve tanë dhe janë fatkeqësisht në anën e gabuar edhe politike, edhe ekonomike.

Dhe, dua të prezantoj, sepse shumë shpesh, paraqiten raste të ndryshme të transformimeve të suksesshme dhe ne si për dëshirë e kemi rastin e Sllovenisë, ku thuhet

se Sllovenia ka qenë rast i suksesshëm, i mbajtjes së pronës publike, Greqia apo vende tjera.

Të nderuar, sot Sllovenia është vendi i gjashtë i Bashkimit Evropian, i cili sipas të gjitha gjasave do të kërkojë ndihmën financiare për të eliminuar falimentimin dhe është kjo një sektor i madh publik. Ekonomia e Greqisë po shkatërrohet për shkak të një super sektori publik, dhe dua t'ua përkujtoj, vetëm të kthehemi edhe një herë tek kostoja të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës do ta paguajnë për shkak të orientimeve dhe politikave të gabuara ekonomike.

Paramendoni Gjermaninë Lindore, e cila ka paguar shumë herë më shumë se sa Plani Marshall për shkak të politikave të gabuara ekonomike, sepse është dashur që të paguajnë taksa edhe sot e kësaj dite qytetarët për shkak të politikave të gabuara ekonomike.

Kjo është një dëshmi e fuqishme që qytetarët e Kosovës besojnë dhe Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për të krijuar bazë të mirëfilltë ligjore, profesionale, institucionale, pa miopi ekonomike për të shikuar të ardhmen e vendit dhe për të mos ardhur asnjëherë në orientimet e ish-Jugosllavisë, sepse asnjë qytetar i Republikës së Kosovës nuk ka kujtime të mira për ish-Jugosllavinë dhe për dijeninë tuaj, të nderuar deputetë, kemi pengesa për ta penguar këtë proces të reformës strukturale dhe këto pengesa nuk vijnë nga brenda, vetëm nga brenda por vijnë edhe nga jashtë. Për informimin tuaj e kemi edhe një letër nga Aleksandër Vulin, i cili bën ftesë për ta ndërprerë procesin e privatizimit dhe ka pretendime të drejtpërdrejta mbi ekonominë e Kosovës dhe mendoj se këto gjëra duhet të trajtohen në veçanti.

Dhe, për fund, më lejoni sepse u përmend këtu edhe mocioni, edhe iniciativa e BSPK-së për peticion. Fillimisht, ky peticion nuk është i konfirmuar dhe e dyta që e kam thënë disa herë deri më tani publikisht, është folur për privatizim të “Trepçës”. Unë nuk e di, kur BSPK-ja ose një institucion tjetër vendor ka folur për privatizimin e “Trepçës”. Dhe për më shumë, dhe me qenë edhe më tutje injoranca më e madhe është se BSPK-ja është e ulur në Bordin e AKP-ës e cila është përgjegjëse për “Trepçën”, prandaj nëse ata duan të dinë diçka, është dashur që ta dinë këtë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë Visar, a? Po i keni diskutimet më vonë, por edhe s'prish punë për mua! Po, shfrytëzoje të drejtën për replikë, por shkurt. Urdhëro, Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Së pari, ministri i bëri disa shpifje për atë që e thash unë dhe për qëndrimin dhe për qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” në përgjithësi. Pra, tha që e konsiderojmë sektorin privat si të kriminalizuar. Kurrë s'e kemi thënë këtë gjë, as kurrë nuk mendojmë ashtu. Pra, këto shpifje tregojnë që vërtet ministri ka diçka të fshehur, për shkak se po të kishte pasur të drejtë dhe po të ishte i bindur se ka të drejtë në punën e tij, atëherë do të na prezantonte fakte, nuk do të shpifte.

Çështja tjetër është që tha se Qeveria nuk merret me procesin e privatizimit të AKP-së. Natyrisht se nuk ka qenë drejtpërdrejt Qeveria, as kjo, po asnjë qeveri drejtpërdrejt e përfshirë në AKP. Mirëpo, ky është një proces, një realitet që ka ndodhur në Kosovë dhe natyrisht se Qeveria e Kosovës duhet të ketë qëndrim për këtë punë. Pra, natyrisht se Qeveria e Kosovës duhet ta ketë dijen dhe informatën se çfarë ka ndodhur dhe çfarë do të bëjë kjo si Qeveri për ta mëkëmbur ekonominë e Kosovës, për shkak se po flasim për ekonominë e Kosovës. Nuk është kjo që është privatizuar një ndërmarrje diku jashtë Kosovës.

Pra, Qeveria, edhe nëse s'ka qenë në pushtet në momentin kur ka ndodhur një gjë, e merr përgjegjësinë për shkak se është vazhdimësi e një qeverie.

Çështja tjetër është se ministri tha që në asnjë rrethanë nuk është sektori i shtetit që e bënë ekonominë. Kjo është absolutisht e pavërtetë. Nëse i shikoni vendet e ndryshme nëpër botë, ka në disa më shumë në disa më pak, po ka prani të institucioneve apo ndërmarrjeve publike në thuaja se të gjitha vendet që quhen kapitaliste.

Dhe, e përmendi që kriza në Slloveni po na vijka për shkak të sektorit publik. Mirë, ministër! E kam unë vetëm një pyetje të thjeshtë për ty, meqenëse je ekonomist. A e din ti ku ia ka nisur kriza e fundit financiare? A e di ti që ia ka nisur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ia ka nisur në bankat private, ministër? A e di ti këtë?

Prandaj, mos e fajëso sektorin publik për krizën për shkak se nuk është e vërtetë. Dhe secili njeri, edhe duke mos qenë ekonomist, për shkak se aq shumë është shkruar për këtë punë, e din që në fakt kriza filloi te sektori privat. Kjo prapë nuk e bën sektorin privat të kriminalizuar, mirëpo mënyra si e rregullon ti sektorin privat është shumë e rëndësishme për ekonominë e vendit.

Dhe, një gjë, për fund, se ju iu referuat peticionit të BSPK-së. Nuk e paskeni lexuar tekstin e peticionit. Askund në tekstin e peticionit nuk thuhet privatizim i "Trepçës". Thuhet likuidim i "Trepçës" dhe peticioni është edhe kundër likuidimit të Trepçës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet, Ymeri! Është e vërtetë që ka shembuj të ekonomive ku shteti e luan rolin kryesor, por ato ekonomi sot fatkeqësisht për orientimet tuaja edhe politike edhe ekonomike po bien për çdo ditë. Është rasti i Kubës dhe i shumë vendeve të tjera të cilat realisht e kanë një orientim të tillë, ndërsa sa i përket shembullit, mendoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë shembulli kryesor i zhvillimit ekonomik në botë dhe i zhvillimeve të sektorëve më të fuqishme në këtë drejtim. Prandaj, do të ishte joprofesionale dhe sigurisht nuk e di nga ju a ka dikush ekonomist të mirëfilltë të cilët flasin, si dhe po flasin për filozofinë apolitike dhe nuk po flasin për kosto dhe debat politik afatshkurtër, por po flasin për një të ardhme, me synime afatgjate, për një

vizion ekonomik, prandaj sigurisht ne do të ishim shumë mirënjohës nëse kemi nga ana e juaj veprime dhe propozime pozitive të cilat mund të avancojnë. Por, për tu kthyer në sistemin nacional, nacionalizim të ekonomisë, për tu kthyer në sistemin centralist dhe të planifikuar, sigurisht se kjo Qeveri nuk është e interesuar dhe nuk do të jetë asnjëherë në këtë drejtim e interesuar për të biseduar as për të vazhduar, sepse është një proces i cili e çon drejt shkatërrimit vendin, e çon në një proces i cili njerëzit tanë kanë kujtime të këqija për sistemin socialist dhe për punën e cila është bërë në ato ndërmarrje.

Dhe, po ju lutem edhe një herë për informatën tuaj, sepse thatë pengesa e pengesa, rolin e sindikatave. Unë po ju them që le ta thotë Sindikata dhe thoni ju nëse keni dëgjuar edhe për procesin e likuidimit. Mendoj se këtu ka nevojë për kuptim nga ana juaj çka është procesi i likuidimit të ndërmarrjet publike dhe të ndërmarrjeve shoqërore, për të cilën këtu kemi njerëz edhe nga Bordi i AKP-ës që mund ta shpjegojnë më mirë, por e besoj se do të ketë nevojë për një trajtim shumë profesional, shumë të qartë dhe orientime të cilat janë drejt të ardhmes, jo orientime në të kaluar, ne jemi shkëputur nga mentaliteti i kaluar dhe do të shkojmë në mentalitete tjera.

Dhe, për fund, ndoshta për ta....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë vetëm po ju njoftoj edhe një herë, se në rend dite e kemi procesin e privatizimit në Kosovë. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të dashur,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, prej kohësh i ka bërë të qarta qëndrimet e veta dhe përcaktimin e qartë e të drejtë për ekonominë e lirë të tregut.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, gjithnjë ka shprehur gatishmërinë për të debatuar për çdo çështje në mënyrë korrekte e të sigurtë që vlerësohet dhe shkon në dobi të zhvillimit të vendit, të stabilitetit ekonomik dhe politik të vendit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mirëpret çdo debat i cili i kontribuon zhvillimeve pozitive në vend, në veçanti zhvillimit ekonomik.

Besojmë shumë se sot ky debat do të qartësojë pozicionet tona karshi ekonomisë së lirë të tregut të përcaktuara me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës.

Privatizimi për të cilin ne sot do të diskutojmë, si proces nuk ka filluar as nuk do të përfundojë me këtë qeveri. Ky është proces i vazhdueshëm, i cili determinohet nga ekonomia e lirë e tregut dhe zhvillimet tjera nacionale dhe globale.

Në kapitalizëm çdo gjë varet nga tregu. Çmimi i mallit përcaktohet nga sasia, cilësia dhe nga kërkesat e shitësit dhe të blerësit. Kjo është arsyeja e kapitalizmit që quhet ekonomi e tregut. Andaj, ne fuqishëm jemi përcaktuar për ekonomi të tregut, duke anashkaluar apo duke injoruar fuqishëm mentalitetin e kooperativave, siç ishte në të kaluarën, i cili po tentohet të instalohet përsëri në Kosovë.

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se pa depërtimin e kapitalit të freskët nga jashtë, pa investitorë seriozë, të cilëve duhet t'u krijohen kushte joshëse dhe kurrsesi të frikësohen, ekonomia jonë nuk mund të rimëkëmbet.

Kjo praktikë duhet të na shqetësojë të gjithë neve, përfshirë edhe ata që bëjnë përpjekje për ta penguar procesin e privatizimit dhe investimet të cilat krijojnë vende të reja pune, të cilat janë më se të domosdoshme në këtë fazë nëpër të cilën po kalon vendi ynë.

Ne kemi pasur probleme të vazhdueshme në rrafshin politik sa i përket privatizimit.

Të nderuar deputetë, ju e dini se Serbia ka lobuar dhe po lobon pa ndërprerë që privatizimi të mos ndodhë në Kosovë, aq më pak nga institucionet e pavarura të Kosovës.

Kjo çështje ka qenë objekt diskutimi në Uashington, në Bruksel dhe në qendrat tjera botërore të vendimmarrjes. Por, natyrisht, se qasja jonë pozitive karshi interesave nacionale ka rezultuar fituese ndaj të gjithë atyre që kishin qëllim dëmtimin e ekonomisë sonë dhe nëpërmjet kësaj pengimin e proceseve demokratike, dëmtimin e shtet-ndërtimit dhe zhvillimit ekonomik.

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës për ekonomi të lirë të tregut, bazuar në vendimet e këtij Kuvendi, si dhe bazuar në ligjet për ndërmarrjet publike, procesi i privatizimit është zhvilluar me transparencë dhe në bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare. Në këtë proces kanë qenë të përfshirë të gjitha grupet e interesit, përfshirë shoqërinë civile, institucionet vendore, ndërkombëtare, investitorët dhe punëtorët. Edhe Qeveria ka bërë përpjekje që të sigurojë transparencë të plotë ndaj të gjitha këtyre grupeve. Kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për korrigjime.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë ne e dimë se si është ndërtuar dhe çfarë rrjedhe ka pasur procesi i privatizimit. Agjencioni Kosovar për Privatizim, procesi i privatizimit i cili ishte nën udhëheqjen e Shtyllës së Katërt të UNMIK-ut, pjesë e së cilës ishin edhe ministrat e qeverive të kaluara, duhet të analizohet drejt duke lënë anash politikat ditore.

Më lejoni të ju kujtoj se Agjencia Kosovare e Privatizimit, themelohet si pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, si një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë të ligjit të Kuvendit të Kosovës, numër 04/L-034, mbi AKP-n. Ky ligj e bën të qartë se AKP ka zotësi të plotë juridike për të marrë, mbajtur ose shitur pronën si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen e tërësisë së detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

Kuvendi i Kosovës, pas krijimit të këtij mekanizmi, ka aprovuar strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, pastaj i ka dhënë dritën jeshile Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së dhe asetet e tjera, që të heqë ndikimin e pushtetit nga pasuria publike. Kjo qasje jona, padyshim se duhet vlerësuar, për dallim nga ata që kërkojnë që pasuria publike të futet nën ndikimin e shtetit.

Strategjia e energjisë, e miratuar në këtë Kuvend, konfirmon se Qeveria e Republikës së Kosovës, është e përkushtuar për privatizimin e asetëve publike duke respektuar vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare bashkërisht kanë udhëhequr këtë proces, duke e vlerësuar si proces të mirë dhe të domosdoshëm.

Kemi argumente të mjaftueshme se gjithmonë se vendimet janë marrë në praninë e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtar, të cilët kanë qenë të pranishëm në çdo takim zyrtar, siç kanë qenë Banka Botërore, ICO, Komisioni Evropian, USAID, ndërsa ato vendore KEK-u, Zyra e Rregullatorit, KOST-i dhe të gjithë e kanë vlerësuar si proces transparent.

Grupi Parlamentar i PDK-së beson se të gjitha grupet e interesit, ashtu edhe grupet parlamentare në Kuvend, të cilat e dëshirojnë zhvillimin ekonomik të vendit, duhet ta mbështesin procesin e privatizimit në mënyrë që t'i japin kurajë investitorëve të huaj, që kanë synim të investojnë në vendin tonë. Duke qenë të vetëdijshëm se asgjë në këtë botë nuk është e përkryer, ne kërkojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shtojë kontrollin dhe të kërkojë llogaridhënie edhe më të madhe nga AKP-ja, e cila është organ i pavarur publik i themeluar po nga ky Kuvend.

Ne duhet t'ua bëjmë me dije të gjithëve, si politikës në Beograd, që dërgojnë letra të vazhdueshme në instancat relevante vendimmarrëse ndërkombëtare, që kërkojnë të ndërpritet ky proces, kërcënojnë investitorët serioz të mundshëm, se ky proces nuk mund të ndalet. Ky është synimi dhe përcaktimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, i bazuar në ekonominë e lirë të tregut dhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik.

Kosova është vend demokratik dhe aspiron të integrohet në Bashkimin Evropian, prandaj Grupi Parlamentar i PDK-së do ta mbështesë edhe në të ardhmen procesin e privatizimit, të bindur se është në interes të forcimit të shtetit të Kosovës, ne duhet t'ua bëjmë me dije të gjithë kundërshtarëve të procesit të privatizimit se shteti ynë funksionon mbi parimet demokratike duke respektuar ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës.

Ne jemi të vetëdijshëm se çdo proces ka sfidat e tij dhe çdo proces mund të rishikohet në kohë të përshtatshme, duke mos rrezikuar për asnjë moment vendimet dhe proceset e rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe politik të vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahaqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: I nderuar kryetar,

Qeveri,

Të respektuar kolegë deputetë,

Sot kemi debat lidhur me procesin e privatizimit të Kosovës dhe ishte interesant të dëgjohet ministri i cili thotë se nuk ka lidhje Qeveria me procesin e privatizimit, nuk ka lidhje me AKP-në, nuk ka lidhje me AKM-në. Ndoshta nuk e dinë edhe që ekziston Komisioni Qeveritar i Privatizimit të Postës, e tjera. Dhe e pamë kujdesin apo brengën për çështjen e Sllovenisë, e mendoj se është mirë që ne të kujdesemi për Kosovën e ta lëmë Slloveninë në atë rrugën e mirë të cilën e ka, e ishalla do të jemi në rrugë të Sllovenisë edhe ne shpejt.

Sa i përket procesit të privatizimit, mendoj që ai si proces është i njohur në shumë vende të botës dhe si i tillë ka sjell konkurrencë, motivim dhe zhvillim ekonomik në vendet tjera, në shtetet të cilat kanë zhvilluar një privatizim të planifikuar mirë, në kuadër të strategjive zhvillimore dhe me interes të vendit të tyre.

Ne, si shumë vendet që ishin nën ndikimin socialist, të sistemit socialist në Kosovë, kemi kaluar në një sistem prej sistemit të ekonomisë së planifikuar, të pronës së përbashkët në një ekonomi të tregut. Dhe ky kalim, normal se nuk ka qenë i lehtë, ka qenë i përcjell me një mori të problemeve shtesë dhe dështimit të sistemit të udhëheqjes së ekonomisë socialiste.

Për dallim prej tjerave, sistemi ynë ka qenë i ngarkuar edhe me probleme shtesë, si masat e dhunshme, bashkimit me letra me ndërmarrje të Serbisë, të cilat sot e kësaj dite po shkaktjnë probleme, të cilat edhe u përmendën.

Ne në LDK besojmë se iniciativa private, se konkurrenca dhe tregu i hapur janë forcat kryesore që sigurojnë prosperitetin ekonomik dhe në parim ne e përkrahim privatizimin, pasi besojmë se iniciativa private, motivimi, dinamika e shndërrojnë një ndërmarrje në ndërmarrje aktive të aftë për t'u përballur më lehtë me vështirësitë dhe më dinamike në përshtatje të kërkesave të kohës. Megjithatë, zhvillimi ekonomik është i qëndrueshëm, nëse resurset shfrytëzohen racionalist dhe nëse nga e gjithë kjo përfiton zhvillimi ekonomik i vendit.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore tani mund të konsiderohet si një proces gati i përfunduar. Ne mund të analizojmë efektin e këtij privatizimi, të marrim masa që ndërmarrjet publike të cilat janë në fazë të përgatitjes për privatizim, të mos përcillen më me mangësi dhe me pengesa sikur ndërmarrjet shoqërore deri më sot.

Dua t'i përmend vetëm ndërmarrjet e Gjakovës, të cilat patën eksportuar 100 milionë dollarë në vit, kur dikur ishin bartëse të zhvillimit ekonomik të Kosovës, e sot e kësaj dite mbeten të paaktivizuara, të pafunksionalizuara, duke shkaktuar dëm jo vetëm ekonomisë së Gjakovës, por tërë Kosovës.

Nëse analizojmë rezultatet të cilat dolën prej privatizimit, i cili ishte dashur të paramendohet si iniciues i zhvillimit ekonomik dhe si krijues i vendeve të punës, në fakt

ne jo që kemi më tepër vende të punës, por kemi diku nja 70 000 të pa punë. Pa marrë parasysh luftën, mendoj se nuk duhet të analizojmë më dhe të kthehemi në luftë dhe në pengesa tjera, sepse jemi 13 vjet larg. Dhe mungesa e strategjisë zhvillimore dhe sot e kësaj dite ka ndikuar në mungesën e koordinimit për ekonomi lidhur me privatizimin.

Ne jemi të vetëdijshëm se sistemi i vjetër i pronësisë dhe menaxhimit është punë e kryer dhe jemi në një fazë të re, por gjithashtu mendojmë se ky proces do të mund të ishte i menduar më mirë dhe të sjellë rezultate më të favorshme dhe të nxitë zhvillimin ekonomik.

Në fillim të këtij mandati, ne si Kuvend e pranuar Projektligjin për buxhet i cili pati privatizimin e PTK-së të inkorporuar brenda. LDK-ja në atë kohë propozoi amendamentin me të cilin kërkohet heqja e PTK-së nga projektligji për buxhet dhe marrjen me të në mënyrë të pavarur. Deputetët e pozitës ishin ata të cilët votuan pro dhe Posta shkoi në pako. Sot, secili prej nesh kemi edhe ankesa prej sindikatës, edhe ankesa të shumta të cilat vijnë prej punëtorëve të Postës dhe prej sektorëve tjerë.

Gjatë amendamentimit të pakos së ligjeve për AKP-në, Odën e Veçantë dhe ndërmarrjet e caktuara, pjesëtarët tanë në komisione, kërkuan që fondet e mbledhura nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, të përdoren për të nxitur projektet për zhvillimin ekonomik, duke u aprovuar paraprakisht nga Kuvendi i Kosovës. Dhe kjo, ende nuk ndodhi.

Ne patëm kërkuar që “Trepça” si ndërmarrje e interesit të veçantë të ketë një ligj special për të, e jo të trajtohet së bashku me ndërmarrjet tjera.

Ne, në LDK mendojmë se privatizimi i ndërmarrjeve publike, nëse nuk është planifikuar mirë, nëse nuk është në funksion të zhvillimit ekonomik, nëse nuk ka plan të kujdesit ndaj punëtorëve, atëherë më mirë të mos privatizohet në këtë kohë se të shkaktohen dëme të pariparueshme më vonë.

Rasti i procesit të privatizimit të Distribucionit ishte rast, ta themi, interesant, ku çmimi i ofruar për tërë infrastrukturën e Distribucionit, me 450 000 konsumatorë, 33 trafo të mëdha prej 35... kilovotëshe, 7 000 trafo tjera, 21 000 kilometra përçues nëpër krejt Kosovën, toka e tjera, do të shiten për 26 milionë. Po të ishte shitur vetëm ndërtesa e administratës në qendër të Prishtinës, me siguri do të ishin marrë më tepër para prej privatizimit.

Sot të gjithë kemi, gjithashtu peticione dhe kërkesa prej këtyre dy ndërmarrjeve në kutitë tona si deputetë.

Në mungesë së strategjisë së zhvillimit ekonomik, i cili edhe do të ishte udhërrëfyes për privatizim, nuk mendoj për atë power point-in e Banjskos, por po mendoj për me të vërtetë një strategji zhvillimore, e cila do të kishte qenë udhërrëfuese për privatizim dhe për ristrukturim të ekonomisë, këto dy gjëra kanë shkuar të pa organizuara dhe në mënyrë stihie.

Nëse sot analizojmë procesin e privatizimit dhe të rezultateve konkrete, mund të themi se kjo nuk i ka përmbushur pritjet tona dhe me kujdes të veçantë do të duhej t'i qasemi privatizimit të ndërmarrjeve publike për t'i evituar pasojat negative të privatizimit.

Dhe, ne si LDK, kemi këto rekomandime:

1. LDK-ja si parti e qendrës së djathtë e përkrah në parim privatizimin si proces.
2. LDK-ja kërkon të rishikohet privatizimi i disa aseteve kryesore publike që ka Kosova.
3. Privatizimi i PTK-së të sillet në Kuvendin e Kosovës për aprovim së bashku me një strategji lidhur me këtë privatizim, e cila strategji definojnë interesat e Republikës së Kosovës në këtë aset publik dhe mënyrën se si do të përdoren mjetet nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje publike.
4. Të rishikohet strategjia energjetike e Republikës së Kosovës, nga Qeveria dhe të sillet në Kuvendin e Kosovës, për aprovim, e cila duhet t'i definojë interesat e Kosovës në këtë sektor.
5. Të shtyhet privatizimi i Kosovës B, i ndërtimit të Kosovës së Re, dhe privatizimi i Distribucionit deri pas aprovimit të strategjisë energjetike të Republikës së Kosovës nga ana e Kuvendit të Kosovës.
6. Të përgatitet një strategji nacionale nga Qeveria dhe të sillet për aprovim në Kuvendin e Kosovës lidhur me shfrytëzimin e mjeteve të mbledhura nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në kuadër të Agjencisë të Privatizimit të Kosovës, si dhe mjetet nga privatizimi i ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYETAR: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Ministër, thonë, sulmi është mbrojtja më e mirë dhe ne po e kuptojmë se je nervoz, sepse kështu e ke bërë punën.

Në fjalën tuaj, përmendët disa fjalë kyçe. Thatë, racional, transparencë, kapital i freskët dhe treg i lirë, ndërkaq veprimet e Qeverisë janë të tilla që bien në kundërshtim me çdo fjalë që ju e thatë në Kuvend.

Në fakt, nga ajo çka kemi parë dhe dëgjuar deri sot në debatet publike, e edhe në Kuvend, i kemi dy ekstreme rreth procesit të privatizimit. Ekstremi i parë është Qeveria e cila e ka shfrytëzuar nëpërmjet një paradigme të çuditshme ekonomike, të cilën veç këta mund ta kuptojnë - privatizimin si mjet për t'u pasuruar vetë, e jo si mjet për të arritur një qëllim,

që në rrethanat e tjera do të ishte mjet për thithjen e kapitalit privat, zhvillimin e biznesit, uljen e papunësisë, futjen e konkurrencës në treg dhe demonopolizimin.

Siç ka ndodhur, për shembull, unë po i jap raste të mira, ministër, në Britaninë e Madhe, në vitet e '70-ta, në Zvicër, në Luksemburg ose në një vend që po ashtu kaloi tranzicioni njëjtë si Kosova, Estonia, që sot është fuqi ekonomike në rritje në Bashkimin Evropian dhe kemi një qëndrim tjetër ekstrem që kundërshton dhe demonizon privatizimin si koncept.

Më lejoni të them që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka qëndrim tjetër që dallon nga këto dy qëndrime. Është kundër të parit, sepse s'ka të bëjë me privatizim, por privatizimi është shfrytëzuar për keqpërdorim, për korrupsion dhe kriminalitet nga Qeveria. Dhe kundër qëndrimit të dytë, sepse konsiderojmë se potenciali zhvillimor mund të vijë vetëm nga investimet private dhe konkurrenca e lirë, por jo nga paratë e taksapaguesve, sepse jemi të bindur që Qeverinë duhet ta kemi për mbrojtje të biznesit, për krijimin e kushteve dhe politikave më të mira për biznes, ndërkaq biznesi e bën vetë biznesi.

Atë çfarë kemi parë deri më sot në procesin e privatizimit në Kosovë, ndërsa shumëçka do të mbetet dhe do të shihet në të ardhmen, sepse transparenca ka qenë zero dhe vetëm disa skandale të fundit tregojnë se ku jemi me këtë proces, tregon që transformimi i ndërmarrjeve publike në këtë proces, nga fillimi në mbarim e shfrytëzuan në esencë për keqpërdorim, zhvlerësim të pronës për shkak të pazareve, një shitje të ndërmarrjeve matrapazëve të cilët nuk i zhvilluan këto, por përkundrazi i rrjepën dhe punëtorët i lanë në rrugë.

Kemi parë një proces i cili do të instalojë monopolin si në rastin e KEK-ut dhe kjo është krejt në kundërshtim me atë çka ju po promovoni, e që quhet treg i lirë, ku qytetari i Kosovës do të jetë i vetmi qytetar në Evropë të cilit nuk do t'i jepet mundësia të zgjedhë operatorin. Kjo qasje e Qeverisë është në kundërshtim me parimin bazë të privatizimit dhe liberalizimit të tregut.

Që ky debat të mos mbetet në nivelin e akuzave dhe pas shumë ngjarjeve të rënda të cilat e kanë përcjellë këtë proces, mendoj që deri në sqarimin e shumë paqartësive, ku ka shumë punë hetuesia dhe po e theksoj edhe një herë që edhe në rastin e fundit, në rastin e privatizimit të KEK-ut, po e ritheksoj hetimin që po ndodh ndaj këshilltarit të transaksionit nga ombudspersoni i korporatës ndërkombëtare financiare, tash paramendoni nëse IFC ka bazë për hetim ndaj punonjësit të vet, sigurisht se Kuvendi duhet automatikisht të kërkojë që ky proces të ndërpritet deri në dhënien e sqarimeve, deri në kuptimin dhe përfundimin e këtij rezultati dhe hetimeve të tjera të cilat lidhen me privatizim.

Do të thotë, në momentin në të cilin po bëhet fjalë, privatizimi degradues në Kosovë duhet të ndalet deri në fuqizimin e shtetit ligjor dhe si qëndron shteti ligjor dhe si qëndron ky proces, e dimë edhe në raportin e fundit të Ombudspersonit, të cilin e ka parë ky Kuvend, që do të mundësonte një privatizim tjetër nga ai që kemi pa deri më sot. Pra, si i tillë duhet të ndërpritet menjëherë, në të kundërtën, ne do të përfundojmë me falje e me

investitorë që për qëllim nuk kanë qëndrimin afatgjatë dhe zhvillim, por kanë qëllim marrjen dhe ikjen sa më të shpejtë të pasurisë së vendit gjatë transformimit nga sektori publik në atë privat.

Duhet që të gjendet domosdoshmëria e pasjes së tregjeve konkurrenciale, post-privatizuese dhe në gjetjen e kohës së përshtatshme për privatizim. Ky privatizim si i tillë duhet të ndërpritet sepse në momentin kur po ndodh sot, keq menaxhimi i ndërmarrjeve kosovare, ku shumë ka pasur dorë politika, bën që këto ndërmarrje të mos duken aspak atraktive për investitorët e huaj dhe rrjedhimisht i bën më pak të kushtueshme. Para vazhimit të çdo privatizimi të ndërmarrjeve duhet të bëhet modifikimi i tyre, pastrimi nga anomalitë, vlerësimi real, caktimi i një pragu minimal e më pas shitja, pra privatizimi.

Asnjëherë në këtë Kuvend nuk e kemi sjell, ose Qeveria nuk e ka sjellë një propozim, një platformë ku kemi pasur një prag minimal të vlerës së këtyre ndërmarrjeve.

180 milionë janë investuar në rrjetin e energjisë nga viti 1999 deri në vitin 2011. Do të thotë 180 milionë në një ndërmarrje, e cila edhe me ton të shitet rreth 20 milionë. Kjo është për keqardhje.

Pastaj, privatizimi sot ndodh në rrethana të vështirësuara në Kosovë, për faktin se Kosova nuk e ka siguruar një ambient atraktiv për investitorë, në tërësi. Për më tepër, sinjalet e prodhuara jashtë kanë qenë trishtuese.

Dhe, në fund, po e përmbyll me faktorin njeri. Gjatë këtij procesi, në 99% të rasteve, punëtorët kanë mbetur në rrugë, sepse nuk kemi pasur privatizim të suksesshëm dhe jo rastësisht sot kemi mbi 66 mijë nënshkrime kundër privatizimit.

Pastaj, sikur edhe në shumë rrethana të tjera, lista e punëtorëve apo përfituesve të 20-përqindëshit është rritur në vazhdimësi dhe këtë përvojë e kemi parë edhe në listat tjera, meqë njerëzit po vuajnë.

Jo me punëtorët e ndërmarrjeve, të cilëve u janë vonuar mjetet dhe të cilat ende presin t'i marrin, por me individë, të cilët kanë lidhje me politikën dhe janë futur në listë për të përfituar.

Se cila do të jetë e ardhmëria e njerëzve dhe punëtorëve e dimë nga e kaluara. Sskush sot nuk merret me ata të cilët janë përjashtuar nga puna në "Ferronikel". Qeverisë nuk i intereson se çfarë ka ndodhur me të gjitha ndërmarrjet e dështuara dhe me punëtorët, të cilët kanë mbetur rrugëve, por në fakt ka filluar edhe ta bëjë pastrimin. Kryeministri shkoi, e unë e pata një pyetje për të.

Në këtë proces, i cili veç po shihet që e ka marrë rrugën e vet dhe drejtimin shumë të gabuar në Korporatën Energjetike të Kosovës dje janë pezulluar nga puna 16 veteranë. Në shtetet demokratike dhe normale, shteti dhe Qeveria investojnë dhe provojnë t'i rehabilitojnë veteranët dhe invalidët e luftës nëpërmjet ndihmave, qoftë sociale, qoftë të

tjera. Çfarë po ndodh në Kosovë? Pikërisht në Deçan janë 16 veteranë, prej tyre 10 janë drejtpërdrejt ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe veteranë, 5 janë familje të dëshmorëve dhe i 6-ti invalid i luftës, mezi që punon. Që të gjithë ata janë larguar nga puna, janë pezulluar, në kundërshtim me të gjitha ligjet, sepse janë futur në grevë. Ne e dimë që ky Kuvend e ka sjellë Ligjin për grevat dhe e dimë që punëtorët kanë të drejtë të hyjnë në grevë, kurse menaxhmenti shumë i politizuar, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me kryeministrin, që nuk po do t'i dëgjojë këto pyetje, por po ikën, merr vendim t'i largojë dhe t'i përjashtojë nga puna këta veteranë dhe invalidë të luftës. Prandaj, dua të pyes: A janë ata aty veç kur duhet të bëjnë fushatë dhe të votojnë për ju, apo duhet pasur kujdes edhe në momentet kur këta njerëz, janë në marrëdhënie pune dhe të rehabilituar, e të përjashtohen nga puna. Kjo është për keqardhje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh debatin i cili është ofruar sot nga një grup i deputetëve për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe të ndërmarrjeve publike, mund të them se ai është i mirëseardhur, duke pasur parasysh se Kuvendi i Kosovës është vendi ku duhet të debatohet për çështje të rëndësishme të shtetit.

Në rast se e shohim si grup parlamentar çështjen e programit qeveritar në të cilën gjendet AKR-ja, mund të themi se AKR-ja është për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe të ndërmarrjeve publike, proces i cili duhet të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe duhet të ketë llogaridhënie edhe për deputetët dhe për qytetarët, meqë duhet të bëhet maksimalisht valorizimi i interesave të qytetarëve të Kosovës dhe njëkohësisht duhet ruajtur edhe investitorin, i cili duhet të vijë në Kosovë që të investojë.

Në rast se nisemi nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, mund të themi se shteti i Kosovës është për ekonomi të lirë të tregut dhe për konkurrencë dhe duke u bazuar në ligjet, të cilat i kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës, mund të themi se jemi për ekonomi të lirë të tregut dhe për hyrjen e investimeve private në shtetin tonë.

Që ta kemi një debat të mirëfilltë si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe duke i marrë parasysh kërkesat e sindikalistëve, të cilët u janë drejtuar grupeve parlamentare, e kryetari tregoi që është marrë një material prej tyre, mund të them se shteti i Kosovës dhe Qeveria janë në dijeni si do të shkojë procesi i privatizimit, ku duhet të rishqyrtohet procesi i privatizimit në rast se ka dështuar, ose në rast se ka nuk ka shkuar mirë, po prapëseprapë mund të themi se pa hyrjen e investitorëve të huaj Kosova nuk do të ketë zhvillim ekonomik. Esenca e zhvillimit ekonomik të Kosovës është nga investimet private, e jo nga buxheti i Kosovës, sepse ai është mjaftë i varfër.

Çështja esenciale për Kosovën, në fazën në të cilën gjendet, është zbatimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik. Se si do të ndodhë procesi i zhvillimit ekonomik të vendit, këtë e

theksoi edhe ministri Beqaj, ndoshta jo në aspekt të gjerë, çfarë është dashur, për shkak kohë të kohës.

Në rast se nisemi nga sektori më i rëndësishëm, meqë ndoshta duhet të kemi zhvillim sekondar ekonomik, është sektori i energjisë. Dhe, u theksua këtu se duhet të draftohet strategjia e energjisë, mirëpo duhet të kemi kujdes se në bazë të Ligjit të energjisë, ajo ridraftohet çdo tre vjet dhe e kemi mundësinë edhe si Komision, dhe si deputetë, të bëjmë plotësim-ndryshimin e saj.

Ndërkaq për “Kosova B” është thënë njaft mirë se do të dalë prej pakos së Termocentralit “Kosova e Re”, dhe esenca është ku e kemi atë fat ta kemi një investitor për të në këtë krizë financiare globale, e cila e ka përfshirë gjithë Evropën.

Ndërsa çështje tjetër që duhet ta theksoj është privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, e mund të themi se privatizimi i tyre ka filluar në kohën e UNMIK-ut, ka filluar me qëllim që të ketë zhvillim ekonomik, mirëpo është vërejtur se procesi diku-diku ka çaluar dhe nuk ka qenë aq i mirë për arsye se ka ndodhur me Rregullore të UNMIK-ut, e jo me ligjet çfarë sot mund t’i kemi, pas pavarësisë së Kosovës.

Apeloj edhe një herë, edhe te deputetët, edhe te Qeveria, të kemi një konsensus për çështjen e privatizimit dhe investitorët të cilët hyjnë në Kosovë, për arsye se edhe ne jemi pjesë e qytetarëve të Kosovës dhe në rast se arrihet kjo nga të gjitha subjektet politike për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve publike, atëherë mund të themi se nuk do të kemi krizë sociale, as nuk do të kemi protesta të qytetarëve, të cilët aludojnë se ne jemi duke e shkatërruar pronën publike, e cila, është kompetencë, në bazë të Kushtetutës që jep drejtpërdrejt në menaxhim të Qeverisë, në bazë të ligjeve, të cilat i ka Kuvendi i Kosovës.

Shpresoj dhe besoj shumë që ministrat që i kemi të pranishëm, së bashku me kryeministrin, me komisionet ndërministrorë për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve publike të jenë në favor të interesave të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nga SLS-ja nuk ka të lajmëruar. Nga “6+”, gjithashtu nuk ka të lajmëruar. Ministër, para se të ta jap fjalën, më duhet t’i them pak fjalë edhe unë.

A i duhet privatizimi Kosovës?

Përgjigjja më e shkurtër do të ishte PO e madhe. Por, si? Kjo është çështja që kërkon një përgjigje nga ne sot.

Tanimë nga të gjithë pranohet se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, hapja e vendeve të reja të punës dhe rritja e mirëqenies për qytetarët, varet në radhë të parë nga zbatimi i politikave dhe reformave adekuate ekonomike dhe strukturore, të cilat do të siguronin shfrytëzimin optimal e racional të resurseve natyrore të kapaciteteve njerëzore që i ka Kosova.

Privatizimi do të duhej të ishte në shërbim të zhvillimit ekonomik. Kjo deri sot nuk ka ndodhur. E kjo do të thotë se privatizimi është bërë keq, bile edhe tepër keq.

Ristrukturimi i sektorit të energjisë, zhvillimi i resurseve minerare dhe modernizimi i industrisë së përpunimit mineral ishik kushte dhe parametra të domosdoshëm për t'i joshur investimet private dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese.

Domosdoshmërisht, për të qenë i suksesshëm procesi i privatizimit do të duhej të përcillej nga:

- Strategjia e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, që nuk e ka,
- Definimi i interesit nacional, që nuk e ka bërë,
- Infrastrukturë komplete ligjore, e përpunuar me kujdes,
- Një reformë qeveritare e përpunuar mirë e me kujdes për tërheqjen e investimeve të jashtme e të brendshme,
- Vendosija e procedurave të drejta, të thjeshta, transparente dhe të përgjegjshme,
- Hulumtimi i përvojave dhe i modeleve të privatizimit nga vendet e tjera, të cilat do të korrespondojnë me kompleksitetin e sektorëve përkatës dhe kërkesat për transformimin e aseteve të tyre,
- Debati cilësor dhe gjithëpërfshirës, i cili do të kontribuonte në arritjen e një konsensusi bazik ndërmjet aktorëve kyç të ndërlidhur me këtë çështje,
- Një Bord Kombëtar i Privatizimit, i përbërë nga njerëz me integritet të lartë, njerëz që nuk u nënshtrohen sekserëve të gjithëfuqishëm,
- Politika fiskale në shërbim të investimeve dhe të investitorëve pa përjashtim, por jo politika të korruptueshme fiskale, siç ka ndodhur deri më tani.

Procesi i privatizimit në Kosovë është përcjellë me dobësi të mëdha, e nuk ka pasur mundësi të ndodhë ndryshe. Problemi është pse pas 17 shkurtit 2008 nuk është bërë asnjë përpjekje serioze për ta ndryshuar këtë proces?

Pse pas 17 shkurtit nuk ka pasur asnjë përpjekje serioze për t'i ngritur kapacitetet qeverisëse e administrative të vendit? Pse nuk ka pasur vullnet për të qeverisur me njerëz që ndiejnë përgjegjësi për të qeverisur mirë e në shërbim të publikut? Pse ka pasur gatishtëri për të qeverisur me njerëz, kur edhe njeriu më i prapambetur i Kosovës e ka ditur se e kanë keqpërdorur trashëparanë publike edhe kur ishik nën firmën e LDK-së, në qeveritë e para e të pasluftës çlirimtare? Përgjegjësia për këtë kryekëput është e të gjitha kabineteve qeveritare të pasluftës, të cilët kanë përzgjedhur njerëz që ishik e janë pjesë e kriminit të organizuar ekonomik.

Standardi i njerëzve të zgjedhur e të emëruar në institucionet më të larta të shtetit është nën çdo nivel. Dikush mund të thotë se kështu është vepruar prej fillimit. Pajtohem, por kjo nuk është ndonjë arsye për arsyetim, për heshtje dhe nënshtrim.

Ne tani, pas rastit të hotelit “Grand”, po e dimë se ka pasur ose kanë qenë sekserë, apo sekserët, që kanë kërkuar miliona. Po, kush është “bossi” i kësaj gjurulldie? Dikush tani mund ta akuzojë të ndjerin Dino Asanaj, por ai nuk ka qenë aq i fortë, ai nuk ka pasur asnjë bodiguard. Ai zor të ketë qenë “bossi”. Kush është “bossi” i vërtetë, këtë duhet ta tregojnë hetuesia, Prokuroria dhe gjyqësia. Po a kemi dhe çfarë hetuesie kemi? A kemi hetuesi të besueshme? A kemi Prokurori të besueshme? Për fat të keq, as gjyqësi të besueshme nuk kemi.

Kemi shpresuar se EULEX-i do ta ketë një cilësi të shtuar në sistemin e drejtësisë, por ai tani po e torturon opinionin, nëse mund të themi se kemi opinion, me kriminelë e psikopatë të ndryshëm. Ata miq po thirren në standarde, ne po thirremi në vlerat evropiane në 24 orë në ditë. Zhvillimet, jo vetëm të fundit, po tregojmë se të gjithë, vendorë e ndërkombëtarë, jemi shndërruar në mashtrues të mëdhenj, që vështirë të përsëriten në shekullin tonë.

Ky popull ka njerëz që meritojnë, që dinë e guxojnë të qeverisin më mirë me këtë vend, që dinë të qeverisin me pasurinë publike, se ky popull e ka krijuar me sakrifica të mëdha këtë vend. Po shihet se muskujt nuk dinë të qeverisin, por nuk u mohohet fakti se dinë të grabitin. Ky vend e ky popull është grabitur, është plaçkitur, është persekutuar, është vrarë e dëbuar mjaft nga pushtuesit në të kaluarën. Ky popull, perspektivën e tij duhet ta shohë në Kosovë, e jo në ikje e sipër. Ky popull duhet të qeverisë me pasuritë e tij, tokësore e nëntokësore, me pasurinë njerëzore të tij.

Deri sot, ata që kanë qeverisur në këtë vend nuk janë dëshmuar se dinë ta qeverisin këtë vend dhe këtë popull. I kemi parë se dinë të pasurohen jashtëligjshëm, kanë ndërtuar kulla e pallate prej hiçgjëje, kanë bërë firma ndërtimi e shumëçka tjetër dhe askush nuk ua ka prishur tymin e duhanit, por vazhdojnë të mbeten perspektiva e qeverisjes së këtij vendi. E kjo është më e tmerrshmja që mund t’i ndodhë këtij vendi.

Para 100 vjetëve, Ismail Qemali thoshte: “Ne duhet t’i tregojmë Evropës se shqiptarët kanë mbetur evropiane në gjak dhe nuk dëshirojnë tjetër, veçse të qytetërohen”. Dhe vazhdonte: “Nëse Shqipëria nuk do të jetë si shtet perëndimor, nuk do të mbahet sot në këmbë në Gadishullin Ballkanik” dhe ne nuk mund të bëhemi shtet në Ballkan dhe në Evropë me këtë nivel të sundimit të rendit dhe të ligjit në Kosovë.

Ne duhet t’u tregojmë, në rend të parë qytetarëve tanë, se dimë t’i integrojmë në familjen evropiane, se aty është interesi ynë si komb. Për të qenë aty duhet ta respektojmë e ta mbrojmë Kushtetutën dhe ligjet që i kemi miratuar dhe jemi zotuar se do t’i zbatojmë, se nuk duhet mashtruar as veten, e as tjetrin, se populli thotë “hamami nuk nxehet me fjalë, por do dru”. Dhe, kosovarët nuk mund të jetojnë me imazh të mirë nëse, dikush mund t’ua japë atë, se imazhin nuk e ha ky popull.

Ne jemi përcaktuar për ekonominë e lirë të tregut. Jemi përcaktuar edhe për privatizimin që e kemi filluar keq që në kohën e UNMIK-ut, por që tani duhet ta ndryshojmë, ta përparojmë, ta bëjmë më transparent, e në interes të publikut, jo të individit. I kemi do pasuri që nuk duhet t'i privatizojmë, si "Ferronikelin", ku janë bërë një sërë gabimesh. Në këtë rast, do t'i përmend disa:

A po e zbaton Kosova modelin e duhur të privatizimit?

Kjo pyetje do përgjigje, që unë nuk mund ta jap, por do t'i them disa gjëra.

E di që do të paguhen njerëzit që të flasin kundër këtij diskutimi se gjoja po i frikësojmë investitorët e jashtëm. Unë nuk po flas që t'i frikësojmë investitorët, por mafinë vendore dhe ndërkombëtare të deritashme. Po, ata duhet të frikësohen. Jo nga unë, as nga diskutimi im, por nga ligji. Nëse jo nga ligji, dikush duhet të frikësohet edhe nga Zoti.

Privatizimi në sektorin minerar pati filluar me "Ferronikelin", i cili, pas "Trepçës", ishte gjeneratori më i madh i eksportit në vend. Qëllimet kryesore të inicimit të këtij privatizimi kanë qenë: tërheqja e investitorëve strategjikë për zhvillimin e resurseve të "Ferronikelit", duke përfshirë implementimin e një programi zhvillimor, i cili do të reflektonte me shfrytëzimin racional të pasurive, gjenerim të vendeve të reja të punës dhe hapjen e tregut për kapitalin privat. Çka fitoi Buxheti i Kosovës nga ai privatizim? Le të përgjigjen ekspertët për këtë.

Procesi i shitjes së asetëve është mbështetur nga:

- rregullorja për qeverisje dhe operacionet e AKM-së,
- rregullorja mbi qeverisjen e përdorimit të tokës,
- rregullorja mbi Odën Speciale në Gjykatës Supreme,
- politikat operacionale të AKM-së, dhe
- rregullat e tenderimit dhe procedurat.

Sipas trendëve aktualë të kërkesës së nikelit në industrinë botërore dhe dinamikës së eksploatimit të kapaciteteve të "Ferronikelit" të Drenasit pritet që të ketë rrjedhë të parasë deri në 120 milionë euro në vit, e që përfaqëson diku 10% të GDP-së së Kosovës, duke e renditur kështu si "xhevahir i kurorës mbretërore" nga spektri i ndërmarrjeve shoqërore.

Nga kjo ndërmarrje fitimprurëse, Drenica po thith, kryesisht, helm. Kuadrot më të mira janë jashtë tij. Dyshoj se dihet pronari i vërtetë.

Sikur procesi të përcillej sipas objektivave të vëna, do të quhej një "storie e suksesshme", por për të gjykuar lidhur më këtë, më lejoni të ju rikujtoj vetëm disa nga mangësitë dhe shkeljet që e kanë përcjellë privatizimin e "Ferronikelit":

1. Procesi i privatizimit është mbështetur nga një kornizë ligjore me kompetencë të pamjaftueshme ligjore, mostransparencë totale, shkelje e rregullave të tenderimit, prishje e parimeve të konkurrencës dhe barazisë për ofertuesit (përmes privilegjimit të kompanive të caktuara nga zyrtarët e lartë të AKM-së), privatizimi me vetëm një

ofertues. Asnjë djerrinë prej 5 hektarëve nuk lejohet të shitet pa tre ofertues. Pse kjo u lejua për “Ferronikelin”?

2. Mungesa e një debati cilësor dhe skemës së iniciativës investive, koha e pamjaftueshme për hulumtimin e potencialeve, sfidave dhe tregut, ka dekurajuar kompani të fuqishme që të aplikojnë në këtë proces të privatizimit.

3. Vendosja e kushtit për eksperiencën 10-vjeçare në industrinë ekstraktive e ka vendosur në raporte diskriminuese komunitetin e biznesit vendor, si dhe shumë kompani tjera nga sektori privat.

4. Në kohën kur do të duhej të përfundonte lista e asetëve, zoti Adams, drejtor i Departamentit të Privatizimit të AKM-së, ka suspenduar gjithë menaxhmentin e kompanisë, duke e bllokuar konceptin e reformave organizative të kompanisë, prioritet e riaktivizimit të asetëve dhe të punëtorëve dhe programin e likuidimit.

5. Qasja e menaxhmentit grek sipas modelit “me përimtime të lehta dhe të shpejta” e ka prishur konceptin e riaktivizimit të asetëve konform praktikave të mira ndërkombëtare, që do të mundësonin shfrytëzimin racional të burimeve dhe energjisë, informatizimin e proceseve afariste, procesin e transformimit tekniko-teknologjik, procesin e reformave sociale dhe ndihmave tjera teknike.

6. Emërimi i zyrtarëve të AKM-së, në pozitat menaxhuese të kompanisë së re, si zoti Arten Bajrush, të cilët kanë qenë aktivisht të angazhuar në përgatitjen e procesit të shitjes së kompanisë, përveçqë është konsideruar konflikt interesi, njëkohësisht ka ngjallë dyshimet për transformim jolegal të asetëve të kompania e re. Është fjala për asetet, të cilat nuk kanë qenë në listën e asetëve për privatizim.

7. Vonesa prej 360 ditësh e nënshkrimit të marrëveshjes së zotimeve dhe kontratës së shitjes, si dhe marrëveshjes së furnizimit me energji nga KEK-u, është e kundërligjshme dhe e ka dëmtuar rëndë Buxhetin e Kosovës.

8. Menaxhmenti i kompanisë së re ka zhdukur pjesë shumë të rëndësishme të arkivit, e për pasojë ka ngecur procesi i likuidimit dhe vlerësimit të stoqeve të kompanisë së vjetër.

Me gjithë këto brenga, procesi është quajtur “storie e suksesshme”, edhe pse:

Nuk na është faktuar mbi efektet e privatizimit në zhvillimin ekonomik, ose së paku pse nuk u përmbushën ato që quheshin "kushte të panegocueshme" të kontratës, si: implementimi i një programi 5-vjeçar, ringjallja me detaje për qasje përpunuese, afatet kohore për kompensim të projekteve investive, niveli i të hyrave për prodhim për këto afate kohore, numri i të punësuarve (aty aktualisht punojnë mbi 800 punëtorë, që është nën minimumin e kërkuar prej 1 000 sish), obligimet për ambient etj.

Në kompaninë “Ferronikeli”, gjatë vitit 2009 janë thyer rekordet e eksploatimit dhe të përpunimit. Nëse merret parasysh sasia e xehes së importuar, gjatë këtij viti janë

përpunuar mbi 1 milion ton xehe e lagët, sipas skemës tekniko-teknologjike, e cila nuk është kompatible me qasjen e re të përpunimit dhe të eksploatimit të mineraleve. Koeficienti i shfrytëzimit të nikelit është ende larg kërkesave teknike për shfrytëzimin racional të resurseve dhe energjisë.

Investimet simbolike në projektet mjedisore dhe mungesa e programeve për menaxhim të mbetjeve industriale dhe rehabilitim të tokave të kontaminuara i ka kompromentuar autoritetet kompetente për mbikëqyrje dhe gjithë procesin e përpunimit. Nëse nuk mund të korrigjohen këto që i ceka, së paku të mos ecim në të njëjtën udhë për këto pasuri që presin të privatizohen.

Shumë privatizime deri më sot kanë dëshmuar se janë bërë keq, por rasti i hotelit “Grand” tregon se interesimi i krimit të organizuar për Postën, KEK-un dhe “Trepçën” do të jetë shumëfish më i madh dhe mund t’i kalojë kufijtë e Kosovës. Tani ne, Kuvendi, duhet të kërkojmë ndihmë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Evropian që të na ndihmojnë në ndërprerjen e privatizimit derisa ta forcojmë sundimin e ligjit. Se mungesa e ligjeve të mira, ekzistimi i liderëve mbi ligjin, së bashku me krimin e organizuar, janë argumente të fuqishme se privatizimi nuk po bëhet për të mirën e publikut. Për kë tani nuk është e qartë se privatizimi nuk duhet të ndodhë? Për kë? E vërtetë tani është se privatizimi mund të shkojë siç ka shkuar deri më tani. Privatizimi duhet t’i lihet Kuvendit, me dy të tretat e shumicës shqiptare, por jo me çfarëdo shumice prej dy të tretave. Me kusht që deputetët të jenë pa kalkulatorë në xhepa, nëse vijnë me kalkulatorë si përfaqësues të popullit, më mirë të mos na lënë. Përndryshe, pasuria e Kosovës do të bëhet “rrush e kumbulla”. Kosova nuk është Amerikë, e as nuk e ka sundimin e ligjit siç e kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk e ka asnjë mundësi administrative që ta përcjellë privatizimin.

Kjo praktikë, të nderuar deputetë, sido që kemi ardhur deri këtu, duhet dhe na obligon të mendojmë më shumë për nipat tonë, se për fëmijët po shihet që s’po mendojmë, se ata gjyshërit i duan ndoshta më shumë.

Përveç kësaj, jemi betuar se do të punojmë për interesat e vendit e të popullit. Këtë e kemi bërë në seancën inauguruese. Lexojeni betimin e deputetit edhe një herë dhe do të bindeni se duhet të frikësohemi.

Në popull ka ekzistuar një bindje se ata që e shkelin betimin apo fjalën e dhënë u shuhet vatra. Prandaj, duhet frikësuar për të ardhmen e pasardhësve tuaj.

Kjo legjislaturë ka dalë nga zgjedhjet e vjedhura. Institucionet kanë dalë nga ato zgjedhje dhe si të tilla nuk e kanë legjitimitetin e plotë për ta privatizuar pasurinë publike. Prandaj, nuk e kanë as të drejtën për ta privatizuar interesin më vital të kombit. Ne jemi të obliguar që qytetarëve tanë t’ua kthejmë besimin në institucione, për të cilat kanë sakrifikuar shumë, dhe besimin në përfaqësimin tonë, nëse nuk dëshirojmë të bëhemi vrasës të ardhmërisë e të demokracisë në Kosovë.

Ne jemi të obliguar ta mbrojmë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në Republikën e Kosovës. Edhe rruga 100-vjeçare që kemi kapërcyer na obligon për një gjë të tillë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryetar,

Sigurisht se, edhe një herë dua të jua përkujtoj, vendimet për privatizim në Republikën e Kosovës merren nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sigurisht që të gjitha rregulloret dhe ligjet me të cilat ky proces vazhdon të implementohet janë vendime të këtij Kuvendi. Unë e kam për obligim që të ju njoftoj për procesin e distribucionit, sepse u përmendën shifra dhe orientime të shitjes së tij, nganjëherë të painformuar mirë rreth rrjedhave dhe strukturës, besa edhe duke bërë krahasime, të cilat nuk janë me vend në kontestin e zhvillimeve ekonomike.

Po ju informoj se struktura, e cila është në pritje për të nënshkruar, është konform vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Janë garantuar të gjitha kontratat e punëtorëve për 3 vjet për ata të cilët kanë pasur kontrata një deri në 6 muaj. Kontratat e përhershme të punonjësve të distribucionit janë të mbrojtura me Ligjin e punës. Pra, kontratat afatshkurtra, të cilat kanë qenë aty, janë të garantuara për 3 vjet.

Kosova, të nderuar deputetë dhe qytetarë, nuk i ka shitur asetet 110-kilovoltëshe, për dallim prej të gjitha vendeve të rajonit.

Shumë shpesh po flitet, në krahasim me Malin e Zi. Dua të ju them se Mali i Zi ka bërë ofertim për shitje të sektorit energjetik, e sektori energjetik dallon shumë prej distribucionit. Pra, e ka bërë ofertën, e ka hedhur në treg prodhimin, distribucionin dhe transmisionin, dhe nuk mund të bëhet ai krahasim me privatizimin, i cili është në proces për distribucionin.

Dhe, të gjitha ato asete 110-kilovoltëshe janë pjesë e KOST-it. KOST-i është ndërmarrje publike, e cila do të mbetet për shumë vite si ndërmarrje e tillë.

Investimet të cilat janë paraparë në këtë kontratë janë 300 milionë euro dhe po ju them, sepse shumë shpesh po bëhen krahasime edhe me Shqipërinë, edhe me Maqedoninë. Ju lutem, hyni dhe analizojeni strukturën e investimeve në këto dy shtete dhe obligimet që i kanë marrë ato. Në strukturën e transaksionit në Maqedoni, përveç që është shitur një pjesë e borxheve të vjetra, është shitur edhe aset i një hidrocentrali prej 40 megavatësh. Pra, nuk është shitur vetëm distribucioni, por është shitur edhe gjenerimi në këtë koncept. E kjo nuk ka ndodhur në Kosovë. Asnjë aset prodhimi 110-kilovoltësh nuk është shitur dhe nuk është në proces, sepse fundi i fundit ne nuk kemi bërë ende ndonjë transaksion. Lidhur me këtë kemi pasur interpelancë dhe Kuvendi e ka thënë fjalën e vet. Prandaj, ne

jemi të obliguar t'i respektojmë vendimet e Kuvendit. Asnjë subvencionim për mosinkasim nuk e merr Qeveria në raport me investitorin privat, siç ka ndodhur në Shqipëri, siç ka ndodhur edhe në vendet tjera, kur ata të cilët nuk kanë mundur të inkasojnë i janë ofruar Qeverisë dhe kanë kërkuar kompensim nga ajo. Asnjë garanci për subvencionim dhe mbulim të mosinkasimit nuk ekziston në këtë transaksion.

Reduktimet e humbjeve komerciale nuk janë pjesë e investimeve, sepse investimet merren me reduktimin e humbjeve teknike. Është obligim ligjor kontraktual nga momenti i nënshkrimit të kontratës që të jetë 3% në bazë vjetore.

Investitori i cili paraqitet, e ka obligim të hyjë në marrëveshje për 20 vjetët e ardhshme për ta blerë tërë energjinë që prodhohet në Kosovë. Kjo energji, të nderuar deputetë, rregullohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e cila prapë i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Është ajo që do të vendosë për tarifën. Jo investitori privat, jo Qeveria, nuk vendosin për tarifën. As investitori privat, as Qeveria, por vendos Rregullatori i Energjisë, i cili përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit.

Ky rregullator do të përcaktojë për këtë investitor pagat dhe numrin e punëtorëve edhe pas 3 vjetëve. Me këtë kontratë parashihet që edhe marrja e kompanisë pa pagesë, në rast se nuk i plotëson të gjitha premtimet që janë bërë. Prandaj, do të ishte jokorrekte të themi se bëjmë krahasime me këtë apo atë. Të gjitha këto qasje janë bërë nëpërmjet përcaktimit të rregullativës nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Pra, në këtë këndvështrim duhet ta shihni procesin e transformimit dhe të privatizimit të distribucionit të energjisë. Ka pasur ide deri në atë sa është thënë që për çka kishte për t'u shitur më shtrenjtë. Ju lutem, do të ishte jokorrekte për të ardhmen e fëmijëve dhe nipave tanë, siç u përmend, që të mos mendojmë të kthehemi në kohën e gurit, kur Kosova realisht nuk do të kishte rrjet të transmisionit, sepse do të shitej. Mendoj se në këtë kontekst duhet të jemi shumë të përgjegjshëm për gjërat të cilat i flasim.

Lidhur me atë se a ka pasur dhe a ka mangësi dhe referencat për transparencë, referencat për krim të organizuar ekonomik, referencat për keqpërdorime, ju lutem, të gjithë jemi persona publikë. Të gjithë kemi obligim për të gjitha ato të cilat i dimë që kanë ndodhur dhe po ndodhin t'i denoncojmë organet e drejtësisë. Jo të bëjmë politikë, por t'i denoncojmë aty ku duhet dhe të merren organet e hetuesisë me te dhe ta shohim se ku po del ajo punë.

U përmendën transaksionet. Po e them, edhe një herë, AKP-ja i përgjigjet Kuvendit dhe Kuvendi do të duhej ta thërriste sot në këtë debat Bordin e AKP-së, kryesuesin, drejtorin menaxhues, të gjithë ata, për të folur për këtë proces. Jo pa ata, të cilët e kanë mandatin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta bërë një proces të tillë. Prandaj, këto janë dallimet të cilat duhet t'i kontestojmë dhe mendoj që do të ishte shumë logjike dhe unë kam bërë dy herë kërkesa me shkrim për Parlamentin, për Kryesinë. Ju lutem, nëse dëshironi të flasim për procesin e privatizimit, thirrni ata të cilët janë përgjegjës dhe që janë zgjedhur nga ky Kuvend. Anëtarët e Bordit të AKP-së janë zgjedhur nga ky Kuvend, rregulloret dhe ligjet e AKP-së janë bërë nga ky Kuvend. Prandaj, ju lutem, për këto

gjëra, për privatizimet, për transparencën e kaluar thirrni ata. Thirrni ata të cilët normalisht kanë bërë, kurse ne do të përgjigjemi për gjërat të cilat jemi duke i bërë ne. Jemi për gjërat në procesin e reformës strukturale në sektorin e energjetikës dhe në sektorët tjerë, e jo të diskutojmë dhe ta vëmë në temë debatin e përgjithshëm të privatizimit, por aktorët të cilët Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka emëruar dhe duhet t'i mbajë përgjegjës ata...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do ta përdor një gjuhë që të kuptohemi më lehtë,

Kemi të bëjmë me dy ndërmarrje, me dy tipa të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet publike, për të cilat është përgjegjëse Qeveria, e që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore, hekurudhore, ajrore, telekomunikacionin, KEK-un, domethënë menaxhimin e ujërave, të mbeturinave, dhe kemi të bëjmë me ndërmarrje shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, për të cilat përgjegjës është Kuvendi. Deputetët s'kanë lidhje me atë punë.

Duhet ta ndaj në dy faza punën e AKP-së dhe të AKM-së. Në kohën e AKM-së kanë menaxhuar ndërkombëtarët. Ju kujtohet emri i Adamsit, ju kujtohet emri i Pollagdës, ju kujtohet emri i Rykerit. Ka menaxhuar Shtylla e Katërt e UNMIK-ut, në bazë të Rezolutës 1244, dhe Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara.

Këshilli Ekonomik Fiskal, ku ka bërë pjesë edhe Shtylla e Katërt, shefi i AKM-së kanë qenë mbi këtë Kuvend. Edhe buxhetin kur e kemi aprovuar është dashur të votojë dhe të vendosë Këshilli Ekonomik Fiskal, domethënë ka qenë mbi këtë institucion. Arsyeja ka qenë se kemi qenë nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara.

Ka pasur në atë kohë tri forma të shitjes: shitja e rregullt, shitja me kusht dhe shitja me kushte speciale, që i thonë tash spin off special. Dhe ka pasur dy lloje të qiradhënies: qiradhënie e rregullt dhe qiradhënie me kontratë, me përparësi të blerjes. Çfarë ka ndodh? Kontratat e llojit të tretë, me spin off special janë bërë me ligjet e Anglisë dhe AKP-ja, dy herë ka kërkuar konsulencë ndërkombëtare për interpretimin e ligjeve.

26 ndërmarrje janë shitur me spin off special, 5 prej tyre janë problematike, për ç'gjë unë kam qenë i zgjedhur nga Bordi i AKP-së që t'i menaxhoj dhe të bëj zgjidhje për to. Më vjen keq që kryetari ka rënë nën ndikimin e mediave dhe përflet edhe LDK-në, por ka qenë kryetar i LDK-së për Drenas dhe ka qenë dega më e mirë atëherë.

Çka ndodh tash? Në fazën e dytë pas pavarësisë së Kosovës, kur bëhen ligjet e reja, kur bartet përgjegjësia në institucionin e AKP-së, nuk bëhet një bartje e rregullt, e arsyeja është se në AKM ndërkombëtarët i djegin shënimet e shitjeve të ndërmarrjeve shoqërore. Por, duhet kujtuar se të gjitha shitjet më të mëdha dhe më të mira janë bërë në fazën e AKM-së, atë që e përmend kryetari, edhe "Ferronikelin", edhe ndërmarrjet tjera. E vërteta është që atë kapital shqiptarët, kosovarët, pas luftës nuk kanë pasur mundësi ta blejnë, nuk kanë pasur mundësi t'i blejnë ndërmarrjet e mëdha. I kanë blerë kryesisht ato

ndërmarrje të cilat kanë mundur më lehtë t'i futin në funksion. Kryesisht kanë qenë ose prona tokësore, ose kanë qenë këto restorantet, por nuk kanë pasur kapacitete financiare të blejnë fabrika, siç ka qenë "Ferronikeli" dhe të tjera. Por, shitja ka ndodhur, e kam fjalën për AKP-në, me oferta të mbyllura me çmim më të madh, gjë që nuk ka ndodhur në kohën e AKM-së. Në kohën e AKM-së, për ta marrë një kontratë është dashur të bëhet vlerësimi 50% çmimi, 25% investimi në atë ndërmarrje dhe 25% numri i të punësuarve që do të mbaheshin.

Sot janë diku të evidentuara rreth 600 ndërmarrje, që përafërsisht shiten në bazë të ligjit, të cilin e ka aprovuar Kuvendi. Kuvendi i ka përcaktuar rregullat e shitjes, nuk ka forma të tjera.

Është edhe një institucion shumë i rëndësishëm që e ngadalëson procesin e privatizimit, sepse ka forma të ndryshme të privatizimit, ka edhe me ankand, ka edhe që japin vetëm për çështje të investimeve nga një dollar, keni dëgjuar. Po këtë formë e ka përcaktuar ligji. Është edhe një organ - Oda e Veçantë e Gjykatës Speciale, i vetmi institucion në Kosovë që e ka gjykatën e vet është AKP-ja. 42 mijë lënda presin aty për trajtim, e domethënë në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në dinamikën e shitjeve të ndërmarrjeve.

Hoteli "Grand", që po përmendet, tash do të mbetet përmendore në Prishtinë edhe për një kohë të gjatë për arsye se është edhe një organ tjetër, përveç organeve të Kosovës, është Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Strasburg ose në Paris, dhe kjo do të zgjasë. Por, janë çështje tjera.

Dikush e përmendi Gjakovën. Gjakova dikur ka qenë njëra ndër komunat më të zhvilluara ekonomisht, me një bazë dhe potencial të mirë ekonomik. Sot është njëra ndër komunat më të pazhvilluara, me papunësinë më të madhe. Por, nuk është faji as i deputetëve, as i AKP-së. Është faji i lëndëve, të cilat nuk trajtohen në Odën e Veçantë, edhe pse kemi bërë ndryshime në këtë drejtim.

Ajo që mua më së shumti më ka brengosur ka qenë 20-përqindëshi. BSPK-ja ka qenë gjithmonë anëtare në bord. Ndarja më e padrejtë që është bërë ndonjëherë në Kosovë është 20-përqindëshi. Deri më sot janë shpërndarë nja 70 milionë. Mirë është, në rregull. Çka ndodh? Ndërmarrjet me numër të madh të të punësuarve dhe ku kushtet e punës kanë qenë më të vështira, si po e zëmë në vendlindjen time, Goleshi u shit 810 mijë euro, me 1 000 punëtorë. 1 000 punëtorë do ta ndajnë 20-përqindëshin e 800 mijë eurove.

Ndërsa kooperativat bujqësore me mijëra hektarë, me 20 të punësuar, janë shitur mbi 20-30 milionë dhe ata marrin pjesë në 20-30 milionë me atë 20-përqindëshin. A nuk ju duket kjo e padrejtë. Këtu është dashur të ketë një politikë unike, që 20-përqindëshi prej krejt shitjeve t'u takojë punëtorëve. Po kjo nuk është bërë kur është dashur, e tash janë këto pasoja.

Tash jemi në fazën më të ndërlikuar, e njëri nga proceset më të mëdha në historinë e ekonomisë së Kosovës është çështja e likuidimit. Nuk është mirë me t'i përmendet emri

atij që ka vdekur, sidomos shqiptarët nuk bëjnë aso gjëra. Ai ka qenë kryetar i AKP-së dhe duhet trajtuar vetëm si ish-kryetar të AKP-së. Me insistimin e tij, me ndryshimin e ligjit, u përzgjedh auditori numër një sot në botë që bën likuidimin e të gjitha ndërmarrjeve dhe pas procesit të likuidimit, kur bëhet kryerja e të gjitha obligimeve ndaj ndërmarrjeve të shitura, paratë që mbeten duhet të shkojnë në Buxhetin e Kosovës, sipas nenit të cilin e kemi bërë, që Qeveria bën propozimin e investimeve, ndërsa Parlamenti vendos që të shkojë në investime kapitale.

Unë po mundohem që për kohën që më jepet t'i sqaroj disa çështje, se ka shumë detale, të cilat janë të rëndësishme për deputetë. Informacioni gjithmonë ka qenë varësisht prej interesimit të deputetëve, sa duan të dinë për atë çështje, se raportimi është ligjor, periodik dhe vjetor dhe, tek e fundit, ai kalon nëpër komisione dhe në Komisionin Funkcional, ku edhe deputetë në fund e japin mendimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Halit Krasniqi!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputete dhe të nderuar deputetë. Unë do t'i trajtoj përciptazi dy aspekte të privatizimit. Kështu, mendoj që ta tërheq vëmendjen e zyrtarëve që kanë ndikim në politikat strategjike të të gjithë procesit të privatizimit. Më duhet të shërbehem me një digresion të vogël nga tema për ta arritur një efekt të madh në trajtimin e saj.

Me të gjithë pushtuesit e trojeve tona, me përjashtim të Serbisë, i kemi përmirësuar marrëdhëniet dhe tani kemi raporte miqësore, sepse kanë ndryshuar ata dhe politikat e tyre ndaj nesh. Një shtet që kurrë nuk ka qenë pushtues këtu, por që me shekuj ka kultivuar politika armiqësore dhe që ka ushtruar ndikim të madh në stërkeqjen e fateve tona këtu dhe gjithandej në gjeografinë shqiptare është Rusia, qoftë me politika mbështetëse, inkurajuese të pushtuesve tanë, veçanërisht të Serbisë, qoftë edhe me katapultimin e formave të ndryshme të ndikimit mbi ne, duke filluar me shpërndarjen e temjanit nga peshkopët drejtpërdrejt dhe nëpërmjet Athinës me "dovat" e imamëve islamë të shkolluar e të përgatitur nëpër shkollat e KKP-së, e deri te arsimimi nëpërmjet tyre në kolegje islame në shtetet arabe, e deri në komprometimin e tyre, kanë shërbyer në një formë fetare dhe për t'i mbëltuar spirancat e robërisë. Pastaj, do të bëhet përgatitja e kuadrove kuazi-islame e imamëve shqiptarë dhe boshnjakë. Nëpërmjet pakicës turke, adhuruesit e kulturës islame dhe të tjerë të devotshëm të këtij vendi kanë gjetur forma të tjera të arsimimit dhe së bashku me programin e rilindësve tanë e kanë shpëtuar nga ky ndikim etninë tonë.

Pas kësaj forme me shumë sukses, që do të japë rezultate, është projekti i radhës me ide të përhapura për proletariatin, e të përvetësuar nga ne deri në marrëzi në mesin e shekullit XIX pothuajse në të gjitha pjesët e copëtuara me shqiptarë, duke krijuar një sistem me idolatri bolshevike e idhuj rusë, e deri në atë masë sa kush i fyen ndër ne dhe nëse nuk i adhuron ndonjëri prej nesh, e pësonte rëndë në jetë nga sistemi i shtetit në cilin jetonim. Sot, faleminderit prej Zotit, kemi ndryshime të gjithanshme në glob dhe veçanërisht në këtë pjesë këtu te ne.

Me përjashtim të ndonjë subjekti minor të konceptit për pronën, që është ende e pranishme, që tani përveç gumëzhimës dhe tentativave për anarki, janë pa ndikim te ne. As me mbështetje çfarëdo qoftë të tyre. Se sot e kemi një kërcim cilësor në emancipimin e përgjithshëm të shoqërisë tonë. Jo më as me temjanin e peshkopëve, as të priftërinjve, as me “dovat” e pseudo-imamëve nuk mund të ndikohet këtu. Sepse tani më e kemi një plejadë të emancipuar të udhëheqësve fetarë me integritet kombëtar, me ndonjë përjashtim të vockël, sa për të mos u rënë mësysh të tjerëve. Jo, më as idetë për pronën, as konceptet për ekonominë centraliste dhe as për proletariatin nuk paraqesin kërcënim për të ardhmen tonë. Megjithatë, hija e Karpateve na ndjek në forma e trajta të tjera, me motive edhe më të forta, sepse gjeografia jonë ka ikur nga sferat e ndikimit të tyre dhe në aleancë me Beogradin do të përpiqen natyrisht që të na atakojnë.

Me rreshtimin tonë politik në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke na goditur ne, i atakojnë politikat e gjithë shteteve miqësore, të cilat kanë bërë politika kombëtare në mbështetje për pavarësinë e Kosovës dhe konsolidimin e institucioneve të saj. Në Këshillin e Sigurimit, Rusia është bërë pengesë kryesore, nëpër kanale diplomatike, gjithashtu.

Përpyekjet e Rusisë për të shtrirë ndikimin e saj do të manifestohen edhe në procesin e privatizimit, jo nëpërmjet Beogradit, as nëpërmjet diskurseve teorike mbi pronën, por me kauzë si atakime për keqmenaxhimin e procesit, me veprime pragmatike në privatizimin e aseteve strategjike, nëpërmjet investitorëve me adresa jashtë Rusisë dhe me origjinë jo ruse, duke u mbështetur nga fondet e Shërbimit Inteligjent për influencë globale nëpërmjet ndikimeve ekonomike.

Nëse në projektet e privatizimit konkurrojnë subjekte afariste me origjinë të dyshimtë ruse, ky është preokupim imi, apo lidhje të tillë çfarëdo qoftë forme, duhet shpërfillur çfarëdo oferte që mund të vijë, sado joshëse që të jenë. Asetet strategjike kur nuk mund nga subjektet tona afariste, duhet të privatizohen nga subjekte me origjinë nga shtetet mike, që në strategjinë e politikës së tyre të dëshmuar janë edhe interesat e shtetit tonë.

Këtë duhet ta themi hapur dhe këtë ndikim duhet ta trajtojmë me vëmendje të veçantë në vazhdimësi, sidomos, aktualisht, në këtë proces shumë të rëndësishëm për të ardhmen tonë.

Gjithashtu, e ndjej të nevojshme të kthej vëmendjen tuaj dhe nga ky vend të ushtrojmë ndikim në logjikën nacionale për qasje më pragmatiste, në procesin e mëtutjeshëm të privatizimit.

Procesi i privatizimit ka qenë një domosdoshmëri dhe këtu nuk kemi dilemë asnjëri prej nesh, ndoshta edhe vetëm për të zhdukur njërin nga kapitujt e fundit të bazës së një sistemi politik të tejkaluar gjithandej nga ishte shtrirë në këtë kontinent. Me gjithë zhvillimet e tij të suksesshme ka edhe shembuj të këqij që kanë krijuar premisa për probleme të mëdha dhe kanë bërë padrejtësi të rënda. Kjo është reflektuar më së shumti në privatizimin e pronave të uzurpuara padrejtësisht në të kaluarën dhe për këtë fakt

pronarët e ligjshëm kanë poseduar dokumentacionin valid, të cilët, edhe pse e kanë prezantuar, nuk e kanë dhënë efektin e duhur në favorin e tyre.

Në të tilla raste, në të ardhmen, të shtyhet privatizimi, propozoj unë dhe besoj që është edhe vullneti i juve dhe të tjerëve, deri në shqyrtimin e plotë ligjor të rasteve të atakuara në formë ligjore. Ju faleminderit për vëmendje.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Ju faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Logjika privatizuese në Kosovë është e mbërthyer brenda një paradoksi të dyfishtë.

Së pari, për vite të tëra është thënë që në ndërmarrjet kosovare, përfshirë këtu PTK-në dhe KEK-un ka shumë korrupsion, prandaj ato duhet të privatizohen që të eliminohet korrupsioni. Njëkohësisht, të gjitha qeveritë janë zotuar për çdo ditë për luftimin e korrupsionit, prej konceptit të sundimit të ligjit e deri te parulla e zero tolerancës. Mirëpo, përvoja e pasluftës na e ka dëshmuar që patëm privatizim, por nuk patëm sundim të ligjit dhe as zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Kjo, për arsyen që prioritet ka qenë privatizimi si lëndë djegëse për tranzicionin. Dhe, ky tranzicion nuk ka qenë tranzicion drejt vendimeve për privatizim, por vendim rapid për privatizim transitiv të privatizimit, gjë që e konfirmon privatizimin si prioritet.

Këto qeveri, që e përdornin korrupsionin si argument për privatizim, nuk mund ta luftonin korrupsionin përderisa e kishin privatizimin në krye të agjendës. Pra, prioriteti i privatizimit të këtyllë, ku nuk lejohen debate, pse të privatizojmë, kur të privatizojmë, çka të privatizojmë, sa të privatizojmë, si të privatizojmë dhe kujt t'ia shesim, e pamundëson luftimin e vërtetë të korrupsionit?

Para se korrupsioni të jetë motor i privatizimit, është intenca e privatizimit ajo që e gjen ose e fabrikon korrupsionin duke e pasur të nevojshëm atë.

Së dyti, privatizimi i aseteve madhore si PTK dhe KEK, bazohet po aq shpesh te keqmenaxhimi i tyre. Nëse këto asete janë të keqmenaxhuara e me shumë korrupsion në to dhe nëse Qeveria është e paaftë ta ulë nivelin e keqmenaxhimit aty, atëherë duhet të largohet Qeveria dhe jo asetet publike, në mënyrë që të vijë një qeveri tjetër e aftë t'i menaxhojë ato.

Është absurde të mendohet se një qeveri që është paaftë të menaxhojë me efikasitet dhe pa korrupsion, është e aftë t'i privatizojë asetet publike me efikasitet dhe pa korrupsion. Më mirë t'i kemi ndërmarrjet publike dhe korrupsionin në to, se sa privatizim të korruptuar, në fund të së cilit nuk i kemi më ndërmarrjet.

Nëse ka korrupsion dhe keqmenaxhim në ndërmarrje publike, aq më shumë do të ketë korrupsion dhe keqmenaxhim më rastin e privatizimit të tyre, si dhe aq më i madh do të jetë dëmi i shkaktuar.

Ka një pajtim të përgjithshëm që burokracia, njëjtë si në korporatat e mëdha, ashtu edhe në shtet, ndikon negativisht. Më tutje, korporatat e mëdha, si në sektorin publik edhe në atë privat, prodhojnë burokraci dhe keqmenaxhim, si pasojë e përmasave të tyre të mëdha.

Në kushte të tilla, ndryshimi i pronësisë ndikon pak në eliminimin e burokracisë. Në vend të ndryshimit të pronësisë, mund të blihej menaxhim nga sektori privat, nëse ky mungon në Kosovë, pa e ndryshuar pronësinë. Pra, ne do të duhej të blejmë menaxhment, në vend së t'i shesim asetet.

Privatizimi i këtyre korporatave të fuqishme është privatizim i monopoleve, që nuk lejon që privatizimi i aseteve të përcillet me liberalizimin e tregut. Sërish, përvoja e ka dëshmuar gjithandëj nëpër botë, se kur vjen puna te monopolet, më mirë të ketë monopol publik, se sa monopol privat. Në rastin konkret, asetet si KEK-u janë në situatë monopoli në treg dhe për pasojë, privatizimi nuk vepron në përmirësimin e tyre.

Ideja e privatizimit bazohet te mekanizmi i konkurrencës, si mekanizëm korrekтив, që e detyron një ndërmarrje të përmirësojë menaxhimin. Rasti i CEZ-it në Shqipëri na tregon se çfarë ndodh në të vërtetë. CEZ-i nuk ka bërë ndonjë përmirësim as në menaxhim dhe as në investime. Ngjashëm edhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, sot nuk ka as dallim viziv dhe as dallim në shërbime, me periudhën e para katër apo pesë vjetëve.

Në kushte të tilla, është më mirë të kesh një monopol publik se sa privat, për më tepër kur bëhet fjalë për asete strategjike si energjia. Në shtetet e dobëta si Kosova, por edhe si Shqipëria, krijimi i monopoleve private të fuqishme është i rrezikshëm, sepse lehtëson kapjen e shtetit. Në rastin e CEZ-it, shteti shqiptar ka pak aftësi ta kontrollojë këtë korporatë, ndërkohë që ajo ushtron presion mbi shtetin dhe e detyron KESH-in t'i shesë energji me çmim mjaft të lirë. Literatura ekonomike dhe përvoja e Shqipërisë rekomandojnë monopolin publik në raport me atë privat edhe për shkak se dëmtohen qytetarët, pasi që monopoli privat synon thjesht maksimizimin e fitimit pa marrë parasysh dëmtimin e qytetarëve.

Në Republikën e Shqipërisë, korporatat si ALB-Telekomi dhe CEZ-i e kanë kthyer në traditë abuzimin me fatura të telefonit dhe të energjisë, duke iu faturuar qytetarëve më shumë sesa ata harxhojnë. Abuzime të niveleve të tilla nuk kanë ndodhur më parë, kur këto ishin asete publike, pasi këto asete ishin më të ndjeshme ndaj ankesave të qytetarëve, që ushtronin presion mbi partitë politike.

Privatizimi i aseteve kyçe vështirëson edhe krijimin e politikave sociale edhe krijimin e politikave zhvillimore. Së pari e vështirëson krijimin e politikave sociale. Për shembull, energjinë me çmim të ulët për shtresat në nevojë dhe së dyti, e vështirëson edhe krijimin

e politikave zhvillimore, për shembull, energjinë me çmim më të ulët për industri të caktuar.

Prandaj, shumë pak shtete dhe gjithnjë e më pak shtete heqin dorë tërësisht nga asetet e tilla, siç po bën kjo Qeveri me Distribucionin e KEK-ut dhe PTK-në. Po them edhe gjithnjë e më pak shtete, përveçse shumë pak shtete, sepse në kushtet e krizës globale, kur mungon likuiditeti, sigurisht që nuk është ky momenti për të shitur asete madhore. Minimalisht duhet pritur sa të përmirësohet tregu. Me asete si KEK-u, që kanë humbje të mëdha në rrjet dhe që nuk arrijnë t'i mbledhin të ardhurat, shteti ka rëndësi shumë të madhe në mobilizimin e forcave të rendit dhe strukturave shtetërore, për t'i mbledhur të ardhurat. Kur firma të tilla privatizohen, ato kanë më pak kapacitete për t'i mbledhur të ardhurat, pasi policia dhe organet shtetërore nuk varen prej tyre.

Pas privatizimit të Distribucionit në Shqipëri nëpërmjet CEZ-it, humbjet në rrjet dhe ato nga arkëtimet janë rritur dhe nuk janë zvogëluar. Në kushtet kur segmente të mëdha të popullatës nuk paguajnë rrymën ose e vjedhin atë, si në Shqipëri e në Kosovë, është e nevojshme të kombinohen politikat sociale, domethënë, ulja e çmimit për ata që nuk paguajnë dot çmimin e plotë me politikat shtrënguese të shtetit për të ndaluar vjedhjen dhe abuzimin. Diçka e tillë bëhet shumë më mirë nga shteti se sa nga privati. Dhe, sërish rasti i Shqipërisë e dëshmon këtë gjë.

Pra, nuk i nevojitet vetëm KEK-u shtetit të Kosovës, por edhe shtetit të Kosovës i nevojitet KEK-u. Privatizimi nuk e lë vetëm shtetin e Kosovës pa KEK-un, por e lë edhe KEK-un pa shtetin e Kosovës.

Sovraniteti i një shteti nuk vlen nëse nuk shprehet në mundësinë për përcaktimin popullor të formave të organizimit ekonomik, apo nëse populli nuk ka asnjë lloj vendimi për organizimin e ekonomisë. Në fakt, një zgjidhje në Kosovë është bërë për një strukturë të caktuar ekonomike. Kjo zgjidhje është asgjësimi i plotë i sektorit publik industrial dhe kalimi i tij në pronësi të kapitalit të huaj. Ky është qëndrimi ekstremist, jo kundërshtimi i privatizimit. Ky është vendim që është marrë, pa pajtimin, pa pëlqimin dhe pa sqarimin e pasojave afatshkurtra dhe afatgjata të qytetarëve të Kosovës. Ky privim nga ky lloj sovraniteti është më i kobshëm sesa vetë shpronësimi nga asetet publike dhe i paraprinë atij.

Shteti si Republikë dhe publikja si pronësi, janë shumë ngushtë të lidhura. Nuk mund ta dëmtosh njërin, pa e dëmtuar tjetrën. Kësaj qeverie më shumë po i dhimbset koncepti dhe projekti i privatizimit sesa Kosova. Sot, të jesh kundër privatizimit akuzohesh shumë më tepër se sa të jesh kundër Kosovës. Në fakt, kjo Qeveri, që është kundër Kosovës, akuzon ata që janë kundër privatizimit në Kosovë. Këta po përpiqen ta shpëtojnë privatizimin abstrakt më parë, sesa Kosovën konkrete, ta shpëtojnë idenë e privatizimit më parë se sa Kosovën aktuale. Kundërshtuesit e këtij privatizimi në Kosovë dhe deputetët që diskutojnë në këtë seancë, që nuk është kundër privatizimit në përgjithësi, i kisha lutur vetëm një gjë, mos u zbrapsni në defanzivë, le të mos dukemi që më të rëndësishme e kemi ta shpëtojmë privatizimin prej këtyre privatizuesve, sesa ta shpëtojmë Kosovën prej privatizimit.

Qëllimi ynë nuk është që ta bllokojmë privatizimin, sepse gjërat janë mirë kështu siç janë pa të, por sepse mund të jenë më mirë, kurse me këtë linjë që po e ndjek Qeveria do të bëhet edhe më keq.

Për ta kuptuar këtë nuk është me rëndësi nëse je i majtë, i djathtë, apo i papërcaktuar ideologjikisht. Ne jemi të privuar nga sovraniteti ekonomik. Ky privatizim është po ashtu privim, është privim nga diçka, është negativ, është privim nga publikja. Ne do të arrijmë ta mbrojmë Kosovën, nëse e duam publikën e Kosovës dhe jo vetëm privaten në Kosovë. Publikja është hapësirë dhe shërbim, publikja është gjuha dhe komunikimi, energjia, posta dhe telefonja. Publikja është arsimiti, shëndeti dhe institucionet publike, publikja është policia dhe ushtria, gjykatat dhe burgjet, publikja është ajri dhe uji, territori i shtetit tonë dhe nëntoka nën këmbët tona. Publikja është liqenet dhe lumenjtë, minierat dhe mineralet, sheshet dhe trotualet, parku dhe parkingu, rrugët dhe bibliotekat, korridoret dhe lifti.

Publikja është e përgjithshme, sepse publikja është e përbashkëta dhe gjithëpërfshirësja, ajo që është midis nesh pa e përjashtuar asnjërin prej nesh. Publikja është demokracia, publikja është Republika, publikja është vetë qenia...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë.

ALBIN KURTI: Pra, publikja është e përgjithshme, sepse publikja është e përbashkëta dhe gjithëpërfshirësja, ajo që është midis nesh, pa e përjashtuar asnjërin prej nesh. Publikja është demokracia, publikja është Republika, publikja është vetë qenia e qytetarit në Republikë. Prandaj, pyetja është ajo e vjetra, duam të jemi apo nuk duam të jemi? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj

XHEVDET NEZIRAJ : I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të flas për çështjen e privatizimit, besoj që ky debat është pak i vonuar, për arsye se ndërmarrjet në Kosovë përafërsisht mbi 90% veç u shitën dhe nuk kemi më çka të diskutojmë, për arsye se ndërmarrje shumë me rëndësi, përveç dhe PTK-ja që ka mbetur se të gjitha tjerat u shitën.

Më kujtohet shumë mirë, në legjislaturën e parë, kur kryeministër ishte Bajram Rexhepi, konfliktin që e kishte me Maria Fussin, në lidhje me privatizimin dhe nuk u marrshim me rregullore, po u marrshim me personin, sepse rregullorja kishte ardhur nga Kombet e Bashkuara, kishte ardhur nga Nju Jorku dhe kishim shumë problem ta ndryshojmë. Edhe ne si Kuvend, ku ministri Beqaj po tenton që çdo adresim ta hedhë në Kuvend, përgjegjësi kanë edhe Qeveria edhe deputetët, po edhe pamundësinë që kemi mundur ta bëjmë për privatizim.

Ministri elaboroi ekonominë e Kosovës edhe unë mundem me thënë lirisht, që ka qenë një ekonomi e planifikuar e ekonomisë socialiste. E dimë që kemi trashëguar një pazhvillueshmëri ekonomike, e dimë që Kosova ka qenë vendi më i pazhvilluar në ish - Jugosllavi, e dimë që nuk është bërë investim që nga viti '81. E di që përveç amortizimit fizik, ndodh edhe amortizimi moral në ndërmarrje, do të thotë, teknologjia vjetërsohet. Të gjitha këto i dimë. Po, a ka mund të ndodhë privatizimi më mirë në Kosovë, unë shpresoj që ka mundur të ndodhë. Dhe, tani janë këto pasojat, për arsye se kemi mbi 500 milionë euro të ngrira, të cilat ky Kuvend dhe Qeveria mund të bëjnë më shumë, që të jenë në funksion të ekonomisë.

Unë besoj, që ndërmarrjet kanë mundur të shiten me shumë më pak para dhe të bëhet shitja edhe në bazë të projekteve të biznesit, të cilët mund të punësojnë njerëz më shumë. Ne me këtë privatizim, me këtë tip të privatizimit, e kemi goditur klasën që duhet mbrojtur, klasën punëtore e jemi duke i mbrojtur disa njerëz, që s'kanë nevojë për mbrojtje. Jemi duke i mbrojtur disa biznesmenë, se ata kanë para mjaftë dhe s'kanë nevojë shumë edhe për këto ndërmarrje. Mirëpo, ky lloj i privatizimi, këtë ka mundur ta bëjë Qeveria, këtë ka mundur ta bëjë ky Kuvend dhe mund të bëjmë diçka më tepër. Këtu janë ato probleme. Sepse, a jemi për privatizim a s'jemi për privatizim, unë shpresoj që të gjithë në Kosovë janë shumë të vetëdijshëm se privatizimi duhet të ndodhë. Ne jemi shumë të vetëdijshëm se ekonomia socialiste ka kaluar dhe e planifikuar, siç po thonë, po ekonomia e tregut, edhe ajo i ka ligjet e veta, i ka rregullat e veta dhe s'do të thotë që ekonomi e lirë të jetë anarki, do të thotë, në këtë kuptim, këto dy koncepte.

Në anën tjetër, duhet edhe qytetarëve të Kosovës dhe klasës punëtore t'u thuhet që është shumë vështirë të kthehen ato ndërmarrje siç kanë qenë në ish socializëm. Është shumë vështirë që "Emin Duraku" dhe Gjakova t'i ketë më 10 000 punëtorë, për arsye se teknologjia e tyre është vjetruar, është stërvjetruar dhe ato makina sot në Kinë mund të shitën vetëm për hekur, për arsye se kanë përparuar teknologjitë tjera përparimtare dhe sot, edhe firmat shumë më të njohura botërore edhe vendet shumë më të zhvilluara e kanë vështirë tregun.

Mirëpo, çka ka ndodhur në Kosovë me privatizim, unë nuk kam shumë informacione për sekserë, s'kam shumë informacione për njerëz që ndikojnë, mirëpo ashtu po dëgjohet në media dhe këtë mund ta bëjë ky Kuvend, që t'i ndalë këto veprime të këqija dhe këtë që është mbetur pa u privatizuar mund të privatizohet në mënyrë të shëndoshë.

Unë besoj, që në këtë Kuvend ka njerëz, ka biznesmenë në Kuvend, pa dalë jashtë këtij Kuvendi, që mund ta blejnë KEK-un për 26 milionë. Po nisem vetëm nga disa biznesmenë, që i kemi këtu. Ata kanë mjete financiare, që mund ta blejmë KEK-un dhe të mos ia japim ndonjë... bile mund të bisedojmë me këta këtu, mund të zgjedhim ndonjë problem shumë më mirë, sesa t'ia japim ndonjë firme të huaj.

Mungesa kryesore që e shoh, janë tërheqja e investitorëve të huaj, në blerjen e ndërmarrjeve me rëndësi të cilët kishin mundur të ndikojnë në rritjen dhe uljen e papunësisë. Kjo nuk ka ndodhë në Kosovë. Arsyeja pse s'ka ndodhur është arsyeja

kryesore, që mund të bie mbi Qeverinë ose mbi ne këtu në Kosovë, se nuk jemi joshës për investitorë të huaj. Prandaj, ne duhet të bëjmë asi politikash, që të jemi joshës për investitorë të huaj. Duhet t'i bëjmë vetes pyetje, pse investitorët e huaj nuk kanë qenë të interesuar t'i blejnë ndërmarrjet tona, a është për shkak të tregut, a janë për shkaqe tjera?

Prandaj, këto janë ato arsye që mund t'i diskutojmë në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Nuk mund të hapet tema e privatizimit e të mos përmendet problemi i njohjes së statusit të 46 shoqërive aksionare të Gjakovës nga ana e AKP-së.

Menaxherët e ish-ndërmarrjeve shoqërore të Gjakovës ishin të parët në Kosovë, që filluan aplikimin e ligjeve për transformimin e kapitalit shoqëror në atë privat, punëtorë aksionarë dhe në bazë të vendimeve të organeve qeverisëse të ish-ndërmarrjeve shoqërore aplikuan ligjet në fjalë dhe u regjistruan në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Gjakovë dhe që nga viti '90 deri në vitin '99, funksionuan si shoqëri aksionare dhe në këtë mënyrë iu shmangën masave të dhunshme të pushtetit okupues serb, të cilat ishin aplikuar në tërë ekonominë e Kosovës dhe kështu mbi 20.000 punëtorë nuk u përjashtuan nga puna.

Po ashtu, si shoqëri aksionare u regjistruan në regjistrin e përkohshëm, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut dhe vazhduan punën deri më 30.6.2003, si shoqëri aksionare. Në bazë të Rregullores 2001/6 mbi shoqëritë tregtare dhe Urdhëresës administrative 2002/22, shoqëritë aksionare të Gjakovës në mbështetje të nenit 44 regjistrimi i ish-ndërmarrjeve shoqërore, po citoj nenin: “Një ish-ndërmarrje, e cila është transformuar me kohë në shoqëri aksionare dhe në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, para se të hyjë në fuqi kjo urdhëresë administrative, që të njihet si e tillë nga një gjykatë kompetente në Kosovë, do të regjistrohet si shoqëri aksionare, ose si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas procedurave të nenit 41 të kësaj urdhërese administrative”.

Duke pritur zgjidhjen e statusit legal të shoqërive aksionare të Gjakovës i mbështetur në ligjet në fuqi më datë 13.5.2009, me ndërmjetësimin e kryetarit Pal Lekaj, është mbajtur takimi me të ndjerin zotin Dino Asanaj, në prezencën e përfaqësuesve të shoqërive aksionare të Gjakovës, ku janë dakorduar, që nga të dy palët kontestuese të formohen grupe të ekspertëve për auditimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e statusit definitiv të këtyre ndërmarrjeve dhe se gjatë muajit maj dhe qershor të vitit 2010, ky proces i auditimit të përfundojë.

Më datë 10.8.2009 AKP informon me shkrim pas katër muajsh palët në kontest në frymë të takimit të datës 13.5.2009, por gjer më tani ky auditim dypalësh nuk ka ndodhur dhe për habi AKP më datë 30.4.2010 merr vendim në të cilin Holding Company “Jatex”,

Holding Company “Deva” dhe Holding Company “Emin Duraku”, t’i trajtojë si ndërmarrje me kapital 100% shoqëror dhe më datë 21.5.2010 AKP bënë shpalljen në shtypin ditor duke u mbështetur në nenin 7.2 të politikave operative të AKP-së, që praktikisht, qëllimi është që këto ndërmarrje të shiten në bazë të kapitullit 7, zbatimi i likuidimit vullnetar, duke u thirr se është shqyrtuar dokumentacioni në dispozicion nga Bordi i AKP-së, gjë që nuk qëndron nga se auditimi dypalësh nuk ka ndodhur ende gjer më tani edhe pse i njëjti ka qenë në dispozicion të AKM-së që 8 vjet. Duket se kjo paska qenë punë e thjeshtë, që me një vendim arbitrar, të pabazuar në fakte dhe dokumentacion, të merret aq lehtë dhe kjo të bie në konkludim se ish- AKM nuk ka vepruar dhe paska qenë naive dhe autoritet kuaziligjor, që këtë çështje nuk e ka zgjidhur për 6 vjet dhe na del një AKP shumë efikase dhe se këtë problem e zgjidh me një vendim të pabazuar dhe jashtëligjor në kundërshtim të plotë me Konventën Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, protokollin 1, neni 1, dhe me Rregulloren 2002/12 të AKM-së.

Konstatimi i AKP-së për trajtimin e shoqërive aksionare të Gjakovës si ndërmarrje me kapital 100% shoqëror është totalisht i pabazuar dhe në bazë të propozimit të ish AKP-së mund të shitet vetëm pjesa e mbetur eventuale e kapitalit shoqëror dhe me Rregulloren e UNMIK-ut të AKP-së ka qenë e detyruar të përcaktojë pronarin dhe këtë AKP-ja nuk e ka bërë asnjëherë gjer më tani.

Andaj, kjo çështje mund të zgjidhet në frymë të ligjeve me marrëveshje në mes të AKP-së dhe shoqërive aksionare të Gjakovës, ose nëpërmjet Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, përkatësisht të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përmes padive të cilat janë bërë.

Vendimet në fjalë të AKP-së thirren në Ligjin 03/L-067 mbi formimin e AKP-së, që është i pabazuar, ngase shoqëritë aksionare kanë aplikuar për njohjen e statusit në bazë të Rregullores 2002/12 dhe posedojnë dokumentacionin valid ligjor dhe vendime përkatëse të gjykatave me të cilat e mbështesin të drejtën e tyre në pronë.

Pas marrjes së vendimit të pabazuar në fakte dhe jashtëligjore nga ana e AKP-së, Oda e Veçantë Supreme, në bazë të padive të shoqërive aksionare të Gjakovës, të ushtruar në vitin 2008, me vendime përkatëse, parandaloi, mori masën e përkohshme për ndalimin e rishitjes së këtyre ndërmarrjeve, shoqërive aksionare Holding Company “Jatex”, “Emin Duraku”, “Ereniku”, “Ereniku - Fabrika e lëngjeve, Bodrumi i verës, “Ena” dhe Holding Company “Metaliku”, duke u mbështetur nga faktet e pashtuara nga ana e këtyre ndërmarrjeve.

Në bazë të Ligjit për AKP-në, AKP-ja është e obliguar, pavarësisht ligjit në fjalë, në bazë të planit gjithëpërfshirës të Ahtisaarit, kapitulli 7, ku përcakton se prona private do të mbrohet në tërësi, sipas parimeve të Konventës Elementare për Liri dhe të Drejta të Njeriut, andaj ky ligj është në kundërshtim të plotë me këtë konventë dhe para së gjithash, është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ngase është e çuditshme, që dikush me supozime të shpronësojë dikë nga prona, andaj këto ndërmarrje kanë parashtruar padi kundër AKP-së në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në muajin 11-12 të vitit 2011.

Në rastin e ndërmarrjeve të Gjakovës, kemi të bëjmë me moszbatim të ligjeve të ish-AKM-së dhe tani të AKP-së, që me ndërrime permanente të rregulloreve iu mohohet e drejta në pronë dhe të bëhet shpronësimi i tyre, gjoja për interes publik duke i shitur dhe rishitur ndërmarrjet e Kosovës dhe duke i zhveshur punëtorët nga e drejta në pronë dhe në punë. Kjo zvarritje mosnjohje e statusit të shoqërive aksionare, qe 13 vjet pas lufte, me paragjykime të pabazuara në fakte dhe ligje në fuqi, është denigruese dhe nënçmuese. Të tërhiqet zvarrë një qytet, i katërti për nga madhësia në Kosovë, me një ekonomi dikur të fortë dhe prosperuese, me resurse humane, me përvojë dhe me pasoja të mëdha, si asnjë qytet tjetër në Kosovë. Athua që gjakovarët kanë faj, që në atë kohë kanë qenë më të shkathët dhe kanë përfituar nga Ligji i reformës ekonomike, në përkrahje të plotë të shteteve perëndimore, për inkorporim në rrjedha dhe standardet e ekonomisë së tregut perëndimor?

Të nderuar, Gjakova e ka kryer privatizimin, për vetë faktin se dy nga këto shoqërive aksionare u është pranuar privatizimi, ndërsa të tjerave edhe pse e kanë të njëjtin status, po iu mohohet një gjë e tillë dhe si pasojë iu është mohuar e drejta për punë normale dhe legale, u është pamundësuar e drejta në kolateral hipotekë, i është cunguar e drejta në sistemin bankar për kredi, me rekomandimin e drejtuar nga AKM, bankave afariste, që çdo kredi e dhënë për këto shoqëri aksionare është rrezik juaji.

Ndërmarrjet që kanë qenë të orientuara në eksport e kanë humbur tregun. Resurset kuadrore janë dezorientuar, i është pamundësuar konkurrimi në tenderët për punë, i është pamundësuar shfrytëzimi optimal i kapaciteteve prodhuese, është krijuar hezitim, jo siguri investitorëve të mundshëm për të investuar në ndërmarrjet e tyre.

Vetëm një shembull po e marr, sa për informatë Shoqëria aksionare “Dukagjini”, që nga pranimi i saj si shoqëri aksionare, ka të punësuar 130 punëtorë, ka dhënë mbi 4 milionë euro paga, ka dhënë 70.000 euro bursa për studentë dhe Buxheti i Kosovës ka përfituar diku 500.000 euro prej saj. Paramendoni, po t’iu kishte pranuar statusi i merituar edhe 46 shoqërive aksionare tjera, ku do të ishte ekonomia e Gjakovës sot.

Rekomandojmë që AKP-ja, bashkë me Qeverinë të nxjerrin masa specifike të përsheptuara për njohjen e statusit të këtyre ndërmarrjeve në Gjakovë dhe përfundimisht, t’u njihet e drejta e tyre legjitime. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëgjova këtu më herët që thanë, ky debat është dashur të mbahej më herët. Pajtohem, ky debat është dashtë me u mbajt shumë më herët, në vitin 1945 kur është kryer Lufta e Dytë Botërore, kur nuk është ditur saktë se cili model i ekonomisë është më i përshtatshëm për zhvillimin e shteteve.

Nëse, sponsoruesi i këtij debati në fund të tij nuk kërkon që i gjithë procesi i privatizimit apo disa segmente të tij të pezullohen a të ndërpriten krejtësisht, atëherë unë paraprakisht po kërkoj falje për pjesën e poshtme të fjalimit.

Por, e kam një ndjenjë, që nuk do të paraqitet nevoja për kërkim falje, sepse ky debat për një hair nuk është thirrur. Do ta konsideroja se do të ishte një debat që po zhvillohet në të mirë të vendit, nëse në fund të kësaj seance propozuesi i debatit të kërkonte, që ne ta mbështetnim, që Kuvendi të ketë një rol më aktiv në monitorimin e procesit të privatizimit, qoftë të ndërmarrjeve shoqërore, qoftë të atyre publike. Mirëpo, jam i bindur që prapa këtij akrobacioni demagogjik, gjoja për të mbrojtur në Kuvend pronën shoqërore dhe atë publike, fshihen as më pak e as më shumë, se veprat e ideologëve ekstremistë majtistë prirë nga mjekërthinjuri Karl Marks.

Pra, ekziston tendenca që në këtë Kuvend, t'i japim "nasihat" botës sesi ne e mendojmë zhvillimin ekonomik, sesi ne e shohim tregun e lirë, sesi ne e shohim dhe e konceptojmë liberalizmin ekonomik, apo në rastin konkret, centralizmin ekonomik.

Të nderuar kolegë deputetë, do të pajtoheshja nëse do të kërkohej që procesi i privatizimit, për hir të transparencës të monitorohej në mënyrë jashtëzakonisht rigorozë. Do të pajtoheshja që në krye të komisioneve të ishte edhe komandanti i KFOR-it i armatosur, që të mbikëqyrte procesin e shitjeve. Pra, nëse ka nevojë do të votoja për këtë punë, mirëpo nuk do të votoja e as nuk do të pajtoheshja me asnjë kusht, që kjo kompani publike, në këtë rast "Vala" apo cilado prej tyre, të pezullohej procesi i shitjes vetëm pse grupet ekstreme majtiste, duke shfrytëzuar pasigurinë e deputetëve të ndryshëm, dëshirojnë t'i arrijnë objektivat e tyre.

Pra, ne po sillemi në pozitë që të zgjedhim nëse dëshirojmë që vendin tonë ta çojmë rrugës së Letonisë, Lituanisë dhe Estonisë apo asaj të Bjellorusisë, Ruisë dhe Ukrainës, vende këto të cilat shteti i kontrollon resurset kryesore ekonomike. Dhe, ky qëndrim imi personal se ne duhet të ndjekim rrugën baltike dhe jo atë moskovite nuk ka të bëjë asgjë me qëndrimet e shtetit rus dhe satelitëve të saj, lidhur me pavarësinë e Kosovës. Kjo ka të bëjë kryekëput vetëm me faktin se cili model është më i suksesshëm. Për të ju bindur se kjo është e vërtetë, atëherë qe po them, hajde ta ndjekim rrugën e Sllovakisë ose të Shqipërisë.

Të nderuar kolegë deputetë, unë personalisht mendoj se është akt patriotik dhe është obligim, që në procesin e privatizimit çdo gjëje publike dhe shtetërore të shitet. Ne jemi këtu për të garantuar qytetarët e Republikës së Kosovës, se ndërmjet modelit të ekonomisë së planifikuar të Maos apo Andropovit, në njërin anë dhe të Margaret Thatcher dhe Ronald Reganit, në anën tjetër, të zgjedhim këtë të dytën.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe Thesari i shtetit është i privatizuar. Margaret Thatcher kur e kishte marrë pushtetin, vendi i saj kishte qenë në një depresion të rëndë ekonomik. Ajo kishte deklaruar se nuk do ta shesë vetëm ushtrinë. Të mos flasim për fatin e sindikatave të punëtorëve në Britani të Madhe. Mirë do të ishte, që këto tonat, të

hyjnë dhe të lexojnë pak për fatin e minatorëve grevistë në kohën e zonjës Thatcher apo të kontrollorëve të aeroporteve ajrorë në kohën e zotit Regan.

Pra, të nderuar kolegë deputetë është dëshmuar katërçipërisht se privatizimi i pronës shoqërore, shtetërore apo publike, quajeni si të doni, nuk është njëra prej mundësive, nuk është njëra prej rrugëve, është vetë mundësia, është vetë rruga, është kërkesa ultimate privatizimi i pronës publike. Nëse ekziston ndonjë rrugë tjetër më efikase, të jeni të bindur që ende nuk është aplikuar askund. Sigurisht, për mundësi të tilla dhe për rrugë të tilla, koka më të mençura se këto tonat, janë duke u rropatur në Harvard, Kembrixh, Oksford, Yale, Westpoint apo vende tjera. Do të njoftohemi ne dhe gjithë bota, nëse ka ndonjë lajm.

Thonë, që budalla mëson prej gabimeve të veta, kurse i mençuri prej gabimeve të tjerëve.

Dhe, tendenca për të eksperimentuar me ekonominë e vendeve të tyre nuk është që nuk mund t'i hasim si kuriozitate nëpër botë. Për shembull, në Venezuelë, një lider i çmendur si Hugo Chavez, jo vetëm që e ka ndërprerë procesin e privatizimit, por edhe i ka nacionalizuar asetet që i kanë shitë njëherë. E ftoj secilin, që të futet dhe të lexojë për gjendjen ekonomike në këtë vend. Besoni ose jo, arsyetimet e Çavezit për privatizimin janë shumë të ngjashme me këto që i dëgjojmë këtu.

Kolegë deputetë, shpesh po krijohet bindja se në Kosovë po shiten kompani e ndërmarrje, vetëm pse kështu po thonë ambasadorë të huaj, apo se ne po i shesim kompanitë tona miqve ndërkombëtarë e besa spekulohet edhe për emrat e ambasadorëve të shteteve absolutisht përkrahëse të Kosovës, si gjoja të përfshirë në transaksionet ilegale. Çfarë marrëzie. Madje, dëgjohen edhe aludime, se duke shitur ndërmarrje po shlyejmë borxhe të luftës ndaj miqve, që na kanë ndihmuar në atë kohë. Idiotësira!

Pra, individë të caktuar, parti të caktuara apo shoqata joqeveritare të caktuara po dëshirojnë të krijojnë opinion publik, se procesi i privatizimit është duke ndodhur për hatrin e gjithkujt, përveç të banorëve të Kosovës. E unë mendoj që është krejtësisht e kundërta, procesi i privatizimit ndodhë vetëm për banorët e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë, rastet e caktuara të korrupsionit, krimin të organizuar, që mund ta njollosin procesin e privatizimit nuk guxojnë ta ndalin procesin e privatizimit. Shteti i Kosovës, institucionet e Kosovës duhet sa më shpejtë që të lirohen nga menaxhimi i pronës publike e shoqërore. Shteti në një shoqëri demokratike duhet të jetë vetëm arbitër e nuk mundet, që në të njëjtën kohë të jetë edhe arbitër edhe palë në lojë. Shteti i Kosovës e ka për obligim, që të jetë garantues i mundësive të barabarta, por jo edhe i të mirave të barabarta. Për këtë kujdeset tregu i lirë. Për këto arsye Karl Marks ka dështuar. Faleminderit!

KRYETARI: Mos u merrni me shekullin XIX! Merruni me të sotmen! E keni pak më afër. Lëreni, jeni të vegjël të merreni me të tjerët, por diskutoni për privatizimin. Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Procesi i privatizimit paraqet procesin e rishpërndarjes së pasurisë shoqërore- publike tek individët dhe firmat private. Në parim, procesi si i tillë ka qenë dashur të ketë një ndikim tejet të madh në ekonominë kosovare, në mirëqenien e qytetarit kosovar, si dhe në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit tonë. Por, realisht shikuar, efektet e këtij procesi janë se disa individë kanë përfituar pasuri të theksuar, kurse të tjerët thuajse asgjë. Madje, fatkeqësisht, dyshohet se ndër përfituesit më të mëdhenj të këtij procesi kanë qenë ndërmjetësuesit dhe shantazhuesit, të cilët jo rrallë kanë luajtur rolet kyçe në privatizimin e shumë ndërmarrjeve shoqërore dhe publike. Procesi i privatizimit në Kosovë, tanimë ka hyrë në vitin e dhjetë të ekzistimit të tij. Përkujtoj se raundi i parë i privatizimit është zhvilluar në korrik të vitit 2003 dhe pas afro një dekade të ekzistimit të këtij procesi, natyrisht mund të shtrohet pyetja, a janë përmbushur të priturat e qytetarëve, që kanë pasur lidhur me këtë proces dhe se a duhet vazhduar më tutje në këtë mënyrë, me këto mjete dhe metoda dhe konform rregullave ekzistuese.

Bazuar në mendimet dhe vlerësimet e opinionit të gjerë, por edhe në mendimet e ekspertëve të ekonomisë, procesi i privatizimit në Kosovë, nuk i ka përmbushur as për së afërmi të priturat e punëtorëve, bujqve dhe qytetarëve kosovarë. Andaj, lirisht dhe me plotë të drejtë mund të vlerësohet si një proces i dështuar.

Në vazhdim do t'i theksoj disa prej rrethanave dhe faktorëve, që sipas mendimit tim kanë ndikuar në një mënyrë apo në tjetrën në dështimin e këtij procesi.

Nën 1, faktori kyç gjithsesi ka qenë korruptimi i personave përgjegjës për procesin e privatizimit. Madje, është fshehtësi publike se në këtë proces drejtpërdrejt kanë qenë të involvuar, por edhe kanë realizuar përfitime të mëdha anëtarët e Kabinetit qeveritar, si ministra, zëvendësministra, zëvendëskryeministra, këshilltarë e deri te zyrtarët e nivelit komunal. Madje, gjatë këtyre viteve janë zhvilluar disa procese gjyqësore, për shkak të korrupsionit në këtë proces. Kurse, rasti më i freskët, i cili pa mëdyshje do të përfundojë në gjykatat e Kosovës, është afera e privatizimit të Hotelit Grand.

Nën 2, faktori i dytë i dështimit të këtij procesi janë vetë pasojat e tij, sepse sipas vlerësimit të ekspertëve të ekonomisë, nga ky proces në Kosovë kanë mbetur pa punë apo i kanë humbur vendet e tyre të punës, afro 70 000 persona, që për një vend të varfër, me një ekonomi të dobët është një grusht i papërballueshëm, i cili mund ta shpijë vendin tonë drejt një kolapsi ekonomik. Këto pasoja tregojnë në faktin, se ky proces ka filluar dhe është zhvilluar pa bërë përgatitjet e duhura dhe pa planifikim paraprak, që do të thotë, se fare nuk është planifikuar se si do të veprohet me punëtorët e ndërmarrjeve që privatizohen. E kështu janë krijuar kushte të favorshme për përfitime enorme apo marramendëse për individë dhe grupe të caktuara të afërta me pushtetin.

Faktor tjetër ishte shitja apo privatizimi i ndërmarrjeve pa caktuar paraprakisht ndonjë çmim të shitjes dhe pa bërë ndonjë studim analitik për mbi vlerën reale të pasurisë së

ndërmarrjeve në tregun kosovar. Kështu, për shembull, në procesin e privatizimit janë shitur 29 200 hektarë tokë, nga të cilat janë inkasuar vetëm 100 milionë euro e që kur e përpjesëtojmë del se një ari tokë e privatizuar ka kushtuar vetëm 34 euro. Paramendoni, një ar tokë është shitur për vetëm 34 euro, në një vend siç është Kosova, ku çmimi i një ar toke sillet në treg prej tre-katërqind deri në tre-katërdhjetë mijë euro. Kjo rrethanë është keqpërdorur nga grupe të interesit, të cilat nëpërmjet korrupsionit, fillimisht i kanë privatizuar këto toka e pastaj, pa kaluar kohë e gjatë, të njëjtat i kanë shitur me çmime qindra herë më të larta dhe kështu kanë realizuar përfitime nga ky proces i dështuar, kurse në të njëjtën kohë janë shpronësuar me mijëra të tjerë, të cilët janë sjellë në buzë të varfërisë dhe mjerimit duke humbur edhe shpresën e fundit të mbijetesës dhe mirëqenies personale dhe familjare.

Unë e veçova privatizimin e tokave bujqësore, por kështu është vepruar edhe me ndërmarrje të tjera, si për shembull, privatizimi i cili është në vijim, i Distribucionit të Energjisë Elektrike, që është duke u bërë për vetëm 26,3 milionë euro, i cili distribucion ka në pronësi 1 058 km. linjë, me afro 20 000 km. kablllo, me mijëra shtylla elektrike, me qindra trafostacione dhe objekte tjera afariste, vlera reale e të cilave sigurisht sillet ndërmjet 200 dhe 300 milionë euro.

Pikërisht, mospërcaktimi i çmimit shitës të ndërmarrjeve për privatizim ka ndikuar që herë-herë në tenderë të privatizimit të konkurrojnë firma e vetme, me tri çmime të ndryshme dhe kuptohet, me emra të ndryshëm, gjë që paraprakisht ka përcaktuar fituesin real të privatizimit të ndërmarrjeve konkrete.

Faktorë tjetër negativ që e ka përcjell këtë proces kanë qenë shantazhet dhe kërcënimet, që u janë bërë ofertuesve të ndershëm nga individë dhe grupe, të cilat ose janë në pushtet, qoftë komunal apo qendror apo janë të afërta me Qeverinë, në përgjithësi. Madje, ekzistimi i shantazheve dhe kërcënimeve të kësaj natyre është vërtetuar edhe në procedura gjyqësore, si për shembull, rasti i kërcënimit të zyrtarëve të komunës së Kaçanikut.

Faktor tjetër është edhe mos ruajtja e destinimit të ndërmarrjeve të privatizuara, fakt ky që ka ndikuar që një sipërfaqe e madhe e tokave bujqësore, pa ndonjë plan dhe strategji është shndërruar në toka ndërtimore dhe në këtë mënyrë ky proces është bërë si katalizator i zvogëlimit radikal të tokave bujqësore në shtetin tonë, përkundër faktit se bujqësia duhet të jetë njëra prej degëve kryesore të ekonomisë kosovare.

Rrethanë tjetër negative, që e ka shoqëruar procesin e privatizimit është edhe dukuria e pastrimit të parave. Vlerësohet, se një numër i madh i ndërmarrjeve shoqërore është privatizuar me të holla, origjina e të cilave nuk është e ditur apo madje me të holla të dyshimta se kanë prejardhje nga korrupsioni, kontrabanda, trafikimi i narkotikëve apo nga forma të tjera të krimit, përfshirë këtu edhe krimin e organizuar.

Fakt tjetër i dështimit të procesit të privatizimit është edhe mos përmbushja e obligimeve financiare ndaj të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara, si dhe ngrirja e mjeteve të inkasuar nga procesi i privatizimit, respektivisht mos përfshirja e tyre në proceset aktive

të zhvillimit ekonomik të Kosovës, ndonëse nga i gjithë privatizimi janë inkasuar vetëm 383 milionë euro, që domethënë se pjesa gati më e çmuar e pasurisë së vendit tonë paska pasur vlerë vetëm më pak se 400 milionë euro dhe për shkak të mos planifikimit, ende ato mjete financiare nuk janë futur në procesin e revitalizimit të ekonomisë kosovare. Kjo nënkupton se këto mjete ende nuk janë duke u shfrytëzuar për hapjen e vendeve të reja të punës, për zbutjen e shkallës së lartë të papunësisë dhe zvogëlimin e mjerimit dhe varfërisë, të cilën është duke e përjetuar një përqindje e madhe e popullatës së Kosovës dhe atë, paramendoni, në shekullin XXI.

Rrethanë tjetër është edhe joselektimi i ndërmarrjeve për privatizim. Vërtet është për t'u habitur dhe për t'u shqetësuar, se si një agjenci shet pa kurrfarë dallimi, sikurse ndërmarrjet jo profitabile, ashtu edhe ato profitabile, madje bujku ynë si nikoqir i mirë që është, kur qet bagëtinë në treg për të shitur, fillimisht i shet ato që i japin qumësht më pak e jo ato që japin sasi të mëdha. Kurse, Qeveria jonë dhe Agjencia Privatizimit, që kanë shumë e shumë njërës të shkolluar dhe ekspertë të ekonomisë, ka vendosur të privatizojë edhe ndërmarrjet më profitabile të Kosovës, siç është rasti me PTK-n, e cila është ndërmarrja më profitabile në vend, e cila ka afër një milionë abonentë në rrjetin mobil dhe afro njëqindmijë abonentë në telefoninë fikse, me shërbime bashkëkohore të internetit, që i sigurojnë Qeverisë dividendë dhjetëra dhe qindra milionëshe në vit.

Andaj, mendoj se agjencia dhe kjo Qeveri duhet ta prolongojë dhe analizojë edhe njëherë privatizimin e ndërmarrjeve profitabile, siç është rasti me Postën e Kosovës e jo që privatizimin e saj të bëjë pjesë të ligjit të buxhetit, siç është dhe e ka bërë, sepse veprim i tillë është plotësisht i kundërligjshëm.

Të metë tjetër të këtij procesi paraqet edhe fakti se në kohën kur agjencia me bekimin e Qeverisë po privatizon ndërtesa dhe objekte afariste në pronësi shoqërore, shumë institucione dhe agjenci shtetërore po paguajnë qira të majme. Kështu, buxheti i Kosovës po shpenzohet pa masë në emër të qerasë për ministri, prokurori, dogana, Avokatin e Popullit, agjenci dhe borde të ndryshme. Kurse, logjika shtet formuese do të ishte që në radhë të parë të sigurohen objektet për funksionimin dhe veprimin e organeve dhe institucioneve shtetërore, e pastaj ajo që mbetet të privatizohet, e jo të veprohet ashtu siç është duke u vepruar.

Pasur parasysh të gjitha këto dobësi, që e kanë përcjellë procesin e privatizimit në Kosovë, mendoj se ky proces e sidomos privatizimi i ndërmarrjeve publike, duhet të rishqyrtohet në mënyrë profesionale dhe analitike, duke i vërtetuar dobësitë dhe keqpërdorimet e paraqitura në proces, ndërsa keqpërdoruesit, të korruptuarit dhe kriminelët e të gjitha niveleve, duke filluar prej Qeverisë, agjencisë e deri te komunat, të vihen para drejtësisë.

Pas evitimit të këtyre dobësive të vazhdohet me një proces më transparent të privatizimit, më të ligjshëm dhe më profitabil për qytetarin, punëtorin dhe ekonominë kosovare, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Është hera e parë që Qeveria po tenton të ndajë pak a shumë veten nga procesi i privatizimit dhe këtë faj, në këtë rast, sepse jo gjithmonë fajin e bërë, mundohet t'ia hedhë AKM-së apo përkatësisht AKP-së.

U dëgjua këtu që edhe thuhet që pse s'e keni thirrur AKP-në dhe rrjedhimisht vjen pyetja, kë të thërrasësh? Personi më i duhur, që kish mundur të flasë tani, personi që ka ditur më së shumti rreth shumë çkaje e sidomos rreth diçkaje, nuk është më në mesin tonë dhe rrjedhimisht edhe nuk mund ta thërrasim. Dhe, arsyet pse nuk është në mesin tonë, me siguri më shumë i di Qeveria sesa ne.

Qeveritarët e sotëm nuk kanë qenë jashtë procesit as në kohën kur janë në Qeveri, po as në kohën kur kanë qenë në opozitë. Më lejoni t'ua kujtoj pak, duke marrë vetëm një nga shembujt e shumtë të këtij fakti.

Në vitin 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, kishte vendosur që ta shiste njërin prej gjigantëve metalurgjik në Kosovë, Feronikelin. Në qoftë se keni harruar, po ju përkujtoj se Ferronikeli në atë kohë u shit për një shumë prej rreth 30,5 milionë eurosh, nëse jam tamam i saktë. Në kohën kur nisi shitja e "Ferronikelit", shumë prej qeveritarëve të sotëm dhe kreu i saj ishin opozitë, madje e kishin edhe një qeveri nën hije, qeveri e cila atëbotë kundërshtoi ashpër këtë shitje, madje aq ashpër sa që edhe i mobilizoi qytetarët e Drenicës për ta parandaluar shitjen e "Ferronikelit". "Ferronikeli" i ishte shitur tashmë "Alferonit", pra një kompanie të regjistruar në Londër.

Në pamje të parë, regjistrimi në Londër tregonte se kemi të bëjmë me një kompani të njohur angleze, por shumë shpejt u mor vesh se kemi të bëjmë me një kompani të regjistruar vetëm për këtë blerje dhe se pronarët ishin tre shtetas të Kazakistanit, të njohur për spekulime me minerale në ish- shtetet e Bashkimit Sovjetik. Po në të njëjtën kohë, këtu ndryshoi dhe qëndrimi i opozitës së atëhershme, qëndrimi i opozitarëve u bashkua me atë qeveritar dhe "Ferronikeli" u shit me një çmim shumë të ulët, madje nuk u shit as me çmimin më të lartë të ofruar, por rreth 16 milionë më lirë, se sa çmimi i një kompanie tjetër konkurruese.

Ky qëndrim i opozitës u ndërrua befasishëm, pas një udhëtimi interkontinental, që bëri i pari i opozitës së atëhershme, u kthye nga atje, jo për ta kundërshtuar, por për ta përkrahur tashmë shitjen e "Ferronikelit" dhe për ta mbështetur kompaninë "Alferon". Madje, në atë kohë lideri i opozitës pati deklaruar, citoj: "Urime Drenicë, urime Drenas, urime Kosovë!". Dhe, në të njëjtën kohë, iu kthye sërish drenicasve, jo për t'i mobilizuar sikur pak ditë më parë në mbrojtje të Ferronikelit, por për t'i çmobilizuar ata.

U bënë bashkë Qeveri e opozitë dhe e dhanë Ferronikelin. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë në atë kohë, i uroi qytetarët dhe ua dha lajmin se kjo ishte një ditë e lumtur për rajonin e Drenicës. E këtij ministri, krejt rastësisht iu gjet emri më vonë në listat e Partisë Demokratike të Kosovës, si kandidat për deputet.

PDK-ja erdhi në pushtet me trenin dhe me vagonët e “Ferronikelit”, por biletën për të hipur në këtë tren nuk e kishte nxjerr në stacionin e trenit në Drenas, por shumë larg Drenicës, diku në Izrael. Pra, PDK-ja u korruptua para se të vinte në pushtet dhe s’ka se si të prisnim një qeveri ndryshe nga kjo që e kemi përveçse një qeveri të korruptuar. Ne kemi qeveri të korruptuar, sepse në këtë Qeveri udhëheq një parti e korruptueshme.

Por, t’i kthehemi prapë “Ferronikelit”. Përveç çmimit të ulët të blerjes, skandaloze ishte edhe pjesa e kontratës për furnizimin me rrymë të “Ferronikelit”, ku Qeveria e Kosovës kishte marrë përsipër obligimin, që “Alferonit” t’ia mundësojë furnizimin e pandërprerë me energji elektrike me një çmim më të ulët se sa kostoja e prodhimit të rrymës. Dhe, në këtë rast, edhe në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike, Kosova do t’ia paguante të gjitha humbjet e fitimit “Alferonit”. Premtimet për t’i mbajtur në punë 1 000 persona, i kishin ikur shumë shpesh, madje, veç sa ka nisur vala e dëbimeve nga puna. Gjendja e punëtorëve për çdo ditë po përkeqësohet, e për sigurinë në punë dëshmojnë edhe... e shumta të vazhdueshme në Drenas. Kurse Kosova dhe Drenica, në vend të lulëzimit të premtuar nga shitja e “Ferronikelit”, fituan vetëm ndotje enorme të ajrit dhe ambientit. Në vend të mirëqenies së premtuar, punëtorët përballen me punë të rënda dhe me paga të pamjaftueshme. Në vend të lumturisë që uronin pushtetarët dhe pozitarët e dikurshëm, punëtorët tashmë kanë rrezikshmëri ekstreme në punë deri në shkatërrimin e shëndetit të tyre, po ashtu edhe rrezikimit të jetës së tyre. Dhe, në vend të rritjes së numrit të të punësuarve, atje kanë nisur tashmë vala e largime të reja nga puna.

E “Ferronikeli” pra nuk u privatizua, por u privatizua vetëm e drejta për ta shitur atë, e kjo e drejtë u privatizua fillimisht pa tender, nga një grup politikanësh dhe pastaj mbi këtë të drejtë ata e shitën, siç ata kanë dashur, aq sa ata kanë dashur dhe atij që ata kanë dashur. Përveçse një kontratë e keqe dhe e dëmshme për vendin, manipulimi me shitjen e “Ferronikelit” është një korrupsion, e korrupsioni është krim. Pra, para se të dënohet krimi, duhet të parandalohet ai. Tashmë është koha. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Faleminderit! A jeni dakord të vazhdojmë a ta bëjmë një pauzë për drekë? Vazhdojmë! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

U përmend disa herë fjala e ministrit, i cili tha se e kemi një vendim të Kuvendit të vitit 2008, e unë i them ministrit që pikërisht me atë vendim ju keni bërë një shkelje, duke mos i respektuar asnjëherë asnjërën nga pikat e këtij vendimi.

Gjithashtu, ministri foli disa herë për kontratat e punëtorëve. Jo vetëm në komunën e Deçanit, ashtu siç e përmendi deputetja nga radhët tona, por një gjë e tillë ka ndodhur në shumë komuna tjera. Në gjë e tillë ka ndodhur edhe në komunën e Gjakovës, ku është larguar drejtoresha e KEK-ut, një profesioniste me një përvojë 20-30-vjeçare. Kjo ka ndodhur edhe në shumë komuna të tjera, pra pikërisht po largohen njerëzit profesionistë për të ardhur njerëz joprofesionistë, e qëllimi i vetëm është manipulimi me ta.

Privatizimi në Kosovë, ashtu siç po ndodh, doli të jetë proces ligjor mjaft i ndërlikuar dhe politikisht i ngarkuar. Prandaj, si i tillë, domosdo do të ketë ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik të vendit. Privatizimi në Kosovë ka ndikuar në përkeqësimin e ekonomisë së Kosovës. Ndërmarrjet në pronësinë shoqërore, të cilat përbënin rreth 90% të industrisë dhe ekonomisë së vendit, u shitën shumë lirë, gjë që është më e keqja, meqë Kosova i humbi edhe tregjet që i kishte. Si rrjedhojë, këto dëme janë të parikuperueshme. Shitja e ndërmarrjeve në pronësinë shoqërore në Kosovë ka mbledhur vetëm 600 milionë euro. Nuk është vetëm një ndërmarrje në Kosovë që e ka vlerën e gjithë këtij privatizimi. Për shembull, ka shumë raste në rajon që një fabrikë të ketë kushtuar rreth 500 milionë euro.

Për fat të keq, gjithë procesin e privatizimit e ka përcjellë korrupsioni, shpërdorimet e vazhdueshme që janë bërë në dëm të qytetarëve të Kosovës. Mungesa e një ligji të duhur mbi privatizimin ka bërë që shkalla e korrupsionit të jetë në këtë nivel, pothuajse të pashpjegueshëm. Vdekja e kreut të Agjencisë së Privatizimit veç sa i rrit dyshimet, edhe ashtu shumë të mëdha, për procesin e privatizimit në Kosovë. Të gjitha ndërmarrjet dhe objektet përcjellëse të tyre janë ndërtuar, janë blerë, janë financuar me paratë e taksapaguesve të konsumatorëve tanë gjenerues kryesorë të Buxhetit të Kosovës, jo me paratë e asnjë subjekti politik, e aq më pak të kësaj Qeverie, e cila në këtë mënyrë përpiket t'i pakësojë dështimet e menaxhimit të shtetit, i cili ende nuk është në gjendje të prodhojë as për vete, e as të gjenerojë të ardhura, përveç taksave tona të shumëfishta, pjesa më e madhe me origjinë nga Diaspora, e deri diku nga donacionet e jashtme.

Qeveria e Kosovës është dashur ta ndërrojë rrënjësisht qasjen ndaj privatizimit të KEK-ut dhe PTK-së. Procesi i privatizimit për KEK-un dhe PTK-në janë pothuajse të njëjtë. Eksperiencat negative nga shtetet e rajonit, si: Shqipëria, Maqedonia etj., është dashur të reflektojnë shumë më ndryshe, në mënyrë që nga institucionet tona të formësohet një tjetër qasje në rrugën dhe procesin e privatizimit, proces që, e përsëris edhe një herë, do t'i kushtojë shumë shtrenjtë zhvillimit ekonomik të vendit.

Privatizimi, siç është duke ndodhur, vetëm sa i ka sjellë dëme ekonomisë së vendit, pasojat e të cilit po i hasim kudo. U përmendën shumë herë ndërmarrjet e komunës së Gjakovës. Unë këtu nuk do të ndalem, sepse Aleanca vazhdimisht ka folur, por më duhet ta përmend faktin se ne si deputetë duhet t'i dimë kompetencat e nivelit lokal dhe të nivelit qendror, të mos ngatërrohen ato, por një gjë më duhet ta them se pikërisht në Qeverinë e Kosovës, zëvendëskryeministrja, që vjen po nga kjo komunë, ka premtuar shumë, e asgjë nuk ka bërë. Jo vetëm që nuk ka bërë, por asnjëherë nuk po interesohet për këto ndërmarrje dhe për asgjë pozitive që ndodh në komunën e Gjakovës. Dhe, gjithçka në vullnetin e kryetarit të Komunës, pa qenë përgjegjësi e tij, i cili është marrë me takime, ashtu siç i përmendi edhe deputetja, por për interesin e qytetarëve të komunës së Gjakovës, duke dashur që gjithherë t'u dalë në krah qytetarëve.

Së këndejmi, si pasojë e privatizimit pa kritere dhe në bazë të interesave grupore janë rrezikuar vendet e punës së mijërave punëtorëve, respektivisht ky lloj privatizimi e ka rrezikuar mirëqenien e rreth 12 667 familjeve në Kosovë. Si “rezultat”, procesi i privatizimit është faktor kryesor që Kosova sot renditet e para në Evropë për nga varfëria

dhe papunësia. Pra, papunësia dhe varfëria kanë adresë të qartë, e ky është privatizimi pa kriterë, pa profesionalizëm, i ndikuar politikisht. Konsideroj që në këtë pikëpamje ka munguar edhe roli i këtij Kuvendi, ndonëse dihet që të gjitha kompetencat në vazhdimësi i kishte Qeveria e vendit, adresa më e saktë e këtyre dështimeve. Unë edhe njëherë e ftoj këtë Kuvend që bashkërisht të ndikojmë në mënyrën e arritjes së një interesi publik, pa e dëmtuar klimën e investuesve në këtë vend, për të cilën aq shumë ka nevojë ky shtet.

KRYETARI: Faleminderit! Suzana është këtu? Nuk është, atëherë fjalën e ka Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar mysafirë vëzhgues,

Debati i sotëm ka një rëndësi të madhe, sepse mund të prodhojë efekte pozitive për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe për zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Për ta arritur këtë, ne duhet që nga ky debat të nxjerrim disa elemente që do ta formësonin një konsensus të një shumice domethënëse në këtë Kuvend. Konsensus në këtë shumicë domethënëse është një pjesëmarrje domethënëse edhe e opozitës. Për ta arritur këtë, Qeveria duhet ta kuptojë këtë dhe duhet të jetë e gatshme që t'i bëjë korrigjimet e nevojshme në këtë proces, korrigjime që e fuqizojnë interesin publik dhe transparencën, që i kontribuojnë rritjes së efekteve të privatizimit në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, uljes së konfrontimeve të ashpra sociale e politike në vend lidhur me privatizimin. Pra, me këtë - forcimit të stabilitetit politik dhe institucional të vendit, e me këtë edhe rritjes së atraktivitetit të vendin tonë për investitorët. E me këtë t'i kontribuojë edhe përmirësimit të imazhit të vendit tonë nëpërmjet të një konfirmimi se klasa politike e vendit është në gjendje të krijojë dhe ta zhvillojë stabilitetin politik e institucional mbi bazë të konsensusit për interesat kyçe nacionale, pra për interesat e vendit, duke e forcuar transparencën, llogaridhënien, rolin e Kuvendit, sistemin gjyqësor, rolin përgjegjës dhe llogaridhënës të Qeverisë, e cila duhet ta respektojë më shumë Kuvendin dhe të raportojë e të jetë llogaridhënëse ndaj këtij Kuvendi.

Nëse Qeveria mendon se gjithçka është duke shkuar mirë dhe duhet të ecën me stilin e deritashëm, ky konsensus do të bëhet shumë i vështirë, për të mos thënë i pamundshëm. Qeveria ndoshta mund ta krijojë një shumicë këtu, një shumicë jodomethënëse në këmbim të rritjes së tensioneve dhe ashpërsimit të konflikteve politike, konflikteve sociale dhe në këmbim të dëmtimit të mëtejshëm të imazhit të vendit tek investitorët seriozë, që aq shumë i duhen Kosovës. Qeveria duhet të mendojë thellë se a e dëshiron këtë.

Konsensusi bazik politik në këtë Kuvend natyrisht duhet të prodhohet edhe me kontributin e opozitës. Opozita, duke u angazhuar për ta vazhduar privatizimin, duke u angazhuar në mënyrë të vendosur për ta korrigjuar këtë privatizim në ato pika, ku cenohet interesi publik. Besoj se kjo është e mundur dhe, sa dëgjova unë edhe nga diskutimet e deputetëve të opozitës, përvijohet ky qëndrim i mundshëm.

Më lejoni që të komentoj se çka do të thotë transparencë. Nuk është vetëm debati apo shpalosja e dokumenteve në publik, edhe pse shumë dokumente, sidomos raportet e këshilltarëve, transaksionet, asnjëherë nuk janë shpalosur sa duhet. Transparenca është, para së gjithash, dëshirë dhe forcë nga Qeveria që të marrë ide, propozime, sugjerime nga debati që zhvillon opozita, shoqëria civile dhe nga ekspertët e mediet.

Nëse bëhemi të shurdhër ndaj gjithë kësaj, transparenca dhe llogaridhënia e humbim kuptimin e tyre real dhe me këtë konfliktet sociale e politike në shoqëri ashpërsohen.

Më lejoni që në vazhdim të jem më konkret. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë ka qenë një proces i domosdoshëm, si një segment i ndërtimit të ekonomisë së tregut. Prandaj, instituti që unë kam udhëhequr deri në vitin 2010 ka bërë pesë publikime në shqip dhe pesë studime në anglisht për këtë problem, duke avokuar për një privatizimi që i kontribuon ndërtimit të demokracisë, ekonomisë së tregut dhe rritjes ekonomike. Pretendimet e Serbisë që atëherë e kanë penguar këtë proces dihen dhe sot nuk duhet të përdoren për t'i frikësuar apo denigruar deputetët. Pretendimet e Serbisë janë false, thjesht një propagandë.

Plani i Ahtisarit me formulimin e tij thotë se e gjithë prona publike dhe shoqërore që gjendet brenda kufijve të Kosovës i takon popullit të Kosovës. Serbia e ka humb çdo sens se mund të ketë sukses në të.

Efektet nga privatizimi kanë qenë larg prej atyre të priturve dhe të mundshme, jo për fajin se modeli ka qenë i keq, por për shkak se është menaxhuar dhe udhëhequr keq nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, që e ka injoruar pikërisht transparencën dhe bashkëpunimin me aktorët e interesuar, që e ka injoruar llogaridhënien dhe raportimin në këtë Kuvend. Ndryshimi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka ndodhur më së tepërmi, për dallim nga AKM-ja, e cila bile na i ka dërguar nja tri raporte këtu. Por, as kjo nuk ka arritur ta krijojë transparencën domethënëse dhe llogaridhënien. Qeveria që është përgjegjëse dhe ka kompetencë për privatizimin e ndërmarrjeve publike duhet ta korrigjojë mënyrën e menaxhimit, në mënyrë që të mos i përngajë AKM-së, të mendojë se është e vetëmjaftueshme, e plotfuqishme dhe të mos e marrë në llogari zërin e Kuvendi dhe zërin e 66 mijë nënshkrimeve, të cilat mund të bëhen edhe më shumë.

Qeveria nuk duhet vetëm të servisohet nga një shumicë e vogël në këtë Kuvend. Privatizimi në Kosovë nuk ka qenë i suksesshëm edhe për shkak të politikave ekonomike, të politikave të taksave dhe çmimit të lartë të kredisë dhe një mjedisi biznesor që e rangon shumë keq Kosovën, në vendin e 117-të dhe 119-të, nga 137 vende. E shumë më keq e rangojnë mu në ato pika që do t'i kishin kontribuar privatizimit më të mirë. Rangohemi shumë keq në mbrojtjen e investimeve, rangohemi shumë keq në zbatimin e kontratave, rangohemi shumë keq te licencat. Derisa kjo nuk përmirësohet, ne do të kemi: imazh të keq te investitorët, investimet e jashtme direkte do të zvogëlohen ose nuk do të rriten, rritja ekonomike çfarë duhet 7 deri 8% do të mbetet vetëm dëshirë, e për këtë është përgjegjës ky Kuvend, është përgjegjëse kjo Qeveri, është përgjegjës sistemi gjyqësor, është përgjegjëse edhe Presidentja.

Unë po i propozoj elementet për një konsensus: ndërmarrjet shoqërore. Përdorimi i fondeve të privatizimit për efektin e tyre ekonomik duhet të krijohet fondi i restitucionit diku 10 deri 15% të këtyre mjeteve. Besojmë se kjo është e mundur me një konsensus politik edhe brenda planit të Ahtisarit. Këtë e kemi propaganduar moti, por gjithë forcat politike deri tash kanë qenë të shurdhra.

Dy: “Trepça” dhe ca ndërmarrje shoqërore ende paprivatizuara të shikohen si raste të veçanta dhe të privatizohen. U fol këtu për ndërmarrjet e Gjakovës. Është turp që deri tash nuk është gjetur ndonjë zgjidhje për këto ndërmarrje. Zgjidhja duhet të gjendet.

Tre: KEK-u dhe Distribucioni, procesi ka shkuar larg, janë krijuar edhe procedura, por edhe këtu procesi duhet të korrigohet. Mendoj se edhe Qeveria, edhe investitori “Limak&Çalik” duhet ta kuptojë se ky aranzhman dhe ky projekt është komprometuar dhe çmimi i vazhdimet të tij do të jetë shumë i dëmshëm për Qeverinë dhe për “Limak&Çalik” dhe për gjithkënd. Andaj, Qeveria, “Limak&Çalik” duhet ta korrigjojë atë. Mendoj që ky aranzhman, në një proces privatizimi duhet të zëvendësojë këtë proces që është komprometuar me një proces koncesioni për një periudhë, kur “Limak&Çalik” obligohet për investime në një aranzhman BOT (Build - operate - transfer) të marrë në qeverisje me investimet që i ka premtuar për 10-15 vjet dhe kjo të mbetet pronë publike. Nëse kjo nuk është e mundur, i tërë procesi duhet të shkojë përsëri.

Katër: PTK-ja, përkatësisht Telekomit - për këtë Qeveria nuk ka bazë legale për privatizim. Baza legale edhe atëherë e kontestueshme me nenin 4 të Buxhetit të Kosovës në vitin 2011, tashmë nuk ekziston. Ky ligj ka pushuar së ekzistuari më 31 dhjetor 2011. Andaj, ky Kuvend nuk ia ka aprovuar asnjëherë vendimin që është publikuar në faqen 4. Kuvendi të një material, që besoj se edhe ju e keni marrë, nuk e ka aprovuar këtë vendim. Ky është keqinformim. Prandaj, ky ose një tjetër vendim i Qeverisë duhet të vijë në Kuvend dhe të vazhdojë procesi i privatizimit.

Qeveria zyrtarisht e ka tërhequr këtë vendim me shkresë nga procedura. Nëse vazhdohet me improvizime, pa konsensus bazik në vend të privatizimit të shpejtë, siç e ka proklamuar kjo Qeveri, do të kemi ngadalësim, konflikte, komprometim të projektit, rënie të imazhit. Është përgjegjësi jona, të nderuar kolegë, dhe e juaja, Qeveri, se çfarë do të zgjedhë ky Kuvend dhe çfarë do të zgjedhë kjo Qeveri. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Zonja e zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të gjithëve, ta përshëndes këtë debat, ta përshëndes edhe nismën.

Mund të pajtohem, mund të mos pajtohem, por e konsideroj të natyrshme që të bisedojmë për një çështje të tillë. E konsideroj të nevojshme dhe do të dëshiroja që të dalë e dobishme. Jam i bindur se mund të dalë e tillë nëse e shikojmë jo politizimin e ideologjizimin e temës, jo përfitimet partikulariste, por nëse thirremi nga interesi i vendit, i sotmi dhe i ardhshmi.

Tema e debatit të sotëm është rrjedha e privatizimit. Ku jemi, ç'po ndodh me të? Nuk besoj se ndihmon shumë qasja kuazi-akademike rreth asaj a duhet apo nuk duhet privatizimi. Është e deplasuar dhe nuk është temë e këtij debati, sidomos mendoj që është absurde të merremi tani me mjekrat e filozofëve të shekullit IX dhe jam i sigurt që dikush në Oxford etj., do të tallej pikërisht me këtë prirjen tonë për ta argumentuar shpesh varfërinë e argumenteve e të fakteve me formula të deplasuara ideologjike.

Megjithatë, nëse duhet eventualisht të kemi referenca, mund t'i marrim referencat më afër, te ato që janë aktuale. Le të përmendet edhe modeli i theçërizmit etj., pse jo, por të mos e përjashtojmë dhe të mos krijojmë përshtypjen sikur duhet të jetë tabu nëse këtu zhvillohet e përvijohet edhe vizioni i Toni Blerit, ta zëmë, i Klintonit, i Obamës e i tjerëve. Është moderne dhe koha megjithatë po dëshmon se e vërteta është pikërisht në anën e një mendimi të ri, kreativ e modern, që është në përputhje me kushtet konkrete. Dhe, këtu, në këtë Kuvend, sekretarja e shtetit zonja Klinton e ka pas nënvizuar nevojën e privatizimit, po e theksoj saktësisht si e ka pas thënë: “inefficient publik companies”, që do të thotë “të kompanive publike joeficiente”. Është interesant se në prezantime nëpër medie kjo “inefficient”, do të thotë “joeficiente” është fshirë.

Për ta totalizuar, si të thuash qasjen deri edhe të sekretares së Shtetit, më ka bërë shumë përshtypje dhe më krijon ende pikëpyetje: Pse? Kujt? Kujt i duhet kjo dhe ku shpie kjo? Për më tepër, ne e kemi edhe një Kushtetutë, zonja e zotërinj, dhe kjo Kushtetutë i ka legalizuar dhe i mbron të gjitha format e pronës në Kosovë dhe pronën publike e merr në përkujdesje të veçantë. U marr shumë kohë për t'i lexuar referencat, por ju sugjeroj që t'i lexoni ato dhe t'i keni si mbështetje në qasjen tuaj. Megjithatë, për të mos rënë edhe unë tash në debate jashtë temës, mendoj se pyetjet të shumta imponohen dhe unë nuk pretendoj t'i them të gjitha, por ndonjë do ta shtroj.

Kjo që po bisedojmë është dilema: privatizim apo jo, pro e kontra, apo çka po ndodh me privatizimin? Është privatizim apo shitje kjo që po ndodh? U tha këtu me plot gojën “është shitje dhe duhet të shitet gjithçka”. Është privatizim sipas praktikave të dëshmuara, si të suksesshme apo një privatizim specifik, që thënë në gjuhën e popullit, po kthehet në “rrush e kumbulla”?

A duhet të privatizohet gjithçka, siç u tha këtu, deri edhe buxheti. Nëse shkojmë sipas kësaj logjike, a duhet të privatizohet edhe privatizimi, zonja e zotërinj? Dhe, a mos po na ndodh që të na privatizohet edhe vetë procesi i privatizimit, me arsytetime që janë shumë të veçanta: nuk po menaxhohem mirë kompanitë publike. Askush nuk e shtron çështjen, pse nuk po menaxhohen ato? Kush po ndikon në menaxhimin e keq të tyre? A është provuar që ato të konsolidohen? Dhe, pse ndodh që kompanitë e tjera publike në vendet tjera të jenë të suksesshme, ndonjëherë edhe të vijnë t'i blejnë asetet tona, kurse ne themi që janë të pasuksesshme apriori dhe duke thënë se janë të tilla, pa perspektivë, a ndikojmë që ato të jenë vërtet të tilla? A ndikojmë edhe në zhvlerësimin e tyre në tregun, në të cilin po i hedhim.

Kësaj i thonë: “Ta presësh pemën për t'ia marrë frutat”. E arsyetojmë se ka nevoja të sotme. E di që ka nevoja dhe përpiqem t'i mirëkuptoj, por shtrohet pyetja: Çka do të

shesim nesër? Çka do të shesin brezat që vijnë? Nëse ne shesim gjithçka, çka do të shesin ata? Dhe, çka po ndodh me ato që po i shesim? Nëse shesim dhe e kthejmë në zhvillim ekonomik, në punësim, në progres, mund edhe të kuptohet, por ju, zonja e zotërinj, e dini që fondi i privatizimit te ne nuk po shfrytëzohet për këtë destinim. Po zhvlerësohet nga viti në vit, e shumë prej jush, që e merrni fjalën, jeni ekspertë për këtë dhe i dini shifrat më mirë se unë dhe gjithë të tjerët.

A mos po na përsëritet edhe modeli i “Ferronikelit” edhe i tjerëve edhe në këto kompani tjera, që po planifikojmë tani t’i shesim me të njëjtin arsytim. Por, dua ta theksoj edhe një gjë që më ka bërë përshtypje dhe nuk më lë indiferent. Edhe nëse pajtohem për të gjitha, duhet të privatizojmë gjithçka, duhet të shesim gjithçka, pavarësisht çka ndodh pastaj me paratë, pavarësisht se ku destinohen ato, ekziston një obligim edhe në Kushtetutën tonë etj., që megjithatë duhet t’i kemi parasysh edhe kreditorët etj., ende spekulojnë disa me titullarin dhe ende nuk janë sigurt kush është titullari, gjë që populli i Kosovës, punëtorja e Kosovës, e ka pasur të qartë edhe para 30 vjetësh, por shpesh na përfaqësojnë edhe ata që nuk kanë besuar kurrë në titullarin e vërtetë të Kosovës, të Republikës saj dhe të lirisë saj. Prandaj, edhe është rrezik nëse ata që nuk besojnë në titullarin të hyjnë në aranzhmane për pasurinë e saj. Dhe, ajo që mendoj, duhet parë, por nëse edhe e shesim kështu siç po thuhet gjithë pasurinë, a duhet të përpiqemi ta shesim sa më shtrenjtë dhe me këtë diskurs që kemi “janë pa perspektivë, duhet të mbyllen” etj., e ulim apo e ngremë vlerën e tyre dhe nëse ulim punën e kujt e bëjmë? Qeveria e ka rolin e vet, Agjencia e Privatizimit për pjesët tjera të pasurisë së Kosovës, por gjithmonë shtrohet një dilemë: në anën e kujt janë përfaqësuesit e Kosovës? Në anën e atyre që shesin, apo në anën e atyre që blejnë?

Sepse nganjëherë i dëgjoj ministrat tanë të flasin me gjuhën e atyre që blejnë. Bëjnë avokim të atyre që blejnë dhe harrohet që, megjithatë, ata janë pala që shesin. Kjo i bie sikur ai që e kishte nxjerrë mallin e vet në pazar dhe në vend se ta lavdëronte, e tallte, e zhvlerësonte. Ai e kishte një arsytim se thoshte: “Dua të tregoj në çfarë halli jam”, por përfaqësuesit tonë në çfarë halli janë? Prandaj, ajo që si minimum duhet të kërkojmë është që të jemi në anën e titullarit të kësaj prone, të Kosovës. Ta mbrojmë interesin e Kosovës, qofshim edhe përballë miqve e partnerëve strategjik, si po i quajmë.

Megjithatë, debat kishte mjaft dhe argumente mendoj ka mjaft. “Fshati që digjet nuk do kallauz”, thotë populli, por ajo që po na mungon është ingranimi i duhur i këtij trupi, i Kuvendit të Kosovës. Ne nuk e kemi siguruar raportin e duhur me Ekzekutivin, me Agjencinë për Privatizim në këtë rast. Sot e kemi një propozim të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, është i vetmi komision që merret me të. Por, nuk kemi një punë paraprake të përgatitjes se me çka duhet të dalim. I mungon Kuvendit të Kosovës një komision i posaçëm për çështjen e privatizimit, e ky është propozimi im. I mungon Kosovës një analizë për procesin e privatizimit, e ky komision do të duhej ta ndihmonte procesin e konsolidimit në këtë fushë të sqarimit të tablosë, ashtu të ngatërruar etj., të korrigjimit të anomalive të deritashme dhe nxjerrjes së mësimëve për të ardhmen. Nuk do të ishte e tepërt, siç kanë vendet e tjera, që për çështje të tilla vitale të ketë edhe një resor të veçantë ndërministror. Ka vende që kanë ministri të posaçme dhe ato e kanë justifikuar vetveten.

Mendoj që si minimum, Kuvendi i Kosovës duhet ta krijojë një komision...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A do edhe pak kohë? Mirë! Vazhdojmë! Deputetja Afërdita-Berisha Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITË BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë,

Ekonomia private ishte faktori themelor i mbijetesës në kushtet e rënda të zhvillimit të aktiviteteve ekonomike në Kosovën e okupuar.

Ekonomia private e tregoi një vitalitet, i cili dëshmon se në Kosovë zhvillimi i ndërmarrësisë është me perspektivë. Zhvillimi i Kosovës duhet të mbështetet para se gjithash në iniciativën e lirë private, në kultivimin e aftësive menaxheriale, në afirmimin e rolit të ndërmarrësve në shoqëri dhe ndërmarrësisë si filozofi e re zhvillimore. Në verën e vitit 1999, ekonomia e Kosovës ishte e shkatërruar plotësisht, pas shumë vitesh të krizës ekonomike dhe politike, keqmenaxhimit, mungesës së investimeve, shkatërrimit dhe luftës. Sapo erdhën zyrtarët ndërkombëtarë e bënë të qartë se privatizimi dhe zhvillimi i iniciativës së lirë private dhe ndërmarrësisë është në lidhje interaktive me zhvillimin e demokracisë, ekonomisë së hapur dhe shoqërisë civile dhe se privatizimi në shkallë të gjerë i ndërmarrjeve të Kosovës do të ishte strategjia kryesore ekonomike e projektit të ndërtimit të shtetit.

Ndërmarrjet e Kosovës operonin në një gamë të gjerë sektorësh, duke përfshirë këtu: minierat, bujqësinë, prodhimin e ushqimeve, përpunimin e metalit, materialit të ndërtimit dhe industritë e tjera. Procesi i privatizimit nuk u është nënshtruar shumë analizave. Pyetja se pse nisi privatizimi i menaxhuar nga ndërkombëtarët mbetet pa përgjigje. Mënyra se si u krye, mbetet pa u shpjeguar, dhe niveli i përgjithshëm i suksesit të tij gjithashtu i ka shpëtuar analizës. Ndërkohë në Kosovë nuk është përmirësuar situata ekonomike dhe sociale për 44% të popullsisë, që jeton në varfëri. Shtrohet pyetja: A do të ndërmarrë masa Qeveria e Kosovës dhe cilat do të jenë masat që do të ndërmerren kundër kompanive që nuk i kanë përmbushur kushtet e parapara me kontratën e shitblerjes gjatë procesit të privatizimit? Sepse, në Kosovë u privatizua pasuria e këtij populli të shumëvujtur, situata ekonomike dhe sociale e të cilit, pas këtij procesi, vetëm sa u rëndua, e aspak nuk u përmirësua.

Nëse privatizimi si proces ka qenë i dështuar, Qeveria është dashur ta ndërpresë ose ta analizojë dhe të gjejë formatin e përshtatshëm, e jo të vazhdojë ta privatizojë ngutshëm edhe pasurinë publike, siç është Posta, e cila i sjell këtij buxheti miliona. Një ndërmarrje privatizohet vetëm nëse ajo nuk është tërheqëse për sektorin. Duket sikur ky proces nuk ka pasur asnjëherë diskutim për qasje ekonomike alternative. Edhe pse nuk është bërë asnjë vlerësim gjithëpërfshirës deri më tani i ndikimit ekonomik të privatizimit në Kosovë, dëshmitë në dispozicion tregojnë se procesi ka ndikuar më shumë në kufizimin e

potencialit socio-ekonomik të Kosovës, duke ngushtuar mundësitë e funksionimit të ndërmarrjeve dhe duke i transformuar ato në para të vlerës së ulët dhe duke i bllokuar punonjësit që të mos punojnë në pritje të privatizimit dhe duke mos u ndihmuar për punësim ose mbrojtje sociale pas privatizimit. Po e marr një shembull konkret, privatizimi i Fabrikës së Gomës Kimike “Ballkan” të Suharekës, e cila pas luftës, deri në vitin 2006, i kishte të punësuar 860 punëtorë. Ajo u shit me spin off special, me një çmim përbuzës 1,4 milion euro, edhe pse ishte njëra ndër tri objektet më të mëdha të Kosovës, pas “Trepçës” dhe “Ferronikelit”.

Kompania turke, e cila e bleu “Ballkanin”, nuk e përmbushi asnjë kusht të paraparë me kontratën e shitblerjes. U referohem informatave nga ish-punonjësit e kësaj fabrike. Sipas tyre, ajo nuk e punësoi numrin e paraparë të punëtorëve, përkundrazi prej 860 punëtorëve, sa i kishte në vitin 2006, numri u përgjysmua në 375, prandaj po shihet që nuk ka punësim, por largim. Nuk bëri investime, por vetëm shkatërrime. Prandaj, këta punëtorë me plot të drejtë në vazhdimësi kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që të shikohet mundësia e rishikimit të kontratës së blerësit, i cili nuk i përmbushi kriteret sipas marrëveshjes. Të rikujtoj, kjo fabrikë para luftës kishte 1 800 punëtorë.

Duket sikur privatizimi në Kosovë ka çuar në humbjen e vendeve të punës. Sindikata e Kosovës ka përlogaritur se 70 000 punëtorë kanë mbetur pa punë, pa pensione dhe pa asistencë sociale për shkak të privatizimit. Në nivelin e ekspertëve të pavarur, ai përshkruhet si një katastrofë, pothuaj si një dështim i plotë dhe si një dështim ekonomik. Argumenti se privatizimi ishte i nevojshëm për ta shmangur degradimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe për ta mbrojtur të mirën e përgjithshme të Kosovës, nuk duket bindës para stagnimit dhe rënies pas procesit të privatizimit. Diskutimi im të mos të kuptohet se unë jam kundër këtij procesi. Unë jam kundër formës, kundër mënyrës dhe vlerës me të cilën u privatizuan ndërmarrjet tona. Sepse, kemi shumë rrethana favorizuese ose faktorë stimulues për zhvillimin e ekonomisë private. Ekzistojnë resurse humane, popullsia e re me një nivel të lartë të arsimimit, relativisht, mendoj të kënaqshëm, sidomos në kushtet e organizimit të formave plotësuese të edukimit për biznes. Edhe pse, përveç atyre që i ceka më lart, ekzistojnë edhe shumë faktorë jofavorizues, siç është mungesa e çfarëdo mbështetjeje të organizuar financiare për zhvillimin e ndërmarrjeve private, zhvillimi i ekonomisë private në Kosovë është rast shumë i rrallë, thuajse pa kurrfarë kredie, pra duke u mbështetur krejtësisht në mjetet e ndërmarrësve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministri Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar, të nderuar deputetë,

Dua të flas pak për periudhën sa isha kryeministër, sepse në atë kohë edhe pati filluar privatizimi. Janë edhe disa ministra që kanë qenë në atë kabinet. Pra ka filluar me Rregulloren 2002/14 të UNMIK-ut nga Departamenti Ligjor në Nju-Jork dhe është gjetur një formë kur Kosova nuk e ka pasur të definuar statusin e vet dhe është gjetur një model që UNMIK-u ta udhëheqë këtë proces. Dhe, në organizim, udhëheqësi i Shtyllës së Katërt e ka menaxhuar në përgjithësi dhe kanë qenë dy drejtorë: njëri për ndërmarrje shoqërore, tjetri për ndërmarrje publike. Ndërmarrjet shoqërore që e kanë filluar privatizimin kanë

qenë të udhëhequra nga ish-ministri i Financave, Ahmet Shala, ndërsa ndërmarrjet publike i kanë udhëhequr fillimisht ndërkombëtarët, e më vonë Ilir Salihu.

Megjithatë, ndërmarrjet publike nuk janë lejuar qysh në atë kohë të privatizohen deri të definohet statusi i tyre, sepse i kanë përzier konceptet nganjëherë: çka është ndërmarrje shoqërore, çka shtetërore e çka publike. Pra, ka pasur dilema edhe për ta. Realisht, a është dashur të privatizimi? Privatizimin është dashur. Unë nuk jam ekonomist, por në atë kohë kam qenë në rrjedha. Edhe në kohën e aparteidit... (*Po, po, zoti profesor, i di do sende nga pak, mund të qeshësh sa të duash*)... edhe në atë kohë ka qenë një ekonomi e centralizuar, kur gjatë kohës së Milosheviqit, shumica kanë filluar të degradohen, sidomos ndërmarrjet e mëdha dhe janë bazuar në tregun e Kleringut, i cili po ashtu ka shkuar dhe këto ndërmarrje është dashur të orientohen. Jo vetëm që thuhet degradim, se nuk është ditur kush është titullar. Diku në disa ndërmarrje janë organizuar punëtorët, kanë punuar diçka, dikush ka dhënë me qira, nuk ka pasur llogaridhënie dhe ajo politikisht më me rëndësi ka qenë se këto ndërmarrje është dashur të kenë titullar dhe titullarin me privatizim. Na para 2-3 ditëve e patëm një fletëpadi të Vulinit, që të mos privatizohet Posta, për arsye se ende pretendojnë që ata janë pronarë të këtyre ndërmarrjeve.

Prandaj, këtu ka qenë një zgjedhje, pos tjerash, pos arsyeve tjera, që t'u dihet titullari. Në momentin që me atë rregullore privatizohet, qoftë privatizim i mirë a i keq, ai e ka titullarin dhe mund t'i bësh sa duash padi, që nuk pinë ujë. Dhe, a ka qenë privatizimi i mirë? Asnjë privatizim nuk ka qenë i mirë. Janë marrë si model Sllovenia dhe Çekia. Sllovenia është menduar si më e mira që i ka mbrojtur sa ka mundur ndërmarrjet publike, por tash ka ra në krizë, po shihet që ka qenë investim i shtetit edhe nuk ka qenë ndoshta modeli më i mirë. Prandaj, nuk ka model perfekt, por privatizimi duhet të vazhdojë. Tash është gati kah faza përfundimtare. Ndërmarrjet shoqërore janë në procesin e likuidimit, sepse shumica e tyre veç janë privatizuar, dhe mbeten ndërmarrjet publike, për të cilat megjithatë është fituar e drejta që nëpërmjet ligjeve tona dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit të bëhen ofertat dhe të privatizohen. Unë nuk dua të hyj në atë se çka apo tek? Ka pasur edhe atëherë propozime që ekspertët e ekonomisë duhet t'ia caktojnë vlerën një kompanie për ta shitur. Por, vlerën e cakton vetëm tregu se sa ofron, e jo sa ia cakton ti. Prandaj, në lidhje me këtë, deri në fazën e pavarësimit të Kosovës, komplet përgjegjësinë për privatizim e ka pasur UNMIK-u - Shtylla e Katërt. E njihni edhe kohën e të famshmes Maria Fuçi, e cila as rregulloren që ka qenë në fuqi nuk e ka respektuar dhe ka dashur ta ndërrojë në dëm të Kosovës. Prandaj, kanë qenë ato konflikte, nuk ka qenë ai konflikt personal, por ka qenë konflikt për një parim.

Dhe, tash, sigurisht që duhet ta presim ofertën më të mirë dhe, siç e tha edhe një parafolës, jo a ka alternativ tjetër, por nuk ka, privatizimi nuk ka alternativë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj. Më pas, shkojmë në pauzë.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar!
Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj që nga debatet e deritanishme, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të vijë në një përfundim nga përfundimi i krejt këtij debati, për të qenë në nivelin e detyrës së tij si Kuvend dhe për përgjegjësinë që e ka.

Unë dua të flas rreth kësaj teme, duke e ndarë në dy pjesë. Po flasim për privatizimin si tërësi, ndërsa kur flasim për privatizimin, atëherë duhet ta kemi parasysh privatizimin, i cili është në kompetencën e AKP-së dhe që është bërë deri më tani dhe proceset që e presin privatizimin - ndërmarrjet publike, të cilat janë në përgjegjësinë e Qeverisë.

Besoj që këtu tanimë është e qartë për gjithë. U diskutua pesha dhe rëndësia e privatizimit. Nuk besoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të shfrytëzohet për të hedhur gisht për atë që ka ndodhur plot dhjetë vjet; kush është parë, si është parë, kush ka më shumë e kush më pak, sepse e humbim temën, dalim nga tema. Nga krejt këto që kanë ndodhur deri më tani, një gjë është e qartë: Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka obligim me ligj, e ka obligim edhe para votuesve të vet - menjëherë ta bëjë një komision hetimor me një agjendë të qartë për ta analizuar procesin e privatizimit nga e para deri në fund dhe një herë e mirë t'i heqim nga rendi i ditës të gjitha dilemat, dyshimet dhe problemet për të cilat besojmë që e kanë karakterizuar në të kaluarën.

Me një analizë të tillë, që ky komision do të angazhonte ekspertë, me një fond të përcaktuar më herët, ne do ta kemi të qartë, në aspektin profesional, do t'i raportohet Kuvendit se si ka shkuar ky privatizim deri më tani dhe kështu e mbyllim një kapitull, si dhe nxirren përfundimet. Kjo është detyra e Kuvendit. Nuk është detyrë e Kuvendit për të hetuar dhe për akuzuar. Këto janë punë që bëhen diku tjetër. Vetëm kështu ne mund ta heqim nga rendi i ditës dhe vetëm kështu nuk e lejojmë të manipulohet me procesin e privatizimit. Vetëm kështu mund të vijmë në një përgjigje meritore: A ka qenë i mirë privatizimi, si ka shkuar privatizimi, a janë plotësuar kontratat?

Me vetë faktin që kontratat e “Ballkanit” të Suharekës, “Sharrcemit” dhe “Ferronikeli” janë të dyshimta dhe nuk janë plotësuar deri në fund, obligimet që i kanë marrë investitorët nuk i kanë përmbushur, kjo e parashtron nevojën e këtij komisioni, për të analizuar a janë përmbushur kontratat, apo jo? Si janë përmbushur, si është privatizuar dhe në fund pastaj ky Kuvend t'i rekomandojë agjencisë përkatëse për të marrë masa. Dhe, vetëm kështu ndihmohen investitorët, ata që thirren te investitorët, dhe vetëm kështu tregohemi seriozë ndaj atyre që janë të interesuar për të ardhur e për të privatizuar në këtë vend. E nëse vazhdojmë kështu të mbajmë tema të vazhdueshme, unë jam i bindur që edhe ata që e mbrojnë privatizimin kështu me çdo kusht, por edhe ata të cilët kanë rezerva, nuk e ndihmojnë investitorin e huaj për të ardhur këtu. Përkundrazi, e frikësojnë.

Prandaj, kërkoj nga ky Kuvend që të formohet një komision me një fond të caktuar dhe të angazhohen ekspertët për ta analizuar procesin e privatizimit që ka qenë nën mbikëqyrjen e AKM-së, e deri më sot.

Çështja tjetër për të cilën unë dua gjithashtu të diskutoj është çështja e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Kjo përsëri është një temë tjetër. Ne nuk po flasim më për atë çfarë

ka ndodhur. Tash po flasim për atë çka mund të vijë. Atëherë, mendoj që këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Po ashtu, nuk është beteja pozitive-opozitive, kush po fiton. Një herë në këtë Kuvend është mirë që të shohim si deputetë se cili është interesi i këtij vendi dhe të flasim mbi bazën e interesit nacional të vendit, e jo mbi bazën e agjendave ditore politike. U tha këtu se kurrkush nuk është kundër privatizimit; kur duhet të privatizohet, pse duhet të privatizohet tash? Na thoni prioritetet që na çojnë në nevojën e privatizimit të PTK-së, për shembull? Cila është nevoja, sepse nëse kemi nevojë duhet ta bëjmë. Po privatizohet Posta. Për çka? Ku do të shkojnë ato të holla? Ku do të investohen? Arsyetoheni!

Unë kam pritur nga ministri që sot do t'i nxjerrë prioritetet, sepse nuk ka privatizim pa prioritetet. Po e privatizojmë këtë sektor për këto arsye, benefitet janë këto. Jo fjalim politik. Unë mendoj që këtu duhet të caktohen prioritetet. Kam pritur që ministri do të thotë: "Po, duam ta privatizojmë Postën, sepse kemi vendosur ta ndërtojmë një termocentral 200 MW të Kosovës në Obiliq, sepse na duhet energjia dhe 200 MW, e s'po kemi financime, sepse Banka Botërore po heziton, sepse është bërë histori Kosova e Re, është bërë sikur Ura e Fshejtë, dhe për këto 200 MW na duhen 300 milionë euro. 300 milionë euro Kosova nuk i ka, prandaj duhet ta privatizojmë Postën". Nuk besoj që njeri normal që do të ishte kundër, sepse nga një privatizim po shkojmë në një investim.

Në vend që të flasim për prioritetet, kam përshtypjen që nganjëherë po e humbim objektivin tonë, prandaj duhet të caktohen prioritetet dhe interesat nacionale njëherë e mirë për këtë vend. Nuk kemi asgjë tjetër, bujqësia, energjetika, mineralet janë mundësitë tona për të ecur përpara. Në qoftë se këtu nuk jemi të kujdesshëm, ky vend do të ketë probleme të mëdha.

Unë mendoj që debati duhet të zgjerohet, jo vetëm në Parlament. Ftoj, bëj apel për profesorë, ekspertë, inxhinierë, analistë të këtij vendi që të mos heshtin. Të ndihmojnë me idetë, me mendimet e tyre, me debatet e tyre për të gjetur rrugë më të mira drejt zhvillimit ekonomik të këtij vendi. Vetëm kështu ne mund t'i realizojmë objektivat tona. Përsëri po pyes - pse duhet të privatizohet? Ka ekspertë që mund të na japin përgjigje, le të japin argumentet, mund të na bindin. Unë sot nuk dëgjova asnjë argument pse duhet të privatizohet Distribucioni? Na e argumentoni me akte pse, pastaj duhet menduar e shikuar që ndoshta është me interes të privatizohet. A është vlera reale? Ne mund të jemi njerëz të painformuar në këtë çështje. Urdhëroni, ndihmona! Mund të japim edhe vlerësime të gabuara. Për atë janë njerëzit adekuatë, ekspertët që mund të na japin mendime, të na ndihmojnë që ta evitojmë ndonjë analizë të gabuar. Sepse, ne nuk jemi të gjithë ekspertë të ekonomisë. Ne presim, dhe unë e kuptoj atë transparencën që u përmend nga parafolësit e mi, që deri në fund të hapet debati.

Nuk është mirë që me pasurinë e Kosovës të bëhet garë, kush kënd po e mund me votë. Jo veç për pasurinë e Kosovës, por për interesa nacionale nuk është mirë të bëhen aso garash. Kemi mënyra tjera që të bëjmë garë të politikës ditore. Prandaj, edhe ata të cilët thonë 'kush është kundër privatizimit', këto klishe dhe këto pallavra më kurrkush s'i ha. Lëri më këto! Lëri më këto, se po ia nisim me frikën ndaj Serbisë, duke u frikësuar se Serbia po çon letra, e deri te Çavezi, se po bëhemi si Çavezi. Këto pallavra më nuk i ha

pazari. Lërimi më këto pallavra. Ne jemi njerëz të pjekur. Jemi njerëz që i marrim vesh këto gjëra. Nuk mund me këto klishe ta mashtroni masën.

‘Vulini i Serbisë ka çuar letër!’ Para se ta përmendësh letrën e Vulinit, ku janë paratë e privatizimit? Për çka paratë s’i kemi ne? Pse s’i kemi paratë e asaj që është privatizuar deri tash? Ku janë paratë e privatizimit, e ju e dini se ato para nuk guxojnë të preken për shkak se Serbia bën ankesë. Nesër mund të ndodhë edhe me Postën. E shesim, gjysma e parave, ose 90% e atyre parave mbeten aty, pa u prekur. ‘Jo ndërrohet pronari’. Po, do të vijë ai “Ballkanit” të Suharekës, e ka marrë fabrikën, por paratë nuk i kemi. Ai do të fitojë patjetër këtu. Edhe ai që e merr Postën, do të fitojë, por ato para të Postës është rrezik të mos i marrim fare ne. Flitni për ato, jo për letrat e Vulinit. Edhe kjo tema për të frikësuar njerëz, mendoj që është e paqëndrueshme, sepse është sa për të ikur prej temës, prej interesit nacional, prej temave qendrore. Nuk mendoj që është mirë sot të futet në asnjë privatizim pa e ditur ku do të investohet. Unë kështu e shoh.

Histori! Unë pres prej ministrit të Ekonomisë, si ekspert i ekonomisë, të na flasë për çështje ekonomike, e jo për politikë, se për politikë s’mund të na e kalojë neve. Politikanë jemi ne. Edhe s’duhet të na injorojë. Unë pres të na japë ekspertizë ekonomike. Në vend që të angazhoheni dhe të harxhoni energji për shitjen e Distribucionit, edhe të PTK-së, ju duhet të harxhoni energji dhe sa më shpejt të fillojnë themelet e termocentralit 200MW, ose 300 MW të këtij vendi, të shfrytëzohen mundësitë tona, burimet tona natyrore, për t’i kthyer në fuqi këtë vend, në fuqi energjetike. Kjo është ajo që është në interes të këtij vendi, e kjo mund ta ndihmojë pastaj edhe privatizimin, edhe investimin, edhe zhvillimin e këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nëse jemi dakord, e bëjmë një pauzë, deri në orën 15:00.

* * *

(Pas pauzës, seanca i vazhdon punimet në orën 15:15.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Për ta analizuar se cila ka qenë puna e deritashme e institucionit, i cili ka qenë përgjegjës që të jetë në krye të procesit të privatizimit në Kosovë, mendoj që duhet të shikohet se cili ka qenë qëllimi i proklamuar publikisht i institucionit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më herët Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe më pastaj ta krahasojmë me realitetin dhe me atë çka ka ndodhur në të vërtetë.

Po të shikohet se cili ka qenë misioni i këtij institucioni, atëherë në dokumentet e tyre lexojmë kështu, bile edhe në faqen zyrtare të Agjencisë. Po citoj cili është misioni i agjencisë: “Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është themeluar për të ruajtur apo për të shtuar vlerën, qëndrueshmërinë afariste dhe qeverisjen e përbashkët të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë”. Domethënë, me fjalë tjera, më së paku për ta ruajtur

vlerën që e kanë reale e me qëllim që edhe për ta shtuar atë, në mënyrë që çka do që të ndodhë, sikur një ndërmarrje publike të vazhdonte të ishte publike, sikur po të vendosej të privatizohej, ajo që do të fitonte më së shumti të ishte Kosova, publiku dhe qytetarët e saj.

Mirëpo, shtrohet pyetja, sa është ky mision i proklamuar i AKM-së në përputhje me atë që ndodhi pastaj, me atë që e kemi tash si realitet? Unë mendoj që ky mision i AKM-së është në shpërputhje me qëllimin e saj të proklamuar. Sot, dhjetë vjet më vonë, kjo agjenci ka arritur që nëpërmjet 56 valëve të privatizimit në Kosovë, të shesë gjithë pasurinë dhe potencialin ekonomik të Kosovës, që e kemi ndërtuar për gjenerata me radhë dhe pas 56 valëve janë shitur mbi 400 ndërmarrje, për 600 milionë euro gati, më pak se 600 milionë euro.

Dhe, në vend që këto para të vihen në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, apo të shërbejnë për zhvillimin e Kosovës, ato janë plasuar jashtë vendit dhe i shërbejnë më shumë bankave e vendeve tjera sesa zhvillimit ekonomik të Kosovës. Dhe, kjo ka qenë një gabim, për arsye se nuk është konceptuar mirë.

Shihet qartazi pra, që ndërmarrjeve tona shoqërore dhe publike, kjo agjenci nuk ua ka ruajtur vlerën e vërtetë, si dhe nuk ka investuar shumë në qëndrueshmërinë e tyre afariste, pra që ato të bëhen gjithnjë e më profitabile, por qëllimi ka qenë vetëm tjetërsimi i shpejtë i pronës, si dhe zhvleftësimi i këtyre asetëve.

Prandaj, shtrohet pyetja, cili është rezultati, sepse, një politikan apo një institucion, apo një agjenci, apo cilado qoftë nuk matet me qëllimet dhe me premtimet që i ka bërë. Ne po dëgjojmë që të gjithë politikanët janë për zhvillimin e Kosovës, të gjitha janë për sovranitetin e Kosovës, të gjithë janë për ta bashkuar veriun e të tjerë, mirëpo puna e një politikani dhe e një qeveritari dhe e një institucioni matet me rezultatet që i ka prodhuar, efektet konkrete.

Dhe, unë mendoj që sa i përket privatizimit, dy kanë qenë efektet kryesore. E para zhvlerësimi drastik i vlerës së ndërmarrjeve deri në shpronësim, si dhe e dyta, pasurimi marramendës i atyre zyrtarëve politikë që kanë qenë të përfshirë në korrupsion dhe që kanë pasur të bëjnë me privatizimin dhe që kanë qenë në krye të këtij procesi.

Çdo ndërmarrje shoqërore, sidomos ato prodhuese me potencial na e dëshmojnë këtë dështim të AKM-së, duke u nisur që nga “Sharrceci” e deri te Fabrika e Tubave. Secila prej tyre është shitur me çmime qesharake, do të thosha, nëse e krahasojmë me vlerën e tyre reale, ndërmarrjet janë zhvlerësuar deri në shpronësim dhe në vend që të fitojë shoqëria dhe qytetarët, më së shumti është vërejtur që janë pasuruar politikanët prej këtij privatizimi të egër.

Në vitin 2000, në një raport të një instituti “Riinvest”, që quhej “Ndërmarrjet shoqërore, transformimi si dhe privatizimi i tyre” - vlera e ndërmarrjeve tona vlerësohej 3 miliardë e gjysmë marka gjermane, që do të thotë hiç më pak se 2 miliardë euro të sotme. Vlera e kapitalit fiks të ndërmarrjeve pra ka qenë jo më pak se 2 miliardë euro, derisa qeverisjet e

deritanishme e kanë shitur pothuajse gjithë ekonominë tonë për 600 milionë euro. Pra, me këtë proces të privatizimit ne kemi shitur këto ndërmarrje për as 30% të vlerës së tyre reale. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që pasuritë tona dikush me qëllim i ka zhvleftësuar fort edhe me siguri, që jo pa ndonjë pazarllëk që e kanë bërë. Tash puna për këtë pazarllëk, për të zbuluar se kush ka përfituar prej kësaj, i përket drejtësisë, mirëpo unë pajtohem këtu me kryeparlamentarin, i cili në fjalën e tij më herët tha se problem është edhe me drejtësinë në këtë vend, sepse ata pikërisht që e kanë zhvatur pasurinë publike, janë ata pikërisht që edhe po e kontrollojnë drejtësinë. Dhe, rezultatet janë këto, përveç shkatërrimit total të potencialit dhe të perspektivës ekonomike të Kosovës, u lanë pa punë mbi 80% e të punësuarve në këto ndërmarrje. Domethënë, kemi pasur dhjetëra mijëra punëtorë që kanë punuar në të kaluarën në këto ndërmarrje dhe rreth 76 000 persona kanë mbetur pa punë pas këtij privatizimi të egër, në këtë mënyrë se si është konceptuar edhe nga UNMIK-u edhe nga kjo Qeveri, sepse po e vazhdon me të njëjtin avaz.

Ky potencial i zhvillimit industrial është shndërruar kryesisht në depo apo në basene për t' u larë fëmijët, kurse struktura e ekonomisë së Kosovës, e cila është ndërtuar për dekada me radhë, prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, është kthyer përmbyës.

Nëse asgjë, për më shumë këto fakte tregojnë qartazi se privatizimi nuk ka shërbyer si mjet për ta ruajtur apo shtuar vlerën e qëndrueshmërinë afariste, siç thuhej në qëllim të institucionit. Ky proces i karakterizuar nga një korrupsion i përmasave të paimagjinueshme ka shkaktuar varfërimin e shumicës së qytetarëve e sidomos të atyre familjeve, të cilët i kanë pasur punëtorët dhe e kanë humbur vendin e punës dhe pasurimin e pak personave, një elite të ngushtë politike, shpronësimin e publikut, si dhe përfitimin e disa individëve.

Ky privatizim i këtij lloji, pra në vend që të ndërpritej ashtu që t' i hapej rruga drejtësisë, për t' u hetuar se çka ka ndodhur në të vërtetë, vazhdon ende me qëllim që edhe këto pak asete që i kemi, këto që na kanë mbetur e të cilat janë të karakterit strategjik për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës, po i qesin në shitje, po i devalvojnë, për t' i shitur krejtësisht lirë, për të mos thënë që po i japin falë krejtësisht.

Janë zhvleftësuar pra ndërmarrjet qëllimisht, nga të deleguarit e Qeverisë nëpër bordet e këtyre ndërmarrjeve, të cilët janë të kontrolluar prej subjekteve politike, e sidomos prej partisë në pushtet. Zhvleftësimi në këtë rast është metoda, shpronësimi i publikut është qëllimi, kurse privatizimi është emri prapa të cilit fshihen këta qeveritarë. Pra, ndërmarrjet që duhet të jenë në funksion të pasurimit të buxhetit, të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit për qytetarët e kësaj republike, janë shndërruar në mjet për pasurimin e pushtetarëve. E po dua të them që ky nuk është privatizim fare, bile as privatizim nuk është, se privatizim nuk është veç t' ia ndërrosh veç statusin pronës. Kurrkund privatizimi nuk është qëllimi themelor i privatizimit, po e marrim një pronë shoqërore dhe po ia japim dikujt. Se në atë pronë më përpara ka punuar dikush, ajo pronë është ngritur me dhjetëra vjet me djersën e dikujt, dikush ka ndarë kontribute me dhjetë, për tridhjetë vjet me radhë kanë nda kontribut, që ajo ndërmarrje të forcohet dhe të ngritet, dhe në fund të thuash që privatizim është pa kurrfarë kriteri, vetëm t' ia japësh dikujt tjetër, një

investitori privat, kjo nuk është qëllimi edhe thelbi i krejt privatizimit. Qëllimi është ku po mbesin ata punëtorë, a po vazhdon prodhimtaria, apo qëllimi është vetëm ta zhvleftësosh ndërmarrjen, ta shesësh 1 milionë euro, një ndërmarrje që kushton 20-30 milionë euro, politikanët të marrin diçka në xhepin e tyre edhe u krye procesi i privatizimit. Kjo është totalisht gabim.

Secili shtet, që synon zhvillimin dhe rritjen ekonomike e kupton që pronësia mbi asetet strategjike, e sidomos pronësia mbi shumicën e aksioneve në këto asete është e domosdoshme për orientimin dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Dhe këtu po flas për vendet e zhvilluara ekonomikisht dhe nuk po flas as për Kinën, as për Çavezin, por po flas për vende të zhvilluara demokratike qysh është Norvegjia, qysh është Zvicra, të cilat nuk janë vende marksiste. Në Norvegji ka kompani të fortë publike, e cila funksionon edhe është profitabile. Në Zvicër po ashtu, në Slloveni po ashtu, këto nuk janë vende marksiste...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit Glauk, edhe mos u merr shumë se s'ka komunizëm, mos u merr me të, por merru me privatizimin. Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra, deputetë të nderuar,

Në të kaluarën janë të njohur modele dhe koncepte të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Nuk dua t' i përmend, se u përmendën disa nga ato, duke filluar edhe prej planifikimit centralist, modeli i cili është bazuar në Ligjin e punës së bashkuar, modele të tjera, mirëpo nuk kisha dashur të besoj që këtu kemi dallime konceptuale, sa i përket qëndrueshmërisë së ekonomisë së lirë të tregut me konkurrencë. Nuk është diçka që s'ka probleme edhe ky model i zhvillimit ekonomik.

Nuk kisha dashur t' i shtroj gjërat bardhë e zi, por t' i identifikoj me ngjyrën që e kanë. Nuk do të hyj shumë në historikun e këtij procesi, mirëpo megjithatë më lejoni me pak fjalë vetëm të kthehem pak në retrospektivë.

Ky proces ka filluar në një kohë, ku s'dua ta amnistoj askënd prej përgjegjesisë, as nuk është punë imja kjo, por ka filluar në një kohë kur institucionet vendore kanë pasur kompetenca të kufizuara. Ka filluar në një kohë, kur kjo ka qenë fushë e rezervuar e përgjegjësive të rezervuara për Përfaqësuesin Special. Sidoqoftë, edhe në atë kohë, në ish-AKM, megjithatë, ka pasur ministra të Qeverisë, që kanë qenë në AKM. Nuk dua t' i ngarkoj me përgjegjësi, se ndoshta nuk kanë mund të bëjnë më shumë për shkak të kufizimeve që i kanë pasur, por kanë qenë pjesë e AKM-së. Me transferimin e AKM-së, në AKP, ministrat nuk janë pjesë e Bordit të AKP-së. Qeveria nuk është pjesë e Bordit të AKP-së. Qeveria, por mbi të gjitha Kuvendi kanë bërë veprime pozitive. Ka pasur progres në këtë fushë, në krahasim me të kaluarën. S'po them që s'ka pasur mundësi më

mirë dhe më shumë, mirëpo janë amendamentuar, janë aprovuar ligjet, të cilat e kanë përshpejtuar kthimin e 20-qindëshit të punëtorëve nga ndërmarrjet e privatizuara. Janë aprovuar ligjet të cilat mundësojnë përshpejtimin e likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuara. Të gjitha resurset e nevojshme, edhe me staf edhe me buxhet janë siguruar për Odën e Posaçme, që të dinamizohet ky proces.

U përmend këtu vlera, të gjithë ekonomistët e dinë që vlera dhe çmimi janë dy kategori të ndryshme ekonomike. Çmimi osilon rreth vlerës, mund të jetë mbi vlerën, mund të jetë i barabartë me vlerën, por mund të jetë edhe nën vlerën, prandaj, në treg e në çmim nuk mund të ndikohet pavarësisht prej asaj se sa është vlera e një asemi.

Kisha dashur të besoj që brenda këtij Parlamenti nuk ka njerëz që kanë nevojë me dalë në mbrojtjen e të keqes. Nuk kanë arsye të dalin në mbrojtjen e të keqes. Ne nuk kemi nevojë t' i mbrojmë të gjitha problemet që kanë përcjellë procesin e privatizimit, po prona private si pronë më e qëndrueshme nuk ka alternativë.

U përmend edhe çështja e Aeroportit, edhe pse pati ngatërresa nga ata që e përmendën, e përzien pak koncesionimin me privatizimin, që janë gjëra shumë të ndryshme, ka shumë dallime ndërmjet tyre. Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" shteti është aksionar i vetëm 100%. Është dhënë një kontratë, është bërë koncesionimi i Aeroportit.

U përmend transparenca, nuk ka më shumë transparencë se sa kjo kontratë të jetë e publikuar në ueb-faqe të institucioneve. U përmend se nuk është një storie e suksesshme, nuk thanë që ndoshta s'ka ndonjë defekt, as nuk kanë ta thonë nevojë, mirëpo dëshiroj për hir të korrektësisë të theksoj, se janë mbajtur në punë 700 punëtorë të Aeroportit, me kontrata 3-vjeçare, se janë punësuar edhe 50 punëtorë të rinj, se janë angazhuar qindra tjerë punëtorë në ndërtim, se deri më rastin e privatizimit të Aeroportit, asnjë dividendë nuk ka ardhur nga kjo kompani në Buxhetin e Kosovës, nga momenti i koncesionimit.

Prej koncesionimit kanë ardhur në emër të taksës koncesionare 4 milionë në buxhetin e Kosovës. Nga viti i ardhshëm partneri privat ka obligim që t'i derdhë në buxhetin e Kosovës në mesatare rreth 39% të bruto të hyrave. Që në vitin 2012, 18% të bruto të hyrave do të vijnë në buxhetin e Kosovës, që llogaritet që do të jenë afërsisht rreth 6 milionë. Investimet janë duke u bërë sipas kontratës dhe sipas planit.

Deri më tani janë investuar rreth 41 milionë, ka për obligim terminalin e ri, që është 40 mijë metra katrorë, parkingun e ri për aeroplanë, parkingun e ri për vetura, për 1 750 pozicione, 56 mijë metra katrorë. Vendparkingun për taksi dhe autobusë 4 130 metra katrorë. Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtesa qendrore mekanike, elektrike dhe hidraulike, galeritë nëntokësore, që ndërlihen me këtë projekt.

U tha se kanë mbetur 76 000 punëtorë pa punë. Kisha pasur dëshirë të korrektohen ata që e kanë thënë këtë. Shumicën e ndërmarrjeve, ish- ndërmarrjeve shoqërore, njerëzit kanë qenë në lista të pagave, por nuk realizuar paga. Po harrojnë disa, që në ekonominë lirë të tregut, tregu është ai që fillohet nga fundi. Ne mund të prodhojmë, ne mund të kemi

pajisje, por nëse nuk kemi treg s'kemi ku i shesim produktet, prandaj, ata kanë qenë në lista të punëtorëve, nuk kanë realizuar paga.

Modeli, ne mund të themi që është mbërri një vlerë apo një tjetër, një çmim apo një tjetër, ndoshta është dashur të bisedohet, që t' i jepet më shumë rëndësi biznes-planit se sa çmimit, mirëpo modeli ka qenë ky, situata është kjo, përgjegjësi Qeveria për ndërmarrjet shoqërore nuk ka, ndërsa sa i përket ndërmarrjeve publike, jemi të fundit, bash të fundit në regjion, që jemi duke ecur në këtë proces. Unë jam për proces transparent. Jam për maksimalizim të benefiteve për shtetin, mirëpo nuk jemi duke zbuluar as rrotën, as ujën e nxehtë, se të tjerët e kanë bërë para neve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Vazhdojmë. Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për njërën nga temat më të rëndësishme për ekonominë kosovare, privatizimin, me të cilin vendi ynë ka filluar shumë vite më parë, efektet e të cilit në zhvillim nuk janë vërejtur.

Politikat e privatizimit i kemi kritikuar të gjithë, pa përjashtim, si pozitive ashtu edhe opozitive por që asnjëherë nuk kemi ndërmarrë ndonjë iniciativë për t'i përmirësuar gabimet, të cilat kanë ndodhur vazhdimisht.

Edhe viteve të kaluara, kur kemi qenë nën protektorat ose më vonë nën mbikëqyrje, janë bërë lëshime të mëdha, ku procesi i privatizimit është kryer pa strategji, pa plane dhe në mungesë të kornizës ligjore, që ka rregulluar këtë fushë. Por, tani procesi i privatizimit duhet të rregullohet dhe zbatohet në formën më të mirë, duke bërë planifikimin e duhur dhe pa u ngutur.

Mbështes nismën për privatizimin e ndërmarrjeve publike, sepse kapitali privat është mundësia më e mirë për të zhvilluar këtë vend. Por, jam që privatizimi të ndodhë pas një studimi të mirëfilltë, duke pasur një ligj për këto privatizime, si dhe të kontribuojmë në atmosferën pozitive për tërheqjen e investitorëve seriozë.

Jemi dëshmitarë për privatizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë - privatizim, për mendimin tim, krejtësisht i dështuar, shitje kjo me një çmim jo konform tregut të hapur, sikur që janë shitur rrjetet e vendeve rajonale. Prandaj, duhet të kemi kujdes në këtë drejtim.

Praktikat në disa vende rajonale tregojnë se përkundër avantazheve që ka sjellë procesi i privatizimit kanë ndodhur edhe keqpërdorime të mëdha dhe ky proces përkohësisht është ndalur për të rifilluar prapë, por duke i eliminuar lëshimet. Për shembull, kemi raste të tilla në Kroaci edhe në Slloveni.

Duhet të jemi të përgatitur për privatizim, të krijojmë një klimë të mirë të bërit biznes, si dhe të punojmë shumë, që të reklamohen asetet tona, të hartojmë strategjitë, planet dhe infrastruktura ligjore për këtë fushë dhe mendoj se rezultati në këtë drejtim nuk do të na mungojë.

Të nderuar deputetë, privatizimi i ndërmarrjeve publike, sidomos i Telekomit të Kosovës, “Valës” dhe telefonisë fikse, pa një ligj specifik, pa një analizë të mirëfilltë, kam frikë se do të rezultojë me një çmim sikur ai i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Është në interesin tonë që kapitalin publik ta bartim te një operator privat, por duhet të jemi të sigurt që ky operator i ri ka kapacitete, që ta ndihmojë Kosovën në rrjetin e zhvillimit ekonomik e jo të kontribuojë në rritjen e papunësisë. Pra, fillimisht të kryhet një analizë e thuktë, të bëhen përgatitje të duhura për oferta të leverdishme dhe sipas rregullave të tregut të hapur. Të përmirësojmë kushtet e favorshme për investitorët e jashtëm dhe në fund e kemi leverdinë tonë, me çmimet e aseteve dhe zgjidhjen e fatit të punësuarve, konform kriterëve të përcaktuara për këto ndërmarrje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Goran Marinković e ka radhën. Nuk është. Fjalën e ka ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se me të drejtë, më herët u tha që duhet t’ ju kthehemi gjërave pak më në mënyrë profesionale dhe më pak politike, më pak emocionale dhe më shumë vizionare. Dhe, dua t’ ju them edhe një herë, se reforma e sektorit energjetik, është reformë e cila ju mundëson qytetarëve tri gjëra themelore:

1. që të kenë siguri të furnizimit me energji elektrike,
2. që të kenë energji të përballueshme elektrike, dhe
3. të investohet në mjete të cilat mundësojnë ruajtjen e ambientit dhe efikasitetin më të madh të mundshëm.

Këto janë tri objektiva të strategjisë për energjinë, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe janë udhëheqës në procesin e transaksionit të Distribucionit. Dhe, për të qenë edhe më specifik, arsyet tjera janë se ne në këtë Kuvend me buxhet kemi miratuar shkurtime buxhetore për KEK-un, duke mos lejuar që qytetarët e Kosovës të paguajnë nga taksat e tyre për energji elektrike, por që të krijojmë një ndërmarrje, e cila është e vetë qëndrueshme dhe e cila mund të ofrojë stabilitet energjetik në vend. Dhe, kjo nuk mund të bëhet pa investime, dhe kjo nuk mund të bëhet pa futjen edhe të sektorit privat. Ky është besimi jonë dhe këto janë planet tona. Ne jemi të interesuar, që të gjitha ato përfitime, do të thotë, për përmirësim të infrastrukturës, reduktim të humbjeve teknike dhe komerciale, krijim të një klime më të favorshme për biznes, furnizim të qytetarëve anekënd të Kosovës dhe eliminim të gjeneratorëve në rrugë janë arsytet pse duhet të procedohet në këtë proces të privatizimit.

Edhe një herë po ju them, sepse u ngrit këtu edhe baza ligjore dhe po flas në mënyrë profesionale, jo politike, asnjë vendim i deritashëm nuk është marrë në mënyrë individuale, por të gjitha janë marrë në mënyrë të përgjegjshme profesionale, ligjore dhe politike dhe nën ombrellën e vendimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Prandaj, Kuvendi është organi suprem i cili vendos për gjëra të tilla.

E përmendët se çka përmban ky proces i transaksionit. Po përmendet dhe po luhet shumë me punëtorët. Po ju them edhe një herë, që kontratat për punëtorët janë të garantuara, sepse u referua më herët nga deputetja, që ky proces i privatizimit është i kryer. Nuk është i përfunduar, jemi në proces të realizimit të këtij transaksioni dhe Kuvendi, në mënyrë absolute mund të marrë vendimet të cilat dëshiron t' i marrë, por, këtë e kemi bërë me një vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të cilin ne kemi pasur edhe një interpelancë dhe një votim, i cili edhe një herë e ka konfirmuar një proces të tillë.

U përmend aspekti profesional i PDK-së edhe nga ish-ministra, të cilët kanë qenë në grupe të ministrave, të cilët e kanë përgatitur bazën ligjore, politike, profesionale për një privatizim të tillë. Nëse dëshirojmë që të mbetemi në gjeneratën e dytë të telefonisë, nëse dëshirojmë që të mbesim në kërcënimet e sindikatave, që do të lëshojnë aeroplanë mbi ndërtesa, nëse dëshirojmë që t'iu zgjasim edhe për një kohë të gjatë atyre përfitimet në mënyrë enorme nga një ndërmarrje e tillë, të gjithë ata, po ju them pa asnjë lloj hezitimi, janë menaxherë të këtyre ndërmarrjeve dhe sigurisht kanë shumë arsye të forta për ta ndaluar këtë proces të privatizimit, sepse janë përfituesit më të mëdhenj dhe keqpërdoruesit më të mëdhenj të një funksionimi të ndërmarrjes publike. Prandaj këto janë arsyet e vërteta, nuk janë arsyet e vërteta, sepse nuk mundet një sindikatë të dalë dhe ta mbrojë popullin. Ata mund t'iu mbrojnë interesat e punëtorëve të vet, jo të popullit, të popullit i mbron Kuvendi, jo sindikatat. Thashë, në gjeneratën e dytë.

Sigurisht, që qytetarët presin shërbime më të mira, presin shërbime më të lira, presin avancim në teknologjitë dhe kjo është rruga, të cilën neve në këtë Kuvend, me vendime të Kuvendit e kemi marrë të gjithë së bashku, për t'iu privatizuar 75% të aksioneve të kësaj ndërmarrjeje. U përmend shumë këtu vlera e ndërmarrjeve. Kisha me qenë jashtëzakonisht mirëpritës të flasin njerëzit, të cilët nuk kanë marrë pjesë në procesin e privatizimit e të cilët në ndërmarrje shoqërore kanë privatizuar, nëse flasim për vlera nominale ekonomike, po flasim në mënyrë profesionale, në vlera të kontabilitetit, ndërmarrjet qindra milionëshe i kanë privatizuar për 3-4 milionë dhe këtu janë deputetë.

Do të ishte mirë edhe ta thonë, ta thonë se ne e kemi bërë, e kemi dëmtuar shtetin, ardhmërinë e fëmijëve tanë, të miqve tanë, të nipave tanë, do të thotë, nëpërmjet këtij procesi dhe hajde ta kthejmë edhe një herë këtë proces prapa, sepse do të ishte banale, ama bash banale të themi, që dikush flet në ekonomi me bagazhin e jo njohurive për aspektin ekonomik dhe aq më pak atëherë kur flitet për vlerë të ndërmarrjeve, ku nuk merret parasysh për asnjë moment, as amortizimi moral, as amortizimi teknik. Prandaj, mendoj që këto janë teori që duhet t'iu hedhim njëherë e përgjithmonë, sepse në atë kontekst, nëse ne kthehemi te vlera nominale e kontabilitetit të ndërmarrjeve është zero. Dhe, këtu është dallimi shumë i madh.

Dhe, po ju them edhe një gjë, sepse u trajtuan çështje në baza edhe profesionale. Unë po i bëj ftesë Kuvendit, që ta identifikojë të keqen, ta luftojë të keqen. Të gjithë ata të cilët kanë njohuri për procese të keqpërdorimeve dhe nuk i denoncojnë ato, janë bashkëpjesëmarrës në këtë proces, prandaj ju lutem adresoni me emër e mbiemër, sepse këtu është vendi ku duhet të ndahet orientimi i qartë.

U përmendën ndërmarrjet e Gjakovës. Vetëm për retrospektivë pak tek ndërmarrjet e Gjakovës. Atyre ndërmarrjeve u është njohur statusi sipas kërkesës së tyre, që të mbesin shoqëri aksionare. Dhe, ama asnjë nga ato nuk është sot funksionale, mu për atë se nuk u janë nënshtruar procesit hiç, të privatizimit, por ka qenë një transformim, i cili ka qenë do të thotë i orientuar në drejtim të tillë për destabilizim të plotë ekonomik të vendit dhe normalisht, ky është dëmi i cilin u është bërë qytetarëve.

Dhe, po ju them të nderuar, mendoj që kapitali moral dhe kapitali profesional janë predispozita për t'u marrë me politikë. Dhe, po e them, që duhet t'i drejtojmë këto gjëra edhe nëpërmjet kapitalit moral edhe nëpërmjet kapitalit profesional. Faleminderit!

KRYETARI: Janë të paraqitur për fjalë edhe 17 deputetë, kjo është nën një. Nën dy, ju kisha lutur t'i përmbaheni temës për të cilën jemi duke debatuar dhe tema është shumë konkrete dhe nuk ka nevojë të etiketohen njerëzit. Ne nuk jemi kah flasim për sistemet shoqërore, jemi kah flasim për procesin e privatizimit, prandaj ju lutem të jemi në këtë temë dhe askush deri më tani nuk tha që jemi kundër privatizimit dhe kjo është e mirë. Krejt çështja është, çfarë privatizimi po duam, A po duam vërtetë ta bëjmë "rrush e kumbulla" apo po duam të bëjmë diçka të nderës për këtë vend? Prandaj, mos i jepni kahet që nuk i kanë asnjë diskutim, jepni atë që duhet. Secili le ta jep kontributin e vet. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Prona private është bazë e ekonomisë së tregut. Në shoqëritë në tranzicion është i domosdoshëm një privatizim i shpejt i sektorit publik dhe shoqëror, në mënyrë që sa më shpejt të sigurohet një efikasitet i ndërmarrjeve, pasi që shteti është treguar si një ndërmarrës i dobët. Ndërmarrësi privat është faktor i pazëvendësueshëm në alokimin e mjeteve, në mbikëqytjen dhe bartjen e rrezikut.

Privatizimi është parakusht për normalizimin tregtar të ndërmarrjeve të paprivatizuara. Shtetet e Evropës Juglindore, që tani veç janë pjesë e Bashkimit Evropian, siç janë: Hungaria, Polonia, Çekia, Estonia, Sllovenia kishin mbërri qysh herët standardet e shumicës së vendeve të OCD-së, përkatësisht pjesa e kapitalit apo sektorit privat mbërrin rreth 65-75% të bruto produktit shoqëror.

Mirëpo, problemi i të gjitha shteteve në tranzicion, posaçërisht i Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe Kosovën, nuk është vetëm procesi i privatizimit të ndërmarrjeve

shoqërore dhe publike, por ekonomia në tërësi. Prandaj, jo vetëm që kërkohet ndërrim i shpejt i strukturës pronësore, por edhe i tërë sistemit ekonomik. Ky është një proces i vështirë dhe me shumë sfida, ky proces sjell konfrontim interesash, sepse pyetja e pronësisë, përkatësisht distribuimi i pasurisë i ka implikimet e veta.

Mirëpo, përcaktimi i kriterëve zhvillimore në korrelacion me strategjinë e privatizimit rezulton me proces ekonomik pozitiv. Një numër i madh i hulumtimeve kanë treguar se ndërmarrjet private kanë një prodhimtari dhe një efikasitet më të lartë në përgjithësi, por në rastin e ekonomive në tranzicion përvojat më të reja tregojnë një efikasitet më të lartë të ndërmarrjeve të privatizuara. Këtyre ndërmarrjeve iu është dashur një kohë më e gjatë e përshtatjes në kushtet e ekonomisë së lirë të tregut, si pasojë e kohëzgjatjes ose tërheqjes nga filozofia ekonomike e ndërmarrjeve shtetërore.

Privatizimi, përveç tjerash e përshpejton edhe procesin e rekonstruimit të ndërmarrjeve e ky është faktori kyç në suksesin e tranzicionit ekonomik në përgjithësi. Por, privatizimi dhe rekonstruimi duhet të përcillen me masa të domosdoshme makroekonomike, që në rend të parë duhet të përcillen me masa financiare dhe ligjshmëri, të krijojnë kushte për hyrjen e ndërmarrjeve të reja private, të vogla, të mesme dhe të mëdha, të krijojnë kushte për investime nga jashtë, e tjera.

Kosova dhe legjislacioni i saj janë duke bërë përpjekje maksimale, që të krijojnë kushte për investime të reja të kapitalit vendor dhe atij të jashtëm. Është krijuar infrastruktura ligjore, e cila siguron të drejtat e investitorit që është kryesore për tërheqjen e investimeve të huaja.

Siç jeni në dijeni, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin nr. 03L-067 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si organ të pavarur publik, me zotësi të plotë juridike dhe si pasardhës të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Agjencia e Privatizimit i ka përafërsisht 600 ndërmarrje shoqërore. Vlen të ceket se ndërmarrjet më të rëndësishme janë privatizuar në kohën e ish- AKM-së, ndërsa në portofolin e AKP-së, tani kanë mbetur shumë asete të vjetruara të teknologjisë së vjetër, të cilat nuk prezantojnë ndonjë potencial të madh ekonomik. Kjo arsyetohet po ashtu, me faktin se ndërmarrjet shoqërore të Kosovës janë dezintegruar për më tepër se një dekadë nga masat e dhunshme.

Kosova është shtet, që ka pësuar shumë gjatë luftës dhe ndërmarrjet shoqërore nuk kanë qenë të përjashtuara nga ky proces. Andaj, kjo ka ndikuar që tregu i mëparshëm, të cilin e kanë pasur këto ndërmarrje të humbet dhe për më tepër, ato janë dominuar nga produktet e shteteve të huaja.

Siç dihet, metodat të cilat janë përdorur gjatë privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre përkatëse, kanë qenë metoda me spin-off special të rregullt, me spin off me kusht dhe me spin off special. Tek ndërmarrjet e privatizuara me spin off special nga AKM-ja janë identifikuar defektet më të mëdha, të cilat konsistojnë në para kualifikim dhe selektim të dobët të investitorëve potencial dhe eventualisht pronarëve të rinj të

këtyre ndërmarrjeve të privatizuar, që ju ka mundësuar blerjen e këtyre ndërmarrjeve dhe në disa raste edhe të individëve apo kompanive, që nuk kanë ndonjë ekspertizë të caktuar në lëmit përkatëse.

E metë tjetër e këtyre kontratave janë mekanizmat shumë të dobët të monitorimit në të kaluarën nga ish-AKM-ja, në raport me nivelin e plotësimit të zotimeve të bëra për investime dhe punësim nga blerësit.

Kjo ka rezultuar me një neglizhencë të madhe nga ana e ish-AKM-së, sa i përket ndërhyrjes me kohë, që ka qenë edhe obligim ligjor ndaj kompanive, që në vazhdimësi kanë dështuar në plotësimin e zotimeve të bëra.

Një storie suksesi në këtë drejtim është pa dyshim ndërmarrja “Sharrcem”, e cila gjatë kohës sa ishte e komercializuar ishin realizuar gjithsej 27 milionë e 800 mijë euro investime, ndërsa investimet e zotuar pas privatizimit janë 30 milionë euro dhe gjithsej 500 punëtorë.

Sa i përket procesit të 20-përqindëshit në këto katër vjet të funksionimit të AKP-së është bërë përmirësim i dukshëm dhe nëse e krahasojmë AKM-në, e cila ka shpërndarë një shumë prej 15 milionë e 600 mijë euro, gjatë mandatit të AKP-së janë shpërndarë mbi 50 milionë euro. Nga ky proces kanë përfituar gjithsej 32 758 punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, privatizimi është një proces i pandalshëm dhe i domosdoshëm për një ekonomi të lirë të tregut për rekonstruimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike për investime të kapitalit të jashtëm me një konkurrencë të lirë dhe dinamike në treg dhe së fundit, për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Faleminderit për vëmendje!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, ministrat,

Të nderuar deputetë,

Unë në fillim kisha dashur të falënderoj zotin Ymeri, kolegun tonë, i cili na e ka mundësuar që të debatojmë për këtë temë, e cila për mendimin tim, ka qenë dashur të diskutohet qysh moti, sepse është një temë që ka preokupuar të gjithë opinionin kosovar, por vetëm organet, institucionet e vendit, po më duket jo.

Unë kisha dashur ta jap një vlerësim, i cili nuk është i ri për askënd dhe nuk besoj që e kisha befasuar askënd, kur them që procesi i privatizimit ka qenë një proces komplet i dështuar dhe në këtë aspekt së paku kemi pasur edhe konfirmime direkt prej zyrtarëve të tij, që i ndjeri zoti Hasanaj, në Komision për Buxhet na ka informuar, që AKP, AKM-ja e

përparshme, më së pari ka gjetur blerësin e pastaj e ka shpallur tenderin. Kjo ka qenë një informatë, të themi zyrtare, pikërisht në Komision.

Unë mendoj që kanë qenë arsye të tilla, që i përmendi zoti Osmani sot, që të digjen edhe dosjet. Unë kisha dashur që të mos ndodhë kjo edhe në të ardhmen, që edhe ky bord i tashëm t'i djegë dosjet. Kurse, pjesa tjetër e ndërmarrjeve publike, që Qeveria po i shet, në njëfarë forme nuk pajtohem me disa që thonë që çmimi i KEK-ut apo Distribucionit të KEK-ut është i ulët. Ky është një çmim real, sepse tregu e përcakton çmimin. Por, shtrojmë pyetjen pse ky çmim të jetë i tillë në një ambient kur të gjitha parametrat flasin, që do të duhej, kostot e ndërtimit të atyre objekteve të Distribucionit janë dhjetëfish më të shtrenjta. Kjo na kthen mbrapa te një vlerësim tjetër, i cili ka të bëjë me gjendjen në të cilën ndodhet shteti i Kosovës, me mosfunksionimin e shtetit juridik, me të bërit biznes, ku rangohemi shumë poshtë dhe kjo është preokupimi ynë kryesor. Do të duhej të jetë preokupim, që për këtë moment të stopohet ky proces i privatizimit, me një optimizëm që në të ardhmen ne do të bëjmë diçka të mirë për këtë shtet, do të bëjmë që shteti të funksionojë. Në këtë mënyrë do të ngrihet vlера e çdo objekti publik.

Edhe diçka, prej përvojës sime po ju them, që e kam parë privatizimin në komunën e Therandës. Më besoni që "Ballkani" i Therandës, prej AKP-së është vlerësuar si rast i suksesshëm. Po ju garantoj që para luftës kanë qenë 2.000 punëtorë, pas luftës ka funksionuar me 800 punëtorë, sot janë 300, dhe merret si storie suksesi.

Nëse është kjo njësi matëse e stories së suksesit, vërtetë kisha pyetur çka është mossukses. Prandaj, ju kisha lutur të gjithë deputetëve, që të logjikojmë me logjikën e njerëzve, të cilët brengosen për këtë problem dhe të aprovojmë një vendim me të cilin stopohet procesi i shitjes së objekteve publike, deri në momentin kur vlerësojmë se vlера e tyre në treg do të jetë më e madhe.

Kjo vlerë momentale është shumë e ulët dhe nuk i bën hair kurrjë Kosovës nëse e shesim sot. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ju tërheq vëmendjen që janë të paraqitur edhe 14 deputetë, që të bisedojnë. Ne kohën e kemi kufizuar, është dhjetë minuta, siç e dini, por ata që kanë mundësi ta thonë fjalën e vet me më pak, janë të lavdëruar. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryesues i seancës,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuara kolegë dhe ju kolegë deputetë.

Edhe pse Kosova është vendi i fundit në Evropë, që ka filluar procesin e privatizimit, të gjithë tashmë e dimë se procesi i privatizimit, si në vendet tjera edhe në Kosovë, është parakusht për zhvillimin e ekonomisë moderne të tregut dhe të fitimit të së drejtës për anëtarësim në integritime evropiane.

Të nderuar deputetë, u fol sot shumë këtu, por edhe një herë ua përkujtoj se privatizimin nuk e filluam ne, privatizimi filloi në fund të vitit 2002, pas shpalljes së Kornizës

Kushtetuese dhe themelimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Prandaj, kushdo që ka qenë para nesh dhe kushdo që do të ishte në vendin tonë apo edhe do të vijë, do të privatizonte dhe do të vazhdonte e do të vazhdojë me privatizimin, sepse privatizimi është më se i domosdoshëm dhe ndoshta tepër i vonuar dhe se ky proces duhet të jetë i bazuar në kuadër të përshtatshëm ligjor, i cili siguron transparencë dhe llogaridhënie dhe kontributin në përshejtimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ne si deputetë të Kosovës dhe Kuvendi si institucion më i lartë vendimmarrës duhet të angazhohemi, në mënyrë që të shmangim të gjitha dilemat dhe ngecjet e mundshme ligjore në rrugën e procesit të privatizimit, gjithmonë duke kërkuar transparencë dhe llogaridhënie, si nga Qeveria, ashtu edhe nga organet kompetente, që përfundimi i këtij procesi të jetë sa më i suksesshëm.

Të nderuar deputetë, të dashur qytetarë, është mirë që sot po debatojmë në këtë Kuvend, për këtë proces sa sfidues, po aq edhe të rëndësishëm për Kosovën, por do të ishte mirë që të jemi të kujdesshëm që energjinë tonë ta shfrytëzojmë pozitivisht dhe të kontribuojmë që të ndërtojmë politika, të cilat do të shërbenin që mjetet e mbledhura nga privatizimi të shfrytëzohen për investime publike, në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, në përmirësim të jetës së qytetarit, në përgjithësi.

Privatizimi i ndërmarrjeve publike në secilin vend të botës është paraqitur si proces i ndërlikuar, prandaj i tillë është edhe në Kosovë, por kur është e nevojshme, e thanë edhe disa deputetë më herët, këto ndërmarrje duhet të privatizohen, për shumë arsye, duke pasur parasysh jo vetëm efikasitetin dhe përmirësimin e performancës, por rritjen e përgjegjësisë ndaj tregut, disiplinën dhe efikasitetin e punëtorëve, zvogëlimin e ndikimit politik e besa-besa edhe ndalimin e korrupsionit. Sepse, me kalimin e kohës është bërë më se e qartë se ndërmarrjet në pronësi shtetërore, që ofrojnë shërbime publike nuk janë në gjendje që t'i përdorin burimet e tyre në mënyrë efikase dhe të ofrojnë shërbime të kualitetit të lartë.

Të nderuar deputetë, Kosova dhe populli i saj tashmë janë përcaktuar për të ardhmen evropiane, prandaj të gjithë ata që mendojnë se duhet kthyer mbrapa me procesin e privatizimit, ju them shkurt, se nuk mund ta ndalin procesin zhvillimor dhe integruet të Kosovës dhe ju them me kuptimin e plotë të fjalës se e kanë gabim. Prosesi i privatizimit duhet të vazhdojë dhe transparenca duhet të rritet në përgjithësi për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë do të flas shkurtimisht me fakte në lidhje me privatizimin e kompanisë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji.

Para vetes i kam dy dokumente, njëri është i Institutit për Studime të Avancuara GAP-it, i cili në bazë të studimit që ka bërë, kuptohet pa i marrë materialet nga Qeveria, sepse nuk ka pasur transparencë, ka arritur të zbulojë që vlera e cila është investuar nga viti 2007 deri në 2012, kap shifrën e 55 milionë eurove. Ndërkohë, sipas zyrtarëve të KEK-ut, nga viti 1999 deri në vitin 2011, në rrjetin e energjisë janë investuar 180 milionë euro, por kjo shifër mund të jetë edhe më e madhe. Atëherë, desha ta pyes ministrin, se cila është logjika ekonomike e privatizimit të një ndërmarrjeje të tillë, ku vetë investimi është shumëfish më i madh se sa shifra prej 26,3 milionë eurosh.

Dokumenti i dytë, të cilin besoj e ka secili deputet, është nga Federata e Sindikatave të Pavarura të Elektrokosovës, e cila i është drejtuar Kuvendit dhe ka disa shqetësime, por do të merrem me vlerësimin e aseteve që kanë bërë punonjësit e kësaj ndërmarrjeje dhe do t'i lexoj.

Një trafo, thotë, për tensionin 35 kV ky rrjet ka 33 trafo, një trafo e këtij thotë kushton 1 milion euro. Duke qenë se janë mbi 7 mijë trafo, vlera mesatare e tyre është 42 milionë euro. Mbi 450 mijë konsumatorë aktiv, vlera 45 milionë euro. Rreth 21 kilometra përçues ajror dhe nëntokësor, vlera 24 milionë euro. Vetëm ndërtesa afariste e Elektrokosovës prej 10 703m² vlerësohet afërsisht 24 milionë euro.

Ka dhe shumë asete të tjera, të cilat nuk po i përmend. Pra, vlerësimi i punëtorëve të kësaj kompanie është krejtësisht i ndryshëm nga vlerësimi që është bërë në shitje. Pra, merreni me mend, vetëm trafo do ta mbulonin këtë çmim. Ministri Beqaj tha në fillim të seancës se Qeveria nuk ka përgjegjësi në këtë proces. Ndërkohë, pak më vonë, e dëgjova ministrin duke bërë avokatin e privatizimit. Ka një kontradiktë logjike këtu. E dëgjova, gjithashtu ministrin duke folur për ekonominë e centralizuar, por jo vetëm atë, por edhe të tjerë. Tani, ata që flasin për ekonominë e centralizuar, ose me të vërtetë kanë nostalgji për këtë ekonomi, ose tentojnë që t'ju hyjnë në qejf amerikanëve, të cilët po e ndjekin këtë seancë. Mirëpo, ju garantoj se ata janë më të mençur se kaq dhe e dinë mirë se për se po flitet sot. I ka dalë boja këtij argumenti, mund ta themi hapur.

Ne të gjithë jemi për ekonominë e tregut, por ekonomia e tregut nuk mund të quhet e tillë, nëse nuk funksionon ligji, pra nëse shkelen ligjet. Unë shtroj pyetjen, cili është ai treg i lirë që politikanin në shërbim të publikut, ky është koncepti i demokracisë, e bën milioner? Cili është ai treg i lirë, që i punëson personat sipas mbiemrit, e jo sipas aftësive profesionale?

Me një fjalë, ekonomia e tregut të lirë nuk e justifikon vjedhjen, plaçkitjen dhe abuzimin. Vetëm ju kujtoj se gjysma e anëtarëve të Qeverisë është nën hetime, pikërisht për shkak të procesit të privatizimit dhe dallaveve, që janë bërë me të. Vetë kreu i AKM-së, tashmë është i ndjerë, siç kemi dëgjuar nga Prokuroria, për shkak të një vetëvrasjeje, e cila gjithsesi mbetet misterioze dhe është e lidhur me këtë proces. Ndërkohë, gjatë kohës që AKM-ja përfundoi misionin dhe gjoja kompetencat do kalonin në duar të vendorëve, dosjet janë djegur dhe zyrtarët e AKM-së janë djegur. Pra, njëri është vënë kapaku me djegien e dokumenteve, tjetri tentohet t'i vihet kapaku me një vrasje misterioze.

E dëgjova këtu ministrin të na jepte leksione e definicione, se ç'është transparenca. Ne që luftojmë për transparencën, ka shumë më mirë ta dimë më mirë se ç'është ajo. Prandaj, zoti ministër, thjesht bëhuni transparent, mos na jepni leksione.

Gjithashtu, dëgjova shpesh këtu të përmendej Marksi. E shoh që ditëve të fundit keni kaluar shumë kohë duke lexuar Marks, por unë ju sugjeroj të gjithëve, të lexoni dhe ekonomistë tjerë të shquar. Ju sugjeroj të lexoni Smithin, Fridman, Rikardo, e të tjerë, me siguri do të mësoni shumë më shumë. Mbi të gjitha, do të mësoni më shumë se si dhe nga shkaktohet kriza ekonomike.

Dhe, një këshillë gjithashtu për ata që na japin leksione, nëse doni me të vërtetë të dini se si ka lindur kriza ekonomike dhe këtë ta kuptoni më lehtë, ju sugjeroj të shihni dokumentarin e Majkëll Mor, "Kapitalizmi - A love story". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nait Hasani. Nuk është këtu. Deputeti Zenun Pajaziti, nuk është këtu. E ka fjalën deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Debati që po zhvillojmë sot, padyshim se është i një rëndësie jetike për shoqërinë tonë, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë politik e social. Substancialisht, prejse ka filluar ky proces, retorika zyrtare, si e teknokratëve dhe burokratëve ndërkombëtarë, ashtu edhe e politikanëve vendorë, shumica e të cilëve madje edhe u shndërruan në oligarkë financiarë, pikërisht nga përfitimi që kanë gëzuar nga lidhja e drejtpërdrejtë me këtë proces, si qëllim themelor kanë pasur justifikimin ideologjik të privatizimit dhe dogmatizmin e postulateve doktrinare, mbi të cilat është postuluar ngrehina në fjalë. Në këtë sens, tendenca qenësore e kësaj qasjeje ka synuar shpërbërjen e çdo alternative diskursive ndaj këtij rendi të ri, përjashtimin e çdo mundësie tjetër sistematike, dhe glorifikimin e premisave normative të privatizimit, si e vërteta përfundimtare e jetës ekonomike dhe shoqërore.

Sidoqoftë, kjo logjikë e natyralizimit të proceseve ekonomike me theks të veçantë e procesit të privatizimit, çfarë është bërë në këtë mënyrë, nuk ka dilemë se ka edhe implikime të drejtpërdrejta politike. Me këtë rast, fillimisht synohet të maskohet e vërteta themelore, se vetë ky rend, në realitet është themeluar nga logjika e përjashtimit të rrethave tjera dhe në këtë mënyrë po ashtu tentohet të injorohet fakti se përmbajtësish i gjithë ky rend është së pari politik, pavarësisht se ministri thotë, të mos flasim për çështje politike, unë i garantoj se ky rend është pikë së pari politik, çështje e një konfigurimi hegjemonist, që ofron dhe jepet nga marrëdhëniet e pushtetit, nëse i kupton ministri këto qasje.

Pra, ky ligjërim ekonomik i transformuar në program politik, mëton ekspozimin e vetvetes si alternativa e vetme, me motivin se gjërat nuk kanë shans që të jenë ndryshe, përpos se konstrukt i kësaj forme aktuale dominuese.

Jam i vetëdijshëm se sfidimi i kësaj qasjeje mbetet një detyrë e vështirë, sidomos kur dihet se tashmë ky diskurs nuk është si çdo diskurs tjetër, sepse ai ka prapa vetes të gjitha fuqitë e një bote të relacioneve të fuqisë, që i ndihmon atij të jetë ashtu siç është, me qëllim që për ta bërë veten të vërtetë dhe empirikisht të falsifikuar. Por, sot më shumë se kurrë shtrohet pyetja, a janë vallë gjërat në realitet ashtu siç na i paraqet e vërteta zyrtare? A u realizuan shpresat dhe premtimet propagandistike të apologjetëve të këtij procesi, për hapje të vendeve të reja të punës, ulje të varfërisë dhe zhvillim ekonomik dhe më tepër, shtrohet pyetja: a është duke u folur për të njëjtat fakte, apo shtrohet pyetja se mos vallë vizionet e atyre që sot janë në pushtet, janë aq shumë të mjegulluara dhe të kushtëzuara nga pozicioni i tyre politik dhe ekonomik, çfarë bën që ata të mos i shohin në të vërtetë të gjitha faktet reale, që është duke i përjetuar shumica e shoqërisë, e në këtë rrafsh vlen të veçohet, sidomos shtimi i numrit gjithnjë e më të madh të papunëve, që ka prodhuar ky proces dhe në këtë mënyrë kapërthimi i shoqërisë nga një varfëri gjithnjë e më e madhe.

Prandaj, një debat substancial mbi procesin e privatizimit nënkupton pikërisht vënien në pikëpyetje, të kësaj logjike që insiston për arsyeshmërinë e pashmangshme të kësaj mënyre të privatizimit ekstrem të çdo gjëje publike, pavarësisht pasojave reale, që mund të ketë dhe demistifikimin e kësaj retorike zyrtare të inauguruar, e cila tash e sa kohë nuk arrin shpërfaq humnerën ekonomike, ku është katandisur shoqëria jonë. Kurse, arsytimi më grotesk, se ky proces duhet të vazhdojë pavarësisht krimeve dhe skandaleve, që janë pjesë inhereente e këtij procesi, pikërisht kujton arsytimet e apartçikëve, partiakë të sistemit totalitar, ku pohohej se pavarësisht dhunës totale, që atëbotë kish përfshirë shoqërinë, udhëheqësit e sistemit pohonin se nuk është me rëndësi kriminalizimi i procesit, që kemi instaluar, por qëllimet utopike. Prandaj, shtrohet pyetja- A ka paradoks më të madh, se sa një njeri që mbi pozitën e logjikës staliniste e shpallë vdekjen e Marksit? E thelbi i kësaj strukture monologjike pohon se pikërisht nuk janë me rëndësi vuajtjet e shoqërisë, aktet kriminale që ndodhin brenda saj, por qëllimet e proklamuar nga udhëheqësit e mëdhenj.

Mirëpo, sidoqoftë në këtë aspekt, vlen të shfrytëzohen edhe disa të dhëna interesante, të cilat ofrojnë një pasqyrë tjetër nga ajo që është paraqitur nga politika zyrtare. Bie fjala, po t'i referohemi një studimi të kryer në vitin 2000 nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest" për gjendjen e ndërmarrjeve, sfidat e tyre për rivitalizim të kapaciteteve prodhuese dhe për më tepër, trendet e tyre kryesore zhvillimore. Kështu, duke krahasuar gjendjen e këtyre ndërmarrjeve ndërmjet vjetëve 1999 dhe 2000, shohim se ato brenda një viti kishin shënuar rritje, sa i përket shtimit të kapaciteteve infrastrukturore nga 28%, në vitin 1999 në 35%, në vitin 2000. Po ashtu, kjo prirje spikat edhe me shtimin e numrit të papunëve, me shtimin e numrit të punësuarve aktivë, nga 18 171 menjëherë pas përfundimit të luftës, në 24 662 në vitin 2000.

Në këtë mënyrë, shihet qartë se prirjet themelore të këtyre ndërmarrjeve atëbotë ishin me tendencë të shtimit, ngase aktiviteti ekonomik në vitin 2000 në krahasim me vitin 1999, ishte dyfishuar, ndërkaq, prodhimtaria e tyre 99% ishte orientuar në tregun e brendshëm, mirëpo prirjet e tilla më vonë u shkatërruan plotësisht, pikërisht nga kjo mënyrë e procesit të privatizimit, si me shtimin e numrit të papunëve pas procesit të privatizimit, ashtu dhe duke e dëmtuar tregun e brendshëm dhe rrjedhimisht edhe potencialet e tyre

prodhuese, duke na shndërruar kështu në një vend të varur plotësisht nga konsumi e importi, si pasojë e këtyre politikave të mbrapshta të mos zhvillimit ekonomik.

Nuk ka dyshim, se procesi i privatizimit, edhe pse i anticipuar nga Qeveritë e kaluara, mori hov ekstrem në mandatin e kësaj qeverisjeje, qoftë në mandatin e kaluar apo në këtë. Prej ardhjes së saj në pushtet, kjo Qeveri qoftë në mandatin e kaluar apo këtë aktual, mund të thuhet se qëllim kryesor e ka pasur privatizimin edhe të disa ndërmarrjeve të mbetura, si Posta, KEK-u e tjerë dhe rrjedhimisht edhe shtimin e më shumë të armatës së të papunëve, që edhe ashtu e ka promovuar tash e sa kohë procesin në fjalë. Por, po të analizohet me vëmendje diskursi zyrtar i avokatëve të privatizimit në Qeverinë e Kosovës, vërehet qartë se edhe ata e dinë që ky proces nuk garanton hapje të vendeve të reja të punës dhe zhvillim ekonomik.

Pikërisht për këtë arsye, premtimi kryesor tashmë i kësaj Qeverie, nuk është më hapja e vendeve të reja të punës, por të paktën ata arsyetohen se formalisht punëtorët e punësuar aktualisht në Postë dhe KEK, apo ndërmarrjet tjera, nuk do të largohen nga vendet e punës edhe për tri deri në katër vjet pas procesit të privatizimit.

Paradoksalisht, duke gjykuar mbi këto fakte, pikërisht prodhimi i papunësisë masive ka qenë njëri nga efektet politike themelore të mënyrës se si është etabluar tek ne procesi i privatizimit. Në këtë kuptim instituuimi praktik i këtij procesi, sipas të dhënave të deritanishme, ka rezultuar me humbjen e vendeve të punës për më shumë se 70 mijë qytetarë të Kosovës. Ndërkaq, kjo humbje ka rezultuar me humbjen e mirëqenies së rreth 12.668 familjeve në Kosovë. Një gjë e tillë, po ashtu, ka ulur të ardhurat për familje dhe si pasojë ka rrezikuar shkollimin e fëmijëve dhe kujdesin shëndetësor për këto familje.

Pra, shihet qartë se procesi i privatizimit është faktori kryesor, që Kosova sot renditet e para në Evropë për nga varfëria dhe papunësia. Papunësia dhe varfëria ka adresë të qartë, e ky është privatizimi i egër.

Pra, shtimi i armatës së të papunëve, edhe pse nocioni “armatë” është i papërshtatshëm, sepse papunësia izolon, atomizon, individualizon, demobilizon dhe zvetënon solidaritetin, përben në të vërtetë dhunën strukturare të këtij procesi. Në këtë mënyrë, ky rend ekonomik nën sloganin e lirisë ekonomike e individuale, ia arrin që gradualisht t’i çmontojë edhe disa nga strukturat bazike, kolektive e sociale, si sindikatat e mekanizmat tjerë kolektivë, të cilat si mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve mund të shërbejnë si struktura adekuate të artikulimit politik alternativ ndaj këtij pushteti dominues. Si rast ilustrativ i kësaj dukurie mund të merret edhe fakti se si sot në Deçan, Istog dhe Pejë, ku janë larguar rreth 30 punëtorë, siç njofton Koha.net, kurse Ministria përkatëse për zhvillim ekonomik, ka kërcënuar me persekutim politik sindikatën dhe protestat.

Ndërkaq, në anën tjetër, pasojat psikologjike të jetuarit në këtë makinë “skëterrore”, sot vërehen edhe tek ata që kanë fatin të jenë të punësuar, qoftë në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Në sajë të presionit që shkakton papunësia tek të dytët, nxitet: frika, ankthi, demoralizimi dhe demobilizimi dhe minohet çdo aksion kolektiv, shoqëror dhe

politik, me ç'rast fati i tyre mbetet nga një fuqi më e lartë për krijimin e vazhdueshëm të tyre.

Gjithsesi, procesi i privatizimit në këtë mënyrë, përpos efekteve negative të sipër cekura në aspektin ekonomik dhe mungesës së fryteve konkrete zhvillimore, ka rezultuar me shkatërrimin e të gjitha institucioneve kolektive, që kanë kapacitet për t'iu kundërvënë kësaj makine të "ferrit", në radhë të parë shtetit tashmë, deponisë së të gjitha ideve universale, të lidhura me idenë e publikut dhe imponimit gjithkund në nivelet më të larta të ekonomisë dhe pushtetit, të një darvinizmi moral, i cili me kultin e fituesit etablon luftën e secilit kundër të gjithëve dhe cinizmin si normë të gjitha praktikave, çfarë e përfaqëson më së miri ministri i Zhvillimit Ekonomik.

Ndërkaq, si pasojë e kësaj dukurie, ky proces tek ne i ka rezultuar edhe me një abrogim të tmerrshëm të drejtave qytetare dhe politike të qytetarëve të Kosovës dhe atë veçanërisht të ish-punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore, tanimë të privatizuar. Të ndodhur në një botë pa mbështetje institucionale, të rrënuar dhe të dëshpëruar, ata më shumë se çdokush tjetër, janë viktimat kryesore të këtij sistemi të ndërtuar mbi logjikën e mohimit të drejtave themelore, sociale dhe ekonomike. Për më tepër, shumë prej tyre, madje as që kanë arritur t'i përfitojnë edhe ato pak të drejta, që i parasheh ky proces, si ajo e përfitimit të 20-përqindëshit të parave të ndërmarrjeve të privatizuar. Bie fjala, nga 81 milionë e më shumë eurove, sa parashihen, disa nga detyrimet, që institucionet kanë ndaj ish-punëtorëve, deri më tani janë paguar vetëm 34 milionë euro. Gjithsej, nga 550 ndërmarrje sa janë shitur, deri më tani që kanë rezultuar me një fond prej mbi 500 milionë euro, punëtorët nominalisht si mesatare, kanë arritur që të përfitojnë për vitet e punës, në ndërtimin e atyre ndërmarrjeve vetëm nga 500 deri në njëmijë euro.

Në këtë aspekt, kjo shtresë e shoqërisë mbeti pa mbështetje institucionale, pa mbrojtje juridike, e braktisur në rrugë dhe e zhytur mes varfërisë, rrënimit dhe qarkut vicioz të demobilizimit. Ky fakt dhe shumë fakte të tjera, që ndërlidhen me këtë proces, e shtrojnë sot nevojën më shumë se kurrë asnjëherë më tjetër, për një intervenim të menjëhershëm institucional në këtë sferë, për ta rikthyer këtë proces në favor të zhvillimit, prodhimit e punësimit e jo të degradimit, rrënimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Afrim, përkthyesit simultan po ankohen që ti lexon tepër shpejt, s'kanë shans të të përkthejnë. Xhevahire Izmaqu, nuk është. Fjalën e ka Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Pasi që po flasim për një proces, i cili është krejt në fund, unë dua t'ua kujtoj një thënie të zakonshme, të cilën e përdorin zakonisht njerëzit, që janë të shtyrë në moshë dhe të cilët nuk janë të kënaqur me zhvillimin e personalitetit të tyre. Dhe, thonë kështu: "Të isha edhe njëherë i ri, por t'i kisha mendtë e sotme".

Ndërkaq, sot do të ndalem dhe të flas lidhur me privatizimin e ndërmarrjes të Postë-Telekomit të Kosovës.

Fillimisht, më lejoni të shpreh mendimin tim se privatizimi i kësaj ndërmarrjeje nuk përbën thjesht vetëm shitjet e aksioneve të saj, por do të thotë shumë më shumë se kaq, që vendin tonë ky privatizim parashihet të jetë investimi më i lartë direkt në vendin tonë dhe përmbyllja me sukses e tij do të jetë edhe çelës për shumë investime tjera në vijim, nga kompanitë e huaja dhe vendore.

Për këtë qëllim, konsideroj se Qeveria dhe Komisioni Qeveritar i Privatizimit e kanë një barrë shumë të madhe mbi supe, që duhet ta trajtojnë me shumë kujdes.

Janë dy elemente kyçe, tek të cilat dëshiroj të ndalem lidhur me privatizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Së pari, pse është e domosdoshme të privatizohet PTK-ja dhe cilat janë efektet që pritet t'i gjenerojë ky privatizim në ndërmarrje dhe në ekonominë kosovare?

Dhe, së dyti, a është duke u kryer procedura e privatizimit në formën më të mirë, duke pasur parasysh kontekstin kosovar dhe tregun global të telekomunikacionit?

Në përgjithësi, ekziston një vlerësim dhe parim i përgjithshëm në mbarë botën, se pjesëmarrja e sektorit privat në kompanitë publike shfrytëzohet në masë të madhe në vendet në zhvillim, si mjet për stimulimin e zhvillimit ekonomik, për të cilin Kosova ka aq shumë nevojë.

Sigurisht, që Kosova si vend i vogël nuk mund të bëjë përjashtim këtu. Kosova ka adaptuar një qasje të tillë dhe privatizimi bëhet pikërisht për këtë qëllim, pra për stimulimin e zhvillimit ekonomik.

Shfrytëzimi i resurseve shtetërore për krijim të një ambienti të mirë ekonomik duhet të jetë gjithnjë synim kryesor i yni, ndërsa, menaxhimi në ndërmarrje publike duhet të bëhet vetëm në rastet, kur nuk ka zgjidhje tjetër. Kjo nuk do të thotë se shteti nuk ka kapacitet për menaxhimin e PTK-së, por që resurset shtetërore duhet të fokusohen në krijimin e një tregu mirë të rregulluar e liberal, i cili do të mundësojë konkurrencë dhe zhvillim të vlerave e prej të cilave më së shumti do të përfitojnë qytetarët e Kosovës.

Këtë që e thashë më sipër do ta argumentoj në shembullin e mëposhtëm. Përderisa PTK-ja që nga themelimi ka qenë gjithnjë ndërmarrje publike, herë me menaxhment ndërkombëtar e herë kombëtar, është folur disa herë rreth vlerës së PTK-së, që nga vitet 2006-2007. Sipas disave, që merren me ekonomi, ka qenë shumë e lartë. Me qëllim nuk do të përmend shifra, për të mos krijuar huti, edhe pse deri më tani nuk ka pasur asnjë vlerësim profesional e që është bërë publik në lidhje me këtë.

Por, në anën tjetër, asnjëherë nuk përmendet një fakt shumë me rëndësi, se përderisa numri i abonentëve, mund të mos ketë ndryshuar shumë, me kalimin e kohës një gjë ka

ndryshuar esencialisht që atëherë. Ajo është çmimi i minutës në telefoni mobile dhe niveli i përdorimit të telefonave kryesisht mobilë nga qytetarët.

Të nderuar deputetë, ky zvogëlim enorm i çmimit dhe i nivelit të përdorimit të telefonisë, do të mund të konsiderohet si një trend normal i zhvillimit të telefonisë dhe teknologjisë, por nuk duhet të harrojmë se krejt kjo ka ndodhur si rezultat i liberalizimit të pjesërishëm të tregut, domethënë futjes në treg të operatorit të dytë të telefonisë mobile.

Tani, nëse nuk jemi shumë vonë, është koha të ecim një hap më përpara, ta lëmë në menaxhim privat komplet këtë sektor, i cili megjithatë do të rregullohet plotësisht nga shteti, qoftë me anë të ligjeve apo Rregullatorit.

Ne kemi mbetur prapa rajonit në këtë proces, këtë na e dëshmon edhe fakti që ne jemi të vetmit në rajon, që nuk kemi teknologji të reja të gjeneratës së tretë dhe të katërt, të implementuara në sistemin e telefonisë sonë mobile. Kjo nuk do të arrihet duke mbajtur gjithmonë PTK-në si operatori më i madh i telefonisë mobile nën pronësinë e përhershme publike. Është koha ta ndryshojmë këtë mentalitet.

Natyrisht, që PTK ka probleme si dhe në gjithë shoqërinë kosovare. Sikur edhe shoqëria jonë edhe PTK-ja ka kaluar nëpër transformime të vazhdueshme, tani është koha për një transformim rrënjësor të saj. Trendi i tregut të telekomunikacionit tregon që me zhvillimin e teknologjisë dhe me rritjen e konkurrencës, janë duke rënë gjithnjë të hyrat nga kompanitë e Telekomit në gjithë botën.

Ne jemi vonuar mjaft, nuk bën të vonohemi më tutje në këtë drejtim. Kjo do të thotë, që shteti i Kosovës, rrjedhimisht qytetari i Kosovës, merr më shumë nga vlera e PTK-së tani se sa nëse PTK shitet pas dy ose tri vitesh. Detyrë e shtetit është të bëjë analiza të tilla dhe të veprojmë konform tyre.

Sa i përket procesit, besoj që me gjithë faktin se ka pasur kritika të ndryshme në lidhje me nivelin e transparencës së këtij procesi, jam i bindur që ky është një nga proceset më transparente të kryera ndonjëherë në Kosovë. Ata që janë të interesuar kanë mund të marrin apo të lexojnë në mjetet e komunikimit publik të gjitha vendimet e marra nga Komisioni Qeveritar i Privatizimit.

Le të mos harrojmë që Kuvendi i Kosovës ka autorizuar Komisionin Qeveritar të Privatizimit, që të bëjë privatizimin në 75% të aksioneve të PTK-së dhe të vendosë për ndarjen e Postës.

Unë, personalisht, pajtohem që Komisioni Qeveritar ka vendosur që Postën e Kosovës, së bashku me njëmijë punëtorë ta ndajë nga pjesa e Telekomit dhe t'ia trashëgojë asaj të gjitha asetet e paluajtshme deri atëherë pronë e PTK-së, si tërësi. Ky vendim ka një rëndësi të madhe. Ju me këtë rast keni garantuar funksionimin e Postës së Kosovës, e cila ka për obligim të funksionojë, qoftë edhe me humbje, në mënyrë që të ofrojë shërbimet e veta në të gjithë territorin e Kosovës, në njërën anë dhe garantuar se ajo do të funksionojë mirëfilli, pa pasur nevojë për subvencione nga shteti, në anën tjetër.

Ky vendim sigurisht që rritë edhe atraktivitetin për shitje të 75% të pjesës së telefonisë mobile dhe fikse. Konsideroj, që po ashtu kryerja me sukses e procesit të parakualifikimit dhe numri dhe kualiteti i kompanive të parakualifikuara janë një shembull i mirë se procesi është duke ecur në rrugën e mbarë.

Të nderuar deputetë, në fund ju drejtohem punëtorëve të PTK-së, një pjesë e të cilëve mund të jenë duke na ndjekur me kujdes dhe presin nga ne të vazhdojmë të marrim vendime me rëndësi për ta dhe familjet e tyre. Jam i sigurt se në PTK ka shumë punëtorë të mirë, të cilët kanë mundësuar funksionimin e kësaj ndërmarrjeje deri sot. Unë dua t'ju them të gjithë punëtorëve të PTK-së, se nuk do të humbin asgjë nga privatizimi i PTK-së, përkundrazi nga ky privatizim do të fitojë PTK, si ndërmarrje, ekonomia kosovare si dhe efektet pozitive në mënyrë direkte dhe indirekte do të ndjejë çdo qytetar i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Unë për shkak të kohës dhe për shkak të shumëçkaje, që u përsërit sot, do të ndalem vetëm në disa çështje. Në fakt, ne po diskutojmë për privatizimin, por unë do të flas vetëm për privatizimin në proces të ndërmarrjeve publike.

Çështja kryesore e privatizimit të ndërmarrjeve publike, disa prej të cilave që janë në proces, siç janë distribucioni, furnizimi dhe Postë-Telekomi i Kosovës, në të vërtetë është problem i madh dhe është çështje për t'u diskutuar.

Në radhë të parë, sepse për këto ndërmarrje publike duhet të vendos Parlamenti dhe duhet të kthehen në pronësi publike, se siç janë në situatën e tanishme, këto nuk janë në pronësi publike, janë në duart e një grushti qeveritarësh, të cilët po i privatizojnë dhe po i shesin këto për interesat e tyre, sepse kjo nuk ka se si të shihet ndryshe.

U fol këtu shumë dhe Qeveria në fakt dështoi të jep arsyet e vërteta, sepse këto ndërmarrje duhet të privatizohen. Shpeshherë kemi dëgjuar nga përfaqësues të Qeverisë se këto ndërmarrje duhet të privatizohen për arsye se nuk mund t'i bëjnë ballë konkurrencës në treg dhe ne jemi ekonomi e tregut të lirë.

Në fakt, kjo i bie se këto ndërmarrje duhet të privatizohen, sepse nuk mund të durohemi pa u korruptuar, sepse është pikërisht Qeveria, është pikërisht politika, e cila i ka shtrirë duart e gjata në të gjitha këto ndërmarrje publike dhe po i bën këto ndërmarrje shumë të politizuara dhe po e dobëson performansën e tyre.

U diskutua shumë për privatizimin dhe u tha nga shumica prej nesh, që nuk jemi kundër privatizimit, por definitivisht jemi kundër formës së privatizimit. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, shumica e aksioneve të ndërmarrjeve strategjike, siç janë Postë-Telekomi i

Kosovës dhe energjia, shumicën e aksioneve i mbanë shteti, kurse te ne po ndodhë e kundërta.

Kemi diskutuar edhe për kohën. Kemi thënë gjithmonë që është koha e papërshtatshme që të privatizohen këto ndërmarrje, për arsye se asnjëherë nuk mund të presim investitorë seriozë dhe nuk mund të presim që këto ndërmarrje të shiten me çmimin e përafërt, me vlerën e këtyre ndërmarrjeve që e kanë, pikërisht për shkak të një vale të krizave që po vërshojnë në vendet e rajonit dhe të botës.

Dhe, së dyti, për shkak të dëmtimit shumë të madh që i është bërë imazhit të Kosovës.

U fol këtu shumë se procesi ka qenë transparent dhe ka qenë në konsultim të plotë me shoqërinë civile. Unë nuk e di asnjë rast që nga Qeveria e Kosovës, në rastet e privatizimit, qoftë të ndërmarrjeve shoqërore ose publike, është konsultuar dhe janë marrë parasysh rekomandimet e shoqërisë civile.

Nëse hyni në internet dhe e shihni se çfarë flet shoqëria civile për rastin e privatizimit të “Sharrcemit”, për rastin e privatizimit të “Ferronikelit”, kontratën e të cilit nuk e kemi parë asnjëherë, për Fabrikën e Amortizatorëve, ju do ta shihni se cilat janë mendimet e shoqërisë civile dhe cili është drejtimi që po e ndjek Qeveria.

U tha gjithashtu se punëtorët i kanë sindikatat e veta dhe sindikatat të ulen qoftë në bordet e privatizimit e tjera. Unë mendoj që këtu duhet të përmendet gjithmonë se ekzistojnë dy lloje të sindikatave. Kemi një palë sindikata që i përfaqësojnë interesat e Qeverisë. Pothuaj se në secilën ndërmarrje publike ne kemi dy sindikata, sepse Qeveria është kujdesur që ta shtrijë autoritetin e vet edhe aty, edhe në autoritetin e sindikatave.

Ne kemi sindikata që i përfaqësojnë interesat e Qeverisë dhe e kemi një palë të sindikatave që i përfaqësojnë interesat e punëtorëve dhe Qeveria kur thirret në sindikata gjithmonë flet për sindikatat, të cilat ajo i ka formuar vetë.

Është shumë me rëndësi të diskutohet për rezultatin që pritet të ketë ky debat dhe unë i ftoj të gjithë deputetët e përgjegjshëm që e kanë ndonjë votë të qytetarëve të Kosovës, që sot, në fund të këtij debati, t’i votojmë qoftë rekomandimet, ose rezolutën, sepse sot e kemi shansin e fundit që ta stopojmë privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë elektrike.

1. Për shkak të çmimit shumë të ulët dhe faljes së këtij aseti që mendohet t’i bahet kompanisë “Limak&Çalik”, dhe
2. Për shkak të krijimit të një monopoli tepër të rrezikshëm që do të ketë konsekuenca negative për të ardhmen e këtij vendi dhe për të ardhmen e qytetarëve të këtij vendi.

Ky debat do të duhej të rezultojë në votimin e arsyeshëm të deputetëve që i përfaqësojnë interesat e qytetarëve të Kosovës dhe gjithashtu kërkojmë nga Qeveria që ajo ta bjerë

vendimin e Kuvendit, cili është ai vendim që Qeveria thirret që e ka për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hykmete, t'i e kreve fjalimin. Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e dorëzoja fjalën te Administrata për shkak se është akumuluar tema, por gjithsesi Aleanca parimisht nuk është kundër privatizimit, Ne nuk mendojmë që një privatizim i drejtë do të ndodhë, derisa gjysma e Qeverisë është në hetime, dhe në njëjtën kohë ne presim përfundimin e thirrjes të këtij debati se çka do të ofrohet për votim dhe gjithsesi do ta japim kontributin tonë me votim. Faleminderit shumë nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet Haradinaj! E ka fjalën deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme, paragrafi 53 thotë: “Në këto rrethana, Gjykata vetëm mund të vijë në përfundim se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njih dhe nuk i zbaton ligjet e miratuara ligjërisht nga Kuvendi”. Në fakt, Dhoma e Posaçme thjesht vazhdon ta injorojë ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj.

Procesi i privatizimit në Kosovë nisi me bazë ligjore në një nga rregulloret e famshme të UNMIK-ut, e njëjta e cila e njihje dhe ende e njih Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, si autoritet përgjegjës për privatizimin.

Në procesin e privatizimit në Kosovë ekziston një konflikt i paprecedent ligjor, si pasojë e të cilit për marrjen e vendimeve gjyqësore mund të shërbejnë baza të ndryshme ligjore. Nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk respektohet sistemi juridik në Kosovë, si pasojë as nuk pranohet AKP-ja si palë. Për disa ndërmarrje strategjike në Kosovë, institucionet tanimë nuk kanë fuqi vendimmarrëse politike, sepse rastet ndodhen në procedurë gjyqësore në Dhomën e Veçantë.

E drejta e Kosovës mbrohet vetëm nëpërmjet përfaqësimit të drejtë në gjykatë, e drejtë kjo e cila është tejet e ngushtuar ose e mohuar plotësisht për rastet e privatizimit.

Ende sot, 4 vjet pas pavarësisë, Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Ankesave të kësaj dhome veprojnë sikur të mos ishte shteti i Kosovës të mos ishte.

Përveç anomalive të panumërta ligjore, me të cilat nisi ky proces, autoriteteve ndërkombëtare, paralelizmin për një kohë të AKM-së dhe AKP-së, mbi vendosjen e legjislacionit të trashëguar nga para vitit 1999, rregulloret e UNMIK-ut, urdhëresave të EULEX-it, si dhe ligjeve të Kuvendit të Kosovës, privatizimi e shkaktoi me siguri valën më të madhe të kontesteve gjyqësore, si dhe kaosin më të madh të vendimeve, shoqëruar me padrejtësi e rrëmujë procedurale.

Procesi i privatizimit ka prodhuar konflikte civile, të cilat lidhen me: të drejtën e shpërblimit, të drejtën e kontratës së punës, të drejtën e pronës, shkelje të kontratës në dëm të punonjësve për siguri jete dhe shëndetësi, si dhe me fitimin e munguar të palëve, duke mos dhënë rezultatet e publikuara si të pritshme.

Kategoritë tipike të rasteve gjyqësore në këtë dekadë privatizimesh janë këto:

1. Rastet gjyqësore që lidhen me zbatimin e kontratave të privatizimit;
2. Rastet e copëtimit të paarsyeshëm të ndërmarrjes dhe kontestim pas blerjes;
3. Ankimim të punëtorëve për marrjen e përqindjes nga privatizimi;
4. Kontestet për rikthim të pronës pas privatizimit dhe riprivatizim dhe
5. Kontestet pronësore.

Përgjithësisht, procesi u karakterizua nga mosrespektimi i kontratave nga blerësit, privatizuesit. Në pjesën më të madhe të rasteve, pësuesit kryesorë ishin punëtorët, me ndërprerje kontrate, me ndryshim kontrate, si dhe me mungesën e investimeve të pritura.

Raste të tjera janë ato të kontestit gjyqësor me shkak copëtimin e paarsyeshëm të ndërmarrjes dhe privatizimin e pjesëve të veçanta, si për shembull Fabrika e tharjes së lëkurës u shit pas copëtimit, pa njësinë ku thahej lëkura.

Të shpeshta kanë qenë rastet e kontesteve pronësore në ndërmarrjet e privatizuara, ose ato në privatizim. Siç dihet, ndërmarrjet shoqërore i janë nënshtruar një procesi të transformimit të dhunshëm nga Serbia gjatë viteve të '90-ta. Shumë kërkesa pronësore lidhur me këtë transformim janë paraqitur në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

Përveç kësaj kategorie, kërkesa pronësore janë edhe të ish-pronarëve, prona e të cilëve ishte marrë në mënyra të ndryshme, ishte nacionalizuar, shpronësuar ose konfiskuar gjatë kohës së komunizmit.

Kategoria tjetër e rasteve është ajo e investitorëve të supozuar që kanë investuar ose kredituar ndërmarrjet shoqërore gjatë viteve të '90-ta.

Statistikat e rasteve gjatë procesit të privatizimit tregojnë për një proces sa të padrejtë, aq dhe të parregullt, e me shenja të forta keqpërdorimi:

1. Raste me ankesë në vitet 2005 - 2007 janë 90;
2. Aplikacione me rregullore të riorganizimit gjatë 2005-2006 janë 7;
3. Padi kundër vendimeve të komisioneve të likuidimit 2006-2007 janë 13 dhe
4. Ankesa të listës së punonjësve gjatë 2003-2007 janë 5 385 të tilla.

Dhoma e Posaçme deri në tetor të vitit 2007 dha vendime për 5 326 ankesa të listës së punonjësve.

Në Kolegjin për Ankesa të AKP-së në Gjykatën Supreme deri në përmbylljen e afatit për dorëzim të kërkesave u regjistruan 40 000 kërkesa. Pjesa më e madhe e këtyre kërkesave, 38 000 rezultuan të patrajuara. Vlerësohet se prej përafërsisht 2 000 ankesave të kontestueshme, 800 deri në 1 000 sosh u ankimuan në Kolegjin për Ankesa të AKP-së.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme gjatë vitit 2009 dha 668 vendime dhe 29 aktgjykime.

Në shkurt të vitit 2009, 597 raste u trashëguan nga UNMIK-u. Në vitin 2010, Dhoma regjistroi 663 raste të tjera. Po ashtu, u pranuan edhe 591 ankesa të listës së punëtorëve, përveç atyre që ishin në pritje prej 1 janarit 2010, pra plus 659 raste të tjera, si dhe 2 684 ankesa të punëtorëve. Në kohën kur po flasim, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme trajton rreth 600 padi në shkallën e parë dhe të dytë dhe mbi 2 600 ankesa në lidhje me lëndët e listave të punëtorëve.

Në fund, lind nevoja ta pyesim ministrin e Drejtësisë, Presidenten dhe Kuvendin: Si mendoni ta zgjidhni këtë barrë të padëgjuar në ndonjë vend normal të kontesteve gjyqësore dhe të rrëmujës legislative, të krijuar artificialisht nga një proces që rezultoi negativ në çdo pikëpamje? Kush kujdeset për të drejtat e mijëra punëtorëve, të cilët ende nuk i kanë marrë shpërblimet, ose janë pushuar nga puna, ose u ka ndryshuar kontrata?

Si do t'u përgjigjeni pronarëve të shpronësuar padrejtësisht, bujqve që e kanë humbur tokën e tyre, dëmtimeve të shëndetit dhe humbjes së jetës për shkak të moszbatimit të kontratës së investimeve dhe kushteve të punës?

Kush mban përgjegjësi për këtë shpërfytyrim të drejtësisë sociale, që ia dhatë dhuratë Kosovës pas luftës?

Ju bëjmë thirrje t'i jepni fund sa më shpejt kësaj gjendjeje. E drejta sot është te punëtorët, te kërkesat e tyre. Respektojeni!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Proces privatizacije na Kosovu formalno je počeo 2002. godine, donošenjem Uredbe UNMIK-a br. 2002/12, od 13.06.2002. godine, kada je ustanovljena Kosovska poverilačka agencija, a u maju 2003. godine raspisan je tender za prvu grupu preduzeća. U toj grupi bila su preduzeća, pomenuću samo neke: "Energoinvest", "Montaža Kosova" iz Prištine, fabrika kreča "Lepenac" Kačanik, Crepo ciglana "Perparimi" iz Srbije i "Ringa" u Peći.

Posle tih preduzeća, u drugoj grupi prodali su se i ostala preduzeća. Do maja 2008. godine, ovaj posao je obavljala kao što sam gore naveo Kosovska poverilačka agencija, a nakon prestanka postojanja ovog tela na osnovu Zakona, zaduženo je novo telo Kosovska agencija za privatizaciju.

Gospodo poslanici,

U procesu privatizacije, ja ne bih sada puno govorio, jer koliko je ona bila efikasna i javna, koliko smo svi mi ovde koji sedimo doprineli da se to podrži ili spreći, imamo prikazano u šiframa, a to je da se do sada privatizovano 270 preduzeća, a mi tek sada podižemo svoj glas. Ja kao poslanik i predstavnik svog naroda, moram da se osvrnem na drugim problem koji trenutno najviše muči moje sugrađane, a to je prava zaposlenih i kako ih oni mogu ostvariti.

Prava zaposlenih u privatizacijama koje se danas sprovode trebalo bi da se regulišu preko besplatnih deonica, ili kupovinom deonica po povoljnim uslovima, ustanovljenih prava na sticanje..., ili žirlnih novčanih sredstava namenjenih za kupovinu deonica. U Kosovskom procesu privatizacije, prava zaposlenih se štite kroz dela sredstava od prodaje, i to je 20% od cene koje su postignuta za neko prodato preduzeće. Nažalost, i ako odredba Uredbe 2003/13 o promeni prava korišćenja zemljišta u društvenoj svojini, daju prava svim radnicima da se nađu na listi procesa za ostvarivanje tog prava. Za ostvarivanje tog prava, je veoma mukotrpan proces za radnike srpske nacionalnosti.

U oglasima u kojima se obavljaju liste radnika kod pouke na pravo na žalbu, navodi se da se u žalbu treba priložiti pri kupovinu radnu knjižicu, ili drugi odgovarajući dokaz, overen od nadležne službe. Moramo biti, pošteno reći, ti koji imamo dokaze da neko ostvare svoja prava, ali imamo mnogo lica kojima je radna knjižica ostala, ostalo u fabrikama gde su radili, tako da za njih je veoma veliki problem da dokažu da su radnici radili u tim preduzećima, iako su tim proveli i ceo radni vek. Moram navesti primer koji kaže da lice koji je dokazalo, doneo radnu knjižicu da je radio do 2003. godine u nekom preduzeću, a onda je kasnije promenio posao, pa se zaposlio u drugu kompaniju, ne ispunjava uslove da ona uđe u deo novčanih sredstava od preduzeće gde je ranije radio.

I na kraju još bi dao neke statističke podatke, a one su veoma poražavajući, gde se može videti kako su se sredstva od preduzeća raspoređivala, tako da od blizu 100 hiljada radnika srpskih nacionalnosti, imamo samo 12 do 15% da su mogli da ostvare svoja prava na raspodelu dela sredstava koji su im zakonom pripadali. Zato moramo dobro da razmislimo kada govorimo o temi privatizacije, moramo više voditi računa o radnicima i njihovim pravima iz koje, ma iz koje zajednice da dolaze. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Privatizimi është i domosdoshëm për shtetin dhe ekonominë e Kosovës.

Në të vërtetë, Kosova është një vend si gjysmë socialist, afro 50% e pronës së Kosovës, e tokës bujqësore dhe e tokës pyjore, livadheve dhe kullosave realisht janë tokë shoqërore, e cila po e ngarkon Buxhetin e Kosovës për ta administruar dhe qeverisur atë.

Ndërsa, në të kundërtën, kjo pjesë nuk e jep kontributin e vet për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe për krijimin e mirëqenies sociale.

Deri tani thuhet se janë privatizuar rreth 50% e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore. Janë grumbulluar rreth 600 milionë të parave, të cilat janë para të ngrira, jo vetëm që janë të ngrira, por në një farë mënyre ka ndodhur edhe absurdi, sepse ato janë mbyllur në vetëbesim në financat publike të shtetit.

Në gjithë Evropën Juglindore dhe në Evropën Lindore, plaçkitja e aseteve ka ndodhur. Nuk janë shfrytëzuar realisht. Kosova ka mundur ta përvetësojë një metodë për ta adaptuar me kushtet tona dhe kjo përvojë të mos lejojë që të plaçkiten këto asete.

Përvoja e deritashme tregon se AKM-ja, AKP-ja dhe institucionet përgjegjëse, privatizimin e aseteve shoqërore dhe publike e kanë trajtuar vetëm...

KRYESUESI: Deputet, konsultimet mund të bëhen, kërkoni konsultime, po uluni tash se jemi në seancë. Ju lutem!

NIJAZI IDRIZI: ...si transaksion, nuk e kanë parë si transformim të pronës.

Qëllimi i privatizimit është transformimi i pronës për shfrytëzimin e saj me një dinamikë të re, duke ia arritur vlerën e saj, e cila mund të bëhet vetëm në duar të privatëve.

Ne nuk kemi ndonjë vlerësim të efektit të privatizimit në ekonominë tonë kombëtare. Por, marrë në përgjegjësi, sipas ekspertëve, në procesin e privatizimit, arritjet deri tani janë shumë modeste.

Është për keqardhje se disa ndërmarrje dhe institute, të cilat kanë poseduar dije të akumuluar për një kohë të gjatë e të verifikuar kanë falimentuar, ose janë në proces të falimentimit.

Edhe një pjesë e ndërmarrjeve që janë privatizuar me spin off special, për fat të keq, ato janë detyruar që të kthehen rishtazi në procesin e privatizimit, duke shkaktuar edhe një të keqe të madhe, si rasti i “Llamkosit”, i Fabrikës së Duhanit në Gjilan.

Një pjesë e madhe e tokës bujqësore shumë kualitative dhe me infrastrukturë fizike moderne ende vazhdon të mbetet djerrinë, bodrumi i “Erenikut” në Gjakovë, në Drenas, Kaçanik e të tjerë.

Kanë mbetur peng edhe 10 mijë hektarë të tokës bujqësore, te të cilat nuk është arritur të përfundojë procesi i komasacionit të tokave. Vetëm 5 mijë të tilla janë në Gjakovë, pastaj ka në Drenas, në Vushtrri e tjera.

E vetmja sferë ku mund të thuhet se AKP-ja është duke e bërë punën e vet mirë është shpërndarja e 20-përqindëshit të punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore. Rreth 70 milionë

euro tash janë në tregun e Kosovës dhe ato po krijojnë mirëqenie për aq sa është e mundur.

Në këtë kohë ne e kemi filluar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Do të ishte mirë që ky proces, meqë ka filluar tash, të shkojë në një rrugë më të duhur.

Së pari, të privatizohen kompanitë që janë barrë e Buxhetit të Kosovës, ato për të cilat ne po paguhemi.

Së dyti, të privatizohen kompanitë që nuk janë me fitime, dhe

Së treti, ato që e sjellin një lloj fitimi.

Më duhet ta them edhe një fakt: PTK-ja, megjithëse nga të gjithë po llogaritet që është një ndërmarrje profitabile, në të vërtetë ajo si të thuash është një ndërmarrje që po e ha dhjamin e vet, për shkak se kjo kompani nuk është duke i sjellë fitim Kosovës.

Rreth 50 milionë që ajo i derdh në Buxhetin e Kosovës janë një shumë tepër simbolike, për faktin se nëse e marrim parasysh debatin e organizuar në vitin 2008, ne e kuptojmë se atëherë kjo kompani, sipas debateve që e kanë bërë ekspertët, ka kushtuar prej 800 deri në një miliard euro. Nëse e bëjmë një llogari të sotme, atëherë për 4 vjet kjo kompani i ka humbur rreth 400 milionë, apo është përgjysmuar për shkak se nga optimistët më të mëdhenj po llogaritet që kjo kompani mund të shitet në një vlerë prej 300 milionë euro, që është një vlerë jashtëzakonisht e vogël.

Do të kisha dashur t'i jap disa propozime, me qëllim, nëse është e mundur të merren parasysh nga ata që do të japin dhe do të dalin në fund me rekomandime.

1. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka procesi i privatizimit për ekonominë e Kosovës, Agjencia e Privatizimit duhet të funksionalizohet dhe të menaxhohet në mënyrë shumë profesionale dhe të monitorohet me shumë kujdes nga komisioni përkatës, ose nga një komision special i Kuvendit;
2. Privatizimi i asetëve strategjike - kompanitë që janë të një rëndësie strategjike duhet të privatizohen nga partnerët tanë, të cilët i kemi partnerë strategjikë,
3. Të caktohen prioritetet e privatizimit të ndërmarrjeve, duke filluar nga ato që janë barrë e Kosovës, e janë duke shkuar nga ato që japin fitime për momentin, por që nuk e garantojnë të ardhmen në treg;
4. Të vazhdohet me privatizimin e tokës me sipërfaqe të vogla, me qëllim që të përfshihen edhe njerëzit që e punojnë atë tokë. Kjo sipërfaqe duhet të jetë prej 20 deri në 50 hektarë tokë, me qëllim që fermerët, të cilët e punojnë tokën, të kenë mundësi të kyçen në këtë proces;
5. Procesi i papërfunduar i komasacionit të përfundojë sa më shpejt;

6. Të shkrihet fondi i mirëbesimit dhe shtetit t'i lëshohen në qarkullim këto para, me qëllim që edhe ato ta japin kontributin e vet në rritjen ekonomike të Kosovës;

7. T'u paguhet sa më shpejt 20-përqindëshi edhe atyre pak punëtorëve që u kanë mbetur pa ua paguar.

Dëshiroj, në fund, të theksoj edhe faktin se protestat e sindikalistëve për privatizimin e ndërmarrjeve publike janë reale, sepse, në fakt, ato kanë frikë se një privatizim i ndërmarrjeve publike do ta ketë fatin e privatizimit që e kanë pasur edhe ndërmarrjet shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar Hamiti!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Ky debat, i cili po zhvillohet pas 11 vjetësh të fillimit të privatizimit është jashtëzakonisht me interes për qytetarët e vendit, edhe pse me vonesë.

Dëshiroj që në fillim të diskutimit tim të sqaroj para opinionit publik kosovar dhe para atyre që nuk e kanë lexuar deri në fund Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për deputetët që ishin të shqetësuar nga angazhimet e institucioneve të Republikës së Kosovës. Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë qartë: “Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës”.

Ky debat është në interesin e transparencës, në interesin e opinionit publik dhe besoj edhe në interesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Mendoj se debatet e tilla për të gjitha çështjet duhet të ndodhin sa më shpesh dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë gjithmonë aty ku kërkohet nga Parlamenti i Republikës së Kosovës. Por, më lejoni që për hir të opinionit publik të sqaroj shumë gjëra, të cilat kaluan kalimthi, apo vetëm si lajthitje gjatë këtij diskutimi.

E para, privatizimi në Kosovë ka filluar në vitin 2001, Nga formimi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, vendimet për emërimin në bord dhe për udhëheqjen e bordit e ka pasur UNMIK-u. Me shumë vështirësi nga individë të atëhershëm të UNMIK-ut, e përmendi më herët edhe ish-kryeministri Rexhep, Maria Fuchi, pastaj edhe me vështirësitë e plota dhe të fuqishme që i ka sjellë Serbia në organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Atëbotë, gjithë spektri politik kosovar e kemi përkrahur që të fillojë sa më shpejt privatizimi. Nga viti 2004 deri më 2008, anëtarë të Bordit të Agjencisë së Privatizimit ka pasur nga UNMIK-u, por edhe nga Qeveria, që përbëhej nga Lidhja Demokratike e Kosovës, AAK-ja dhe të tjera.

Nga ky moment kanë filluar që në bord të jenë edhe ministrat e Qeverisë së atëhershme, por gjithmonë vendimet apo vendimet ekzekutive i ka pasur UNMIK-u. Por, politizimi kishte filluar në atë periudhë.

Nga viti 2008 deri më 2012, pra tash kur po flasim, me futjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës qershor 2008, janë zgjedhur anëtarë vendorë të bordit, por gjithmonë edhe ndërkombëtarë.

Personalisht si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës kam vendosur që për t'i ikur ndikimit politik të mos propozohen ministra në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi i ri ishte propozuar nga Qeveria dhe është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës. Në atë kohë ishte koalicioni Partia Demokratike e Kosovës - Lidhja Demokratike e Kosovës. Ai bord është edhe sot ende aktiv.

Ky bord, sipas ligjit dhe rregullit, i ka raportuar vetëm dhe vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar çdo raport të punës vazhdimisht dhe gati në mënyrë unanime.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ekzistojnë transkriptet për të gjitha këto aprovime të raportit të punës së AKM-së në Kuvendin e Kosovës, edhe prej atyre që e kritikuan privatizimin, edhe prej vitit 2001-2004, 2004-2008, 2008-2012. Prandaj, nuk është interes të flitet për interesa politike ditore, por t'i shikojmë vendimet dhe sjelljet tona në këtë periudhë të ndërtimit të shtetit të Kosovës në të njëjtin kohë të proceseve që i kemi kaluar.

Pra, dëshiroj të theksoj edhe një herë se zot, llogaridhënës dhe përgjegjës për privatizimin nga viti 2001 - 2008 ka qenë UNMIK-u dhe Qeveria e atëhershme, nga viti 2008 deri sot është zot llogaridhënës dhe përgjegjës Kuvendi i Republikës së Kosovës, ju të dashura bija dhe bij të kombit tonë.

Ndërsa, vendimet e Qeverisë që udhëheq kanë qenë këto, me të tjerët, natyrisht që nuk janë, por që kanë qenë deputetë e nderuar, të zgjedhurit legjitim të qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa dëshiroj gjithashtu të sqaroj, sepse shumë çka u lidh me Qeverinë e Kosovës.

Vendimet e Qeverisë që udhëheq unë nga viti 2008 për procesin e koncesionimit dhe privatizimit janë këto dy: koncesionimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, ku janë bërë investime mbi 100 milionë euro. Aeroporti do të jetë prej më të mirëve në rajon, madje më i miri. Për këtë i siguroj qytetarët e Kosovës dhe jam shumë krenar.

Dhe, është vendimi tjetër, ai i Distribuimit të rrjetit energjetik dhe çmimin nuk e ka përcaktuar Qeveria, por ekonomia e lirë e tregut, siç shkruan në nenin 10 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Jo, nuk po e lexoj nenin tjetër, se e kam edhe letrën e përfaqësuesit të Qeverisë së Serbisë, të cilën e ka dorëzuar ditë më parë në Nju-Jork pikërisht kundër ekonomisë së lirë të tregut në Kosovës. Prandaj, nuk është me interes për askënd t'i përputhet agjenda, qoftë në gabime teknike, qoftë gabime taktike, nuk dua të besoj të qëllimshme. Ju faleminderit shumë!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Ju lutem, kërkoheni fjalën, mund ta merrni fjalën. Ka edhe replika pastaj, mos ndërhyri në diskutim! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Janë jo të paktë ata që përfituan në Kosovë nga toka bujqësore, përpos bujqve. E kanë pasur mundësinë të përfitojnë tregtarët, ndërtimtarët, politikanët, por jo edhe bujqit. Ke mundur të bëhesh i pasur shpejt, me pak shkathtësi. Dhe, diç e tillë është shfrytëzuar. Është shfrytëzuar në emër të zhvillimit ekonomik, duke u thirrur në parime të larta.

Për pasojë, deri më tash toka në masë të madhe mbetet djerrinë, e bujqit që do ta punonin atë mund të mbeten vetëm vëzhgues në shitjet e stërshitjet e saj, mund të bëjnë krahasime se cilës tokë i është ndërruar destinimi më shumë, apo në cilën tokë është ndërtuar ndonjë objekt më i madh. Por, të flitet se cila kulture bujqësore është mbjellë diku dhe çfarë rendimenti ka dhe të krahasohet kjo me periudhën para privatizimit, kur ndërmarrjet ishin aktive, kjo gjë nuk mund të ndodhë këtu tani.

Privatizimi është shikuar nëpërmjet prizmit të tregut, e kjo mund të jetë keqkuptim i ekonomisë së tregut dhe rrjedhimisht toka bujqësore nuk i është nënshtruar punimit për prodhim, por i është nënshtruar tregut, duke u shndërruar në plaçkë shitjeje e stërshitjeje.

Deri më tani janë privatizuar rreth 111 ndërmarrje bujqësore, me rreth 25 400 ha, nga të cilat një numër i vogël janë aktive. Dhe, disa nga këto kanë filluar të jenë aktive tek dy vjetët e fundit. Rreth ¼ nga ndërmarrjet e privatizuara u është ndërruar destinimi. Në tërë këtë proces, pati edhe raste të privatizimit që rezultuan me prodhim, por kjo në përqindje të vogël dhe falë nismave dhe këmbënguljes nga fermerët, me gjithë rrethanat e pafavorshme.

Në pyetjen e përfaqësuesit të AKP-së, gjatë monitorimit të Ligjit për tokën bujqësore, se çfarë ka ndodhur me ndërmarrjet e privatizuara pas privatizimit dhe cilat ishin kriteret e shitjes, kemi marrë përgjigje direkte: "Nuk është punë jona, ne e shikojmë vetëm ofertuesin me çmim më të lartë". Dhe, si rezultat, së pari, toka në Kosovë u është shitur atyre që e shesin e stërshesin, e jo atyre që e punojnë dhe, së dyti, toka në Kosovë u është shitur lirë atyre që e shesin e stërshesin. Çmimi mesatar për tokën e këtyre ndërmarrjeve

të privatizuara është 20,14 euro/cent për ar, e kjo mesatare është rritur në dy vjetët e fundit.

Unë mendoj se kur në përpjekjet e popullit tonë për liri, fjala “Kosova e lirë”, e që e ka përcjellë tërë kohën këtë përpjekje, ka nënkuptuar Kosovën e çliruar nga pushtuesit, kjo nuk do të thotë se ka mundur të keqpërdoret kjo, e të nënkuptohet se është çmimi i lirë i shitjes së tokës. Po ashtu, e kam përshtypjen se po manipulohet edhe me thirrjen në anglisht “Free Kosova”, e kjo nuk do të thotë Kosova “gratis” nga të tjerët.

Bujqit e Kosovës nuk arritën ta zhvillojnë Kosovën, pasi nuk arritën ta kenë tokën për ta punuar, sepse ajo u ble nga tregtarët që përfituan nga shitja.

Toka u shit lirë, duke u arsyetuar me zhvillim dhe prodhim. Dhe, kjo shitje vetëm sa e ndau prodhuesin bujqësor nga toka. Ua futi përfituesit e shitjes dhe stërshitjes në mes, e për pasojë kjo tokë sot mbetet djerrinë, duke kaluar nga një blerës te tjetri.

Dhe, AKP-ja nuk shiti tokë të importuar. E shiti tokën, e cila punohej prej shekujsh dhe e shiti duke mos pyetur fare për të kaluarën e asaj toke.

A kishte pronar të hershëm? Dhe, a mos kishte konteste gjyqësore. Dhe, kudo ku pati privatizim të tokës, pati injorim të pronarëve të vjetër. Dhe, këta pronarë të vjetër nuk janë pronarë tokash me qindra hektarë, siç mund të kenë qenë agallarët apo bejlerët nga e kaluara, por ishin familje që kishin nga 2, kush nga 3 e 4 hektarë. Këtë tokë ua mori shteti jugosllav i kohës, që e kishte Rankoviçin në pushtet. Fshatarët nuk u pajtuan, nuk e pranuan as kompensimin simbolik që u jepej me dhunë. U ankuan edhe nëpër gjyqe për tokën, por atë tokë nuk e morën. Ata nuk ia dhanë pushtetit këtë tokë, por pushteti ua mori me dhunë. Dhe, këtyre fshatarëve, pra asokohe u kishte mbetur vetëm shpresa dhe fjala që kur të forcohemi ndonjëherë dhe ta çlirojmë vendin, do t’i rimarrim këto toka. Por, ja që shteti, pas çlirimit, nuk ua ktheu tokën. Shteti i lirë madje ua solli atyre belanë me stërshitësit. Nëse ata ishin të gatshëm të luftojnë me armikun për tokën e tyre, përse të vihen tani në provë e të kenë konflikte me tregtarët e tokave të tyre. Lufta e dinjitetshme me pushtuesin shumë lehtë mund të shndërrohet në mundësi për bela të padinjitetshme me stërshitësit. Dhe, raste të tilla ka në Rahovec, Malishevë, Drenas, Kaçanik, Therandë e në tërë Kosovën, pra është e pranishme si dukuri. Dhe, prapë, e tëra kjo është bërë në emër të zhvillimit ekonomik.

Unë do të doja të shtoja se po përmendet vazhdimisht çështja e privatizimit nën spektrin ideologjik, gjoja. Por, po më intereson: ata që etiketojnë shumë lehtë në aspektin ideologjik, pse nuk çohen të flasin asnjëherë për denacionalizimin e tokës? Pse nuk flitet për tokën, të cilën ua ka marrë fshatarëve pushteti jugosllav? Pse nuk mendohet një herë t’u kthehet atyre, e pastaj të shohim për privatizimin? Ajo tokë u është marrë atyre me të padrejtë. Dhe, ata kanë të drejtë në atë tokë.

Shikuar nga pikëvështrimi i zhvillimit nëpërmjet bujqësisë, privatizimi i deritanishëm vetëm sa e ka dobësuar ekonominë dhe është bërë pengesë e shanseve për zhvillim ekonomik. Dëmi dhe mundësitë e prodhimit bujqësor dhe në industrinë përpunuese të

këtyre prodhimeve e ka lënë Kosovën shumë vite prapa. Pas luftës çlirimtare në Kosovë kishte ide nga ekspertët tanë që toka e ndërmarrjeve shoqërore bujqësore të mos privatizohej për shkak të kontesteve pronësore, por të themelohej fond i tokës bujqësore, siç e kanë shumë vende në Perëndim, e nga i cili fond toka pastaj u jepet bujqve me qira simbolike dhe kështu shteti do të mund ta subvenciononte prodhimin. Kjo ide ka qenë që të ndërtohej një fond deri në momentin e denacionalizimit të tokës. Kjo do të sillte natyrisht prodhim, do të sillte zhvillim, pasi ai që do ta merrte me qira do të nënkuptonte që do ta merrte për ta punuar. Dhe, vetë mundësia që ajo të bëhej pronë krijon kushte që ai që e blen të ndërtojë mbi të.

UNMIK-u asokohe ishte kundër dhe shitja filloi duke e shitur tokën me moton “Sa më lirë - sa më shpejt, nuk ka rëndësi kujt”.

Toka e ndërmarrjes bujqësore “Mirusha” u shit me 11-12 euro për ar, tokë kjo që ishte pronë e fshatarëve para viteve 1958-1959 dhe tokë për të cilën fshatarët nuk u pajtuan ta japin asnjëherë. Tani mbi këtë tokë po kalon autostrada. Kjo tokë e pëlleshme nuk mund të shfrytëzohet më, pasi mbi të është ndërtuar dhe pjesa tjetër mbetet plotësisht e ndarë, pa qasje në të. Fshatari nuk arrin tek ajo për shkak të autostradës. Pra, autostrada u ndërtua mes përmes tokës. Dhe, aty ku kaloi autostrada kjo tokë u kompensua nga shteti me 1 000 euro për ar, ndërkaq u shit për 11 euro, e kjo i bie që ai që i futi 10 000 euro, pas tre vjetësh mori 1 milion nga shteti. Ky nuk është megjithatë zhvillim. Është zhvillim i dikujt personalisht, por jo i përgjithshëm. Dhe, në fund, fshatari i shtypur mbetet sërish pa tokë, me bela në qafë për gjeneratat që vijnë.

Situatë e ngjashme është edhe në tokën e fshatrave të Rahovecit, ku ka konteste gjyqësore për tokën e shitur. Janë të shumtë nga të gjitha anët e Kosovës fshatarët e varfër, me letra nëpër duar që kërkojnë avokatë dhe duan t’u kthehet toka, bredhje e pashpresë rrugëve nga njëra zyrë në tjetrën, ca të tjerë protestojnë e shumë të tjerë mendojnë të ikin jashtë, pa shpresë për mundësinë e një jete të dinjitetshme në Kosovë.

Kjo përsëri nuk mund të quhet zhvillim. Në komunën e Kaçanikut, toka e ndërmarrjes “Mladost”, më në fund, u privatizua. Me gjithë protestat e shumta të qytetarëve, pushteti e tregoi vendosmërinë e tij për shitjen dhe e arriti një gjë të tillë. Këtu u rrit paksa çmimi në 102 euro për ar, e në anën tjetër fshatarët ankohen, protestuan, kanë edhe dokumente, ka edhe konteste gjyqësore, por megjithatë ajo u privatizua. Në kadastër, në vitin 1965 figuronte si pronë e fshatarëve të këtyre fshatrave. Madje, ka raste kur në vitin 1945, një pjesë e tokës së kësaj zone i ishte kthyer pronarit shqiptar nga koloni serb, të cilit i ishte marrë nga mbretëria serbe. Ky kthim ishte bërë me dëshirë dhe kjo dëshmon se kjo tokë i takon fshatarit shqiptar dhe i është marrë në vitin 1928, pra historia nuk fillon me vitin 1945.

Po nga vjen kjo këmbëngulje e pashoqe? Kjo këmbëngulje e pashoqe për privatizimin e kësaj toke megjithatë lidhet me idenë e ndërtimit të autostradës së re për Shkup. Pra, marifete të njëjta, për të njëjtën gjë.

Ndërsa në Suharekë është njëra nga ndërmarrjet e privatizuara, që është NBI “Suhareka”, me spin off special, ku privatizuesi nuk i ka përmbushur obligimet dhe për pasojë janë shkatërruar me qindra hektarë vreshta. E tërë teknologjia përpunuese është shkatërruar dhe është shitur. Dhe, edhe për këtë tanimë mund të themi është një mundësi më pak për zhvillim.

U tha me të drejtë se njëra nga prioritetet për zhvillim duhet të jetë bujqësia, pasi krijon mundësi për zhvillim. Fatkeqësisht, është privatizimi ai që këtë lëmi e ka hendikepuar për shumë vite.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, nënkryetar,

Unë zakonisht, kur janë shterur diskutimet, diskutimin e kam dorëzuar, por sot po e lexoj megjithatë, për të marrë kohë që opozita të mobilizohet më shumë.

Privatizimi i ndërmarrjeve publike është më se i domosdoshëm dhe madje tepër i vonuar. Shtetet socialiste të Evropës Juglindore e kanë filluar tranzicionin te ekonomia e lirë e tregut dhe me këtë edhe në procesin e privatizimit në fund të viteve të ‘80-ta dhe në fillim të viteve të ‘90-ta.

Kosova, edhe në bazë të parimeve kushtetuese, është përcaktuar për zhvillimin e një ekonomie të tregut të lirë. Në këtë kuadër, Qeveria duhet të vazhdojë me procesin e privatizimit dhe ta mbështesë rrugën e zhvillimit të një ekonomie të tregut të lirë.

Kosova, sikur shtetet tjera ish-socialiste, është shkëputur përfundimisht nga ekonomia e sistemit socialist, e cila ishte parakusht për funksionimin e sistemit socialist të pronës shtetërore.

Kompanitë publike në mbarë botën janë treguar më pak të suksesshme se kompanitë private, andaj Kosova, sikur shtetet tjera, duhet ta vazhdojë rrugën e nisur në funksion të krijimit të një sistemi demokratik dhe me ekonomi të tregut të lirë, në të cilën e vetmja mbeturinë e ish-sistemit socialist joekzistues mbeten pronat publike dhe ndërmarrjet shoqërore. Akuzat që janë bërë gjatë dy vjetëve të fundit, se Qeveria ka ecur përpara në këtë proces, pa konsultime të mjaftueshme, shpesh kanë pasur konotacione politike edhe në opinionin qytetar dhe te punëtorët janë ngrehur shumë shqetësime dhe frikë e panevojshme. Në të shumtën e rasteve, kur flitet për procesin e privatizimit, si argument i së kundërtës theksohet fakti se ky proces ka shkaktuar probleme sociale, me theks humbjen e vendeve të punës. Mirëpo, këto akuza janë hedhur poshtë me masat e ndërmarra nga Qeveria për të siguruar garanci për të punësuarit në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Pra, të gjitha garancitë janë të parapara me ligje të Republikës së Kosovës dhe sipas procedurave të parapara, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për transaksionet e privatizimit.

Qeveria e Kosovës e ka shfaqur vendosmërinë e saj për t'i privatizuar ndërmarrjet strategjike. Kjo vendosmëri duhet përkrahur dhe këtij procesi do t'i ndihmonte shumë krijimi i përkrahjes së nevojshme politike dhe publike, si dhe krijimi i një konsensusi themelor në Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i angazhuar aktivisht që ta fuqizojë pozicionin e tij në këtë proces, i cili do ta sigurojë transparencën për të mundësuar përfundimin e suksesshëm të këtij procesi dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Përfundimi i suksesshëm i privatizimit është jetik për Kosovën, andaj atij i duhet përkrahje e domosdoshme politike për këtë, e jo tensione eventuale politike dhe sociale që mund ta komprometojnë procesin dhe ta vonojnë privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe që do të shkonin direkt në favor të Serbisë, e cila që nga fillimi me çdo mjet është përpjekur ta pengojë. Sabotimi, neglizhimi dhe pengimi i procesit të privatizimit e ka vetëm një rezultat dhe ai është - shmangia nga ekonomia e lirë e tregut, e cila paraqet fundamentin e demokracive perëndimore, të cilat i aspironi ju, unë dhe çdo kosovar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në saje të mundit dhe djersës së punëtorëve shqiptarë, në ato pak vite kur regjimi pushtues e lejoi njëfarë zhvillimi relativ, Kosova arriti ta ndërtojë industrinë e vet. Kjo industri, edhe pse e pamjaftueshme krahasimisht me nivelin e zhvillimit sektorial në vende të tjera, solli pasoja pozitive për Kosovën, e rriti prodhimin, e rriti punësimin dhe kualifikimin e punëtorëve. E përmirësoi gjendjen ekonomike, si dhe solli si pasojë direkte urbanizimin dhe emancipimin kulturor në disa qendra tepër të rëndësishme për shqiptarët, historikisht po edhe sot e kësaj dite, siç janë për shembull Mitrovica, Gjakova, Gjlani e qytete tjera. Këto qytete u kthyen në qendra të industrisë. U kthyen në qendra të prodhimit, por edhe të rezistencës shqiptare, sepse nuk duhet të harrojmë që luftës çlirimtare i ka paraprirë edhe lëvizja punëtore, grevat e protestat e tyre, thirrjet për liri e për republikë, edhe pse në atë kohë nuk do ta kishin menduar kurrë që në liri do të mbeteshin të papunë, që minierat e fabrikat do të shiteshin, do të mbylleshin e do të ktheheshin në depo.

Por, falë vullnetit dogmatik të qeveritarëve për privatizimin, falë syve të mbyllur të drejtësisë, falë presionit të lobeve dhe interesave jotransparente, sot e pamendueshmja është bërë realitet. Një ndër rrjedhjat e drejtpërdrejta të privatizimit fundamentalist që po ushtrohet në Kosovë, përveç korrupsionit, përveç varfërimit, përveç moskujdesjes për efektet në jetën e punëtorëve dhe familjeve të tyre, ka qenë deindustrializimi.

Edhe pse një nga premtimet e atyre pushtetarëve ndërkombëtarë e vendorë, që e kanë mbështetur privatizimin, ka qenë thithja e investimeve të huaja që do të sillte zhvillim të ekonomisë, kjo nuk ka ndodhur as edhe në një rast. Përkundrazi, privatizimi i industrisë, i fabrikave dhe i minierave, ka sjellë shkatërrimin e tyre nëpërmjet shpërdorimit. Qëllimi i

vetëm ishte fitimi sa më i shpejtë, kështu që makineritë e fabrikave, që në disa raste ishin të reja e funksionale, janë shitur dhe ndërmarrjes i është ndërruar destinacioni.

Ky privatizim pa llogaridhënie as ndaj punëtorëve, e as ndaj qytetarëve, që ishin mbajtësit legjitimë të atyre pronave, e solli deindustrializimin.

Shkatërrimi i pronës së përbashkët të shqiptarëve, privatizimi dhe shpërdorimi, deri edhe shkatërrimi i industrive ka filluar që në vitin 1988, me Milosheviqin, mirëpo nuk u ndërpre as pas luftës, madje as pas shpalljes së pavarësisë.

Me sa duket, ky proces ekstremist dhe eksperimental, që nuk ka sjellë mirëqenie askund ku është zbatuar, do të vijojë të imponohet ndaj qytetarëve të Kosovës edhe tani, që formalisht ju, zotërinj pushtetarë, e keni zhvilluar farsën apo teatrin e përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë.

Ky proces i privatizimit irracional sjell përfitime në xhepat tuaj, sjell përfitime në xhepat e lobistëve ndërkombëtarë dhe të firmave që shesin e blejnë konsulencë, por nuk ka sjellë asnjë përfitim për qytetarin e Kosovës. Sepse, synimi juaj nuk është mirëqenia. Mirëqenia është synim afatgjatë, përfitimi është afatshkurtër, e ju të gjithë e dini se do të jeni në pushtet për një kohë shumë të shkurtër.

Është vendi të kujtohet se në vitin 1988, 48% e produktit të përgjithshëm bruto të Kosovës vinte nga industria minerale dhe ajo e përpunimit. Ndërsa sot, pasi gjiganti i përpunimit “Ferronikeli” është privatizuar, sa është kontributi i tij në ekonomi? Ky është zhvillimi që ju e premtoni? Ju doni ta ktheni krejt Kosovën në një “Ferronikel” të privatizuar, ku edhe pse punohet me tri ndërrime, edhe pse kushtet e punës dhe pagat janë tepër minimale, edhe pse investimi ka qenë pothuajse zero, pra edhe pse shfrytëzimi është maksimal, përfitimi shoqëror e shtetëror është pothuajse zero.

Vetëm në vitin 2004, ndërmarrjet shoqërore në Kosovë kanë qenë me qindra, e 75% e tyre kanë qenë ende funksionale. Ato, në vitin 2004 përfaqësonin 90% të bazës industriale dhe minierave, 50% të tregtisë dhe 20% të tokës bujqësore. E sot, ku jemi?

Për shkak të një privatizimi të çoroditur, që nuk ka bërë asnjë dallim ndërmjet aseteve me rëndësi strategjike kombëtare dhe atyre të tjerave, jemi të dënuar të mbetemi peng të mjerimit e të papunësisë.

Lejimi i deindustrializimit nëpërmjet privatizimit me edhe pa spin off është faj i drejtpërdrejtë i atyre partive që e kanë mbajtur pushtetin, edhe pse të gjitha studimet dhe realiteti i krijuar tregojnë se shumica e investitorëve nuk kanë pasur interes të drejtpërdrejtë në ndërmarrjen dhe funksionimin e saj, por thjesht e kanë dashur tokën, apo ndërtesat. Ata shumë shpejt i kanë likuiduar makineritë, i kanë shitur dhe i kanë nxjerrë në rrugë punëtorët, e i kanë dhënë fund prodhimit.

Këtu është pika ku deindustrializimi rezulton me pasoja shkatërruese për vendin, pikërisht kur punëtorët mbeten pa punë e pa shpresë për punë në të ardhmen, pikërisht kur ndalon prodhimi.

Nga ana sociale, papunësia solli zhvendosje demografike, solli varfërim të qyteteve të rëndësishme, e mjafton ta përmendim Mitrovicën. Shumë prej problemeve të ashtuquajtura të pazgjdhshme vijnë nga papunësia e mjerimi në Mitrovicë, nga ky rezultat direkt i deindustrializimit të kësaj krahine.

Po ashtu, të njëjtat probleme janë shpërndarë kudo në Kosovë, ku shumë prej rajoneve janë rrënuar demografikisht prej emigrimit të jashtëm e imigrimit të brendshëm, që tashmë po rezulton me katastrofa urbanistike e sociale.

Nga ana ekonomike, deindustrializimi dhe ndalimi i prodhimit është kontribuues direkt i bilancit tregtar të Kosovës, i cili nga viti në vit po bëhet më negativ. Kjo fatkeqësisht nënkupton që edhe punëtorët që i detyruat të shkojnë në emigrim, me paratë që dërgojnë, nuk i kontribuojnë së ardhmes së atdheut, pasi këto para shkojnë për konsum importesh.

Duket se deindustrializimi juaj na ka prodhuar një rreth vicioz, prej të cilit nuk ka rrugëdalje. Sepse, në fakt, e vetmja rrugëdalje do të ishte një qeveri që punon ndryshe nga kjo juaja, një qeveri që i shtron për diskutim politikat e veta dhe nuk punon me dogmatizëm, një qeveri që në vendimet e veta merr parasysh interesat e punëtorëve, të profesionistëve dhe të popullit, një qeveri që ka për synim mirëqenien, e që nuk heq dorë nga asetet me rëndësi strategjike, por i zhvillon ato me përkujdesje e me vizion.

Deindustrializimi ka qenë rezultati i privatizimit të egër që ju e keni bërë deri më sot. Mos e vijoni këtë politikë edhe me ato pak asete të rëndësishme që nuk janë privatizuar ende!

Dëgjojeni vullnetin e qytetarëve që e kanë nënshkruar petitionin ose përndryshe një ditë do ta dëgjoni gjykimin e tyre!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Salë Berisha-Shala!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit i nderuari kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi, Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Të gjithë këtu e theksuan se privatizimi është një nevojë e domosdoshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës në kushtet e ekonomisë së tregut dhe është dashur të ndodhë patjetër dhe duhet të përfundojë si proces sa më parë.

Nëse shikohet objektivisht, procesi i privatizimit për shoqërinë kosovare nuk paraqet polarizim të skajshëm të gjyimit apo ngërthim krejtësisht antagonist të individëve, të partive politike dhe institucioneve të Kosovës. E gjithë shoqëria në Kosovë ka qëndrim posaçërisht të njëjtë dhe nuk dallon me njësi matëse rreth kryerjes së këtij procesi, i cili do të duhej të krijonte zhvillim ekonomik për Kosovën.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është krejtësisht normale që në çdo vend në tranzicion debati për privatizim të jetë kryekëput politik, shpesh me efekte të dëmshme, efekte negative, ngase sidomos sot ishte një tentativë që në opinion të krijohet bindja se nëpërmjet këtij procesi po shitet gjithçka, madje edhe Kosova.

E përcolla me vëmendje këtë debat dhe nga ato që u thanë shpeshherë më humbi edhe vullneti të inkuadrohem për këtë proces të jashtëzakonshëm për Kosovën dhe të flas në lidhje me këtë. Është shqetësuese, sepse, si duket, ne si deputetë këtu bashkërisht e kemi shumë të dobët kujtesën. Unë po jua përkujtoj juve dhe po ua përsëris se privatizimi ka filluar në vitin 2001, që u përmend edhe nga shumë parafolës, dhe një debat për procesin e privatizimit është zhvilluar në vitin 2006, dhe ky diskutim më detyroi të shkoj e ta marr transkriptin dhe t'i shoh përafërsisht paraqitjet e deputetëve të asaj legjislature dhe pozicionimet e tyre. Madje, kjo dobësi e kujtesës do të na kushtojë shumë shtrenjtë, por duhet ta dimë shumë mirë se qytetarët e Kosovës e kanë kujtesën shumë më të fortë se ne dhe atë kujtesë do ta reflektojnë te kutitë e tyre të votimit. Le të spekulojnë çka të duan të tjerët rreth asaj, por kjo është një diçka e vërtetë.

Unë do t'i referohem transkriptit, ku njëri nga anëtarët e ish-Qeverisë, kur në koalicion ishin LDK-ja dhe AAK-ja, e lavdëron në qiell procesin e privatizimit dhe mundohet t'ua mbushë mendjen deputetëve se është kah shkon mbarë, edhe pse e ka pasur një arsye të vogël në atë kohë, sepse vendimmarrës në shumicën e rasteve ka qenë UNMIK-u.

Mua më vjen shumë keq, që gjatë përcjelljes së diskutimi pati raste kur ndonjëri nga deputetët, për të mos ia përmendur emrin dhe të mos humb kohë, tha se nuk janë jashtë procesit jashtë procesit të privatizimit, as tash, e as atëherë, Qeveria në pushtet, ndërsa harron se në atë kohë ka qenë pjesë e atij subjekti politik dhe asnjëherë nuk i dimë arsyet pse është larguar prej atij subjekti politik, për arsye se nuk ka përfituar kurrë nga ai privatizim, apo për çfarë tjetër. Mandej është shumë shqetësuese këtu kur disa nga diskutuesit dhe folësit e paraqitën, sikur më tepër tingëlloi për konsum politik dhe qytetar, për konsum të brendshëm, njëllonj ankese se kjo Qeveri nuk është në rregull, se duhet të bëjë kështu e ashtu, përderisa janë njerëz të fortë dhe bashkëpartiakë të kësaj Qeverie në pushtet. Këtu do t'ia japë vetes të drejtën ta përmend, apo apostrofoj konkretisht profesorin e nderuar, zotin Mustafa, nga subjekti politik i të cilit janë dy zëvendëskryeministra dhe është më e ndershme dhe më korrekte ne t'i japim vërejtjet te partitë tona, e këtu të mos i mundojmë shumë qytetarët dhe të mos marrim kohë shumë në foltore, duke u ankuar rreth këtyre proceseve, sepse kjo do të tingëllonte shumë keq nëse ne nuk kemi fuqi për t'i ndryshuar, atëherë pse të na besonte qytetari e të na japë prapë votën dhe të mendojë se ne do ta marrim atë fuqi me votën e tyre.

Dhe, një gjë tjetër që u spikat, e përbashkëta e shumicës së diskutuesve ishte shqetësimi për procesin e privatizimit të "Ferronikelit" dhe rrjedhat në të. Pra, ky privatizim ka ndodhur në vitin 2006 dhe po jua përkujtoj - kur në pushtet kanë qenë dy parti politike, të cilat sot janë në opozitë.

Krejt në fund, qëllimi ynë i përbashkët duhet të jetë përfundimi sa më parë i këtij procesi dhe të mos ndalemi duke e kundërshtuar njëri-tjetrin, sepse dëmi për ekonominë e Kosovës do të jetë i pariparueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muhamet Mustafa ka kërkuar replikë!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit, Më duhet të bëj replikë në diskutimin që sapo e dëgjuam. Muhamet Mustafa nuk është pjesëtar i asnjë subjekti politik. Unë jam në krye të Grupit të Ekspertëve 15. Jam pjesë e Koalicionit për Kosovë të Re dhe në atë koalicion ne kemi kontribuar për një program ekonomik, i cili me menaxhimin e keq të procesit të privatizimit është vënë seriozisht në pyetje.

Prandaj, nën një, unë këtu flas në emër të atij grupi të ekspertëve, nën dy, në emër të ndërgjegjes sime profesionale, dhe nën tre në emër të votuesve që më kanë zgjedhur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Kurtan Kajtazi, në kartelën e deputetes Xhevahire Izmaqi. A është kështu?

KURTAN KAJTAZI: Po! Faleminderit kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Procesi i privatizimit për të cilin po diskutojmë sot, duke përfshirë kornizën ligjore, është krijuar qysh para dhjetë vjetësh. Administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut e themeloi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, që të udhëheqë me procesin e privatizimit, sikur edhe me Administratën e Përgjithshme të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore në vend.

Sipas Kornizës Kushtetuese të atëhershme, menaxhimi dhe administrimi me pronën shoqërore dhe publike ishte kompetencë e rezervuar për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Bordi i AKM-së përbëhej nga 8 anëtarë, 4 prej të cilëve ishin ndërkombëtarë dhe 4 vendorë, duke përfshirë 3 ministra dhe kryetarin e Bashkimit të Sindikatave. Mirëpo, në instancë të fundit, bordi i përgjigjej direkt Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Në këtë mënyrë, shihet që AKM-ja ka qenë institucion plotësisht i pavarur nga institucionet vendore. Sidoqoftë, është e rëndësishme që të përmendet, megjithatë, se krijimi i politikave të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, si dhe procesi i tillë filloi dhe u zhvillua shumë vite para se kjo Qeveri të ishte në pushtet. Andaj, shtrohet pyetja, mbi çfarë baze adresohen sot kritikantët?

Duke marrë parasysh natyrën e komplikuar të llojeve të ndryshme të pronës, të cilat ishin trashëguar nga sistemi i kaluar në Kosovë, ishte e qartë qysh atëherë se procesi do të

kalonte nëpër sfida të shumta. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se edhe në të gjitha vendet tjera në tranzicion ky proces ka kaluar me vështirësi të shumta.

Në diskutimin e sotëm ne duhet t'i kemi parasysh specifikat e vendit tonë në atë kohë, e sidomos ato deri në shpalljen e pavarësisë. Sidoqoftë, nga pikëpamja e konceptit të zhvillimit ekonomik, procesi i privatizimit është i rëndësishëm për faktin se në Kosovë jemi duke zhvilluar sistem demokratik dhe ekonominë e tregut të lirë, prandaj si i tillë nuk ka alternativë tjetër. Kjo do të arrihet duke i respektuar parimet e ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës së lirë. Zhvillimi dhe rritja ekonomike është duke u bazuar në përkrahjen dhe mbështetjen maksimale të sektorit privat. Privatizimi gjithashtu është proces kyç në realizimin e reformave strukturore, si dhe në përforcimin e sektorit privat, si bartës kryesor i zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, privatizimin duhet parë edhe si mënyrë dhe rast shumë i mirë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe po ashtu është faktor i rëndësishëm në zhvillimin e Kosovës. Kjo gjë është theksuar edhe në dokumentet strategjike zhvillimore të institucioneve të vendit.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk duhet parë vetëm nga prizmi dhe perspektiva afatshkurtër, por në kontekst të zhvillimeve afatgjata ekonomike, si dhe në faktin se prona shoqërore, karakteristike nga sistemi i kaluar socialist, u dëshmuar tërësisht si joefikase, gjë e cila u dëshmuar në të gjitha vendet ish-socialiste në Evropë dhe më gjerë. Ndërsa privatizimi i ndërmarrjeve publike tek tani është në proces, gjë që është rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me vendimin e Kuvendit të Kosovës dhe strategjinë e Qeverisë së Kosovës për zhvillim ekonomik. Ju faleminderit!

DAUT HARADINAJ: Të nderuar përfaqësues të popullit të Kosovës, të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ne duhet ta kuptojmë kohën në të cilën jetojmë, duhet ta kuptojmë se jetojmë në një kohë të ndryshimeve të shpejta dhe që të ekzistojmë duhet edhe ne të ndryshojmë. Duhet t'i rrisim kapacitetet që të jemi në gjendje të përballemi me këto ndryshime. Le të jemi të sigurt se ose duhet të jemi në hap me ndryshimet që i sjell koha, ose duhet të mbetemi një prej shteteve më të pazhvilluara të regjionit të Ballkanit dhe të Evropës. Ideja që gjithmonë të krahasojmë kohët duke përdorur slogane bajate, monotone dhe jo kreative, "ka kaluar koha e ekonomisë së planifikuar", "qasje komuniste", që përdor Qeveria e tanishme e Kosovës, po bëhen irrituese, injorante, joproductive. Unë ia përkujtoj Qeverisë se është përgjegjëse për të gjitha lajmet e këqija që dalin nga Kosova dhe transmetohen nëpër botë.

Dhe, si parti parlamentare, ne AAK, jemi për privatizim dhe do të kontribuojmë që ky proces, edhe pas shumë mangësive, të meremetohet aq sa është e mundur, së paku në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Dhe, kontributi ynë është konkret, me këshilla konkrete se çfarë mund të bëhet tani.

Ne si AAK e kuptojmë konkurrencën politike dhe i kuptojmë qasjet e ndryshme që mund të kenë grupet politike kundrejt zhvillimeve ekonomike dhe sociale. Ne nuk jemi kundër procesit të privatizimit. Jemi për një privatizim të planifikuar mirë dhe me mendje të kthjellët. Por, nëse jemi për privatizim, nuk do të thotë se jemi që ta falim pronën e vendit

tonë. Kur jemi në gjendje t'i dalim zot vendit tonë, jemi edhe për mbrojtjen e pronës së tij. Nuk jemi për atë që vendin ta marrë nëpër këmbë injoranca.

Jemi për privatizim, sepse e dimë se duhet ta transformojmë ekonominë e Kosovës, por kurrsesi për privatizim si “pa krye”, apo për ta përdorur si mjet për arritjen e qëllimeve të ngushta dhe private të grupeve të interesit brenda Qeverisë.

Duke pasur parasysh se kemi arritur në fazën përfundimtare të privatizimit të pjesëve më të vlefshme të PTK-së;

Duke pasur parasysh se janë harxhuar para publike për privatizim, goxha para, me miliona euro të qytetarëve të varfër të Kosovës;

Duke pasur parasysh se nuk ka kohë, tani më është shpenzim i kotë i fjalëve dhe kohës për të debatuar për ekonominë dhe krizën globale financiare, thua se jemi duke e lexuar ndonjë kolumnë nga gazeta financiare dhe duke harruar se jemi Kuvend ku merren vendime;

Duke pasur parasysh se nuk mund të lejojmë që ta falim pronën e Kosovës;

Duke pasur parasysh se AAK-ja nuk e do një Kuvend, në të cilin tolerohen manovrimet, ku Qeveria përdor polarizimin për apo kundër privatizimit, pra përdor grupet politike që janë refuzuese ndaj procesit të privatizimit për kontrabandimin e asetëve të PTK-së dhe mbajtjen e debatit të mbyllur në temën kush është për dhe kush kundër privatizimit;

Duke pasur parasysh se kur duam ta shesim, nëse nuk marrim çmim të kënaqshëm, atëherë e mençur dhe e mirë është ta kthejmë mallin në shtëpi, e jo ta falim;

Duke pasur parasysh se tani më nuk ka kohë dhe hapësirë që të bëhet ndryshim i madh në procesin e privatizimit, propozojmë që:

Qeveria të vendosë çmimin minimal të shitjes së asetëve të tenderuara të VALËS. Në mungesë të kësaj, i propozojmë Qeverisë që ky çmim të jetë së paku 300 milionë euro. Ky do të ishte sinjal i mirë për qytetarët, por edhe për investitorët e jashtëm. Për qytetarët e Kosovës do të ishte shenjë e mirë se Qeveria nuk po fal gjë, e cila mund të përkthehet në vjedhje, por po bëhen politika ekonomike. Për investitorët e jashtëm, do të ishte sinjal se Kosova është vend stabil dhe serioz me politikat e veta ekonomike.

E kundërta, shitja me çfarëdo çmimi lë vend për të kuptuar se procesi ishte manipulativ dhe për përfitime të ngushta qeveritare.

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

KRYETARI: Ministër Beqaj, diskutimet kanë përfunduar! Nëse e do fjalën? Atëherë 5 minuta i ka kryetari i Grupit Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pra për fjalën përfundimtare.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E dëgjuam pra debatin sa i përket procesit të privatizimit, i cili natyrisht që u përqendrua më shumë te vazhdimi i procesit të pronës publike nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shkak se kjo është çështja me të cilën janë të preokupuar qytetarët e Kosovës.

Nga debati u vërejt se një pjesë e konsiderueshme e deputetëve ishin kategorikisht kundër këtij procesi të privatizimit, edhe pse thoshin që jemi për procesin e privatizimit në parim, por në përgjithësi e kundërshtonin këtë proces të privatizimit. Pra, kjo tregon që në fakt është e pamundur t'i dilet në krah këtij procesi të privatizimit, që po e bën Qeveria e Kosovës, natyrisht përveç këtyre që e bëjnë, dhe disa deputetëve nga partia në pushtet, që verbërisht e mbrojnë Qeverinë dhe çfarëdo që bën ajo.

Në vazhdim po e lexoj tekstin e mocionit, të cilin ne e propozojmë për votim.

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 15.8 dhe atij 52.2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, grupet parlamentare të:

Lidhjes Demokratike të Kosovës;

Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, si dhe

Grupi i deputetëve,

I rekomandojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës ta votojnë këtë mocion.

Kuvendi i Republikës së Kosovës merr vendim që procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike të pezullohet për një kohë derisa të plotësohen kushtet, si vijon:

1. Vendimi për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës të sillet në Kuvendin e Kosovës për aprovim, së bashku me një strategji lidhur me këtë privatizim, e cila i definon qartë interesat e Republikës së Kosovës në këtë aset publik dhe mënyrën se si do të përdoren mjetet nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje publike.
2. Të rishikohet strategjia energjetike e Republikës së Kosovës nga Qeveria, si dhe të sillet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aprovim, strategji kjo e cila duhet t'i definojë interesat e Kosovës në këtë sektor.
3. I gjithë aranzhmani për privatizimin e kompanisë për Distribuim dhe Furnizim të energjisë elektrike të rishqyrtohet dhe Qeveria të sjellë për këtë një propozim në Kuvend për miratim, dhe
4. Të përgatitet një strategji nacionale nga Qeveria dhe të sillet për aprovim në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me shfrytëzimin e mjeteve të mbledhura nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Pra, këto janë pikat e mocionit të cilat i propozojmë për votim dhe kërkojmë nga ju, kryetar, që këtë mocion me të gjitha këto pika së bashku, e jo pikë për pikë, ta hidhni në votim. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat mocionin e propozuar nga grupet opozitare, siç shkruan këtu, edhe pse ne nuk jemi të sigurt a është nga të gjitha grupet opozitare.

Tani ua jap fjalën shefave të grupeve. Në emër të Partisë Demokratike kryetari i Grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Meqë ne ishim për harmonizim të rekomandimeve, qoftë të opozitës, qoftë të pozitës, sepse nuk kemi të bëjmë me një çështje, e cila i takon pozitës apo opozitës, por është një problem me interes nacional dhe ne e kemi përkrahur këtë debat të bindur se do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit, në krijimin e vendeve të reja të punës, që nënkupton joshjen apo krijimin e kushteve të favorshme për investitorët e huaj.

Megjithatë, ne grupet parlamentare të Koalicionit e kemi përgatitur po ashtu një rezolutë, të cilën ua kemi dorëzuar, dhe unë po e lexoj.

1. Në harmoni me vendimet e Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës të vazhdojë implementimin e procesit të privatizimit konform standardeve dhe normave ndërkombëtare me transparencë.

2. Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, Agjencia Kosovare e Privatizimit të vazhdojë krijimin e ndërmarrjeve të reja nëpërmjet privatizimit të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, si dhe fondi i mirëbesimit të ofrohet në shfrytëzim dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

3. Konform akteve ligjore në fuqi, Kuvendi i Republikës së Kosovës të vazhdojë me monitorimin dhe kërkojmë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe nga Autoriteti Rregullativ të Telekomunikacionit mbikëqyrjen e sektorit përkatës, si dhe monitorimin e aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, ne vlerësojmë se është në dobi të zhvillimit ekonomik, të krijimit të stabilitetit politik dhe ekonomik të vendit, që ne të vazhdojmë me procesin e privatizimit, të mos biem ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me vendimet që i kemi nxjerrë para pak kohësh, dhe kërkoj nga të gjithë deputetët që të votohet ky mocion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se është njëfarë rendi, prandaj priteni rendin! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne, edhe gjatë paraqitjes së fjalës në emër të Grupit, nga zonja Sahatqija, i kishim disa propozime, të cilat pastaj u harmonizuan së bashku me grupet tjera opozitare dhe është ai

tekst, të cilin e lexoi zoti Ymeri, dhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës do t'i votojmë ato propozime, që janë katër, përkatësisht mocionin që u lexua nga zoti Ymeri. Ndërkaq e kontestoj të drejtën që këtu të hidhet tash, jashtë procedurave, një tekst tjetër dhe sigurisht se ne, pas votimit për mocionin, që është propozuar nga grupet konform rezultatit të debatit, do të japim qëndrimin tonë dhe sigurisht që do ta votojmë mocionin që u lexua, i harmonizuar nga grupet opozitare. Kurse, edhe një herë po e përsëris, nuk kanë pasur të drejtë proceduralisht ta propozojnë këtë që e bënë tash.

KRYETARI: Proceduralisht nuk keni pasur të drejtë asnjëra palë. Do të ju tregoj se pse nuk keni pasur të drejtë asnjëra palë. Unë do të jua lexoj rregullën dhe do të ju tregoj se nuk keni pasur të drejtë. Në emër të Aleancës, fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!
Sigurisht edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrahë këtë mocion, sepse jemi pjesë e harmonizimit të qëndrimeve të përbashkëta. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Duke marrë parasysh gjithë çështjen e debatit, unë edhe në fjalimin tim, në fillim të seancës, ju thashë se për çështjet madhore, apo për çështje të privatizimit duhet të ketë një konsensus. Dhe këtu, në këto rekomandime të këtij mocioni, që prapëseprapë unë jam me ju, meqë thatë se edhe kjo është jo e ligjshme, sepse është dashur në fillim të nxirret një mocion i tillë, në rast se doni një debat të tillë, atëherë vendimet, të cilat miratohen në Kuvendin e Kosovës duhet të jenë në favor të qytetarëve të Kosovës, e jo të kërkohet diçka që prapëseprapë do të vijë në Kuvend të Kosovës.

Unë nuk jam kah e kuptoj cila është esenca? Duhet të tregohet kush është fitimtar në këtë proces? Fitimtarë duhet të jenë qytetarët e Kosovës, e jo ne që jemi këtu, sepse ne jemi për ata këtu.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, kryetari i Grupit Sasha Milosavljeviq e ka fjalën!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!
SLS smatra da je proces privatizacije od velikog značaja za budućnost kosovskog društva, i mi čemo taj proces podržati da se nastavi. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 6+, kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkürler sayın Başkan,
Aynı şekilde 6+ Parlamento Grubu, özelleştirme sürecini önemli olarak bulduğu için destekleyeceğimi bildirmekteyim. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ne e kemi një rezolutë dhe një mocion, që na kanë ardhur në fund të seancës. Rezoluta nuk është mbështetur kurrkund, kurse mocioni është mbështetur në nenin 52 të Rregullores. Dhe, po ua lexoj pikën 2:

Mocioni përmbajtjesor nëse është rezolutë i dërgohet Zyrës për Propozime dhe Parashtrësia jo më vonë se 8 ditë pune para debatit në mbledhje, përveç kur është një çështje urgjente. Zyra për Propozime dhe Parashtrësia e përkthen mocionin në gjuhët zyrtare të Kuvendit, e bën redaktimin dhe ua dërgon deputetëve jo më vonë se 5 ditë pune para debatit në mbledhje.

Rezoluta nuk është përkthyer, nuk i kemi dy dokumente, prandaj kërkoj nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” t’i thërrasë kryetarët e grupeve parlamentare apo cilindo që e dërgojnë grupet parlamentare që të harmonizohet teksti, të përkthehet dhe pastaj të marrin pjesë në votim.

A jeni dakord për këtë? Po! Atëherë, mirupafshim në seancën e nesërme!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare më 4 tetor 2012

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Këtu në ekran i kemi të paraqiturit për fjalë, prandaj pyes, a jeni paraqitur për pikën e parë të rendit të ditës, apo për ndonjë çështje tjetër?

Për rend të ditës është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Ministra,
Kolegë të nderuar,
Dje e kemi pasur një debat për një çështje, lirisht mund të themi edhe jetike për perspektivën e vendit tonë. Prandaj, pas shterimit të debatit janë paraqitur një mocion dhe një rezolutë.

Dje seanca ka vendosur që sot, në fillim duhet të votohen mocioni dhe rezoluta për debatin e djeshëm. Në të kundërtën, unë kërkoj prej kryetarit që seanca le të vendosë

përsëri se a do të votohet, apo nuk do të votohet? Dhe ne nuk pranojmë që të futet asnjë pikë e rendit të ditës dhe seanca nuk do t'i zhvillojë punimet pa u votuar dhe pa përfunduar pika e djeshme, apo votimi i mocioneve të djeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dini që Kuvendi e ka një Rregullore, e ajo e përshkruan se si zhvillohet puna në Kuvend. Rregulloren nuk e ka shkruar kryetari, por e kanë votuar 2/3 e deputetëve të Kuvendit dhe ju e dini që ajo e ka edhe një nen tjetër, që mund të anashkalohet kjo rregullore, por me një votim të 2/3 të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Pa u bërë anashkalimi, këto dy rezoluta nuk mund të hyjnë në këtë rend të ditës. Lexojeni nenin 52, pika 2 e Rregullores.

Unë jam i obliguar që punën ta procedoj sipas Rregullores së Punës, e jo sipas dëshirës së asnjërit deputet, e as sipas dëshirës të një grupi parlamentar. Rregullorja është e të gjitha grupeve parlamentare.

(Ndërhyrje)

Unë jam ai që e interpretoj Rregulloren, e jo ju! Mund të hyjë në rend të ditës duke u shmangur nga Rregullorja, nga neni 84 i Rregullores.

Nëse ju votoni për të bërë shmangie, unë jam dakord. Unë jam këtu që ta respektoj Rregulloren.

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç e keni thënë dje, ne e respektojmë që kjo t'i kalojë procedurat. Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë kundër shmangies nga Rregullorja dhe nuk e votojmë, përkatësisht nuk votojmë për shmangie nga Rregullorja, nëse hidhet në votim.

E thatë dje, meqenëse sot hidhet në votim, që të respektohen procedurat, le të respektohen për atë mocion që e bëmë, prandaj ne do të votojmë kundër shmangies nga Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Edhe ne jemi kundër asaj që të shmangët Rregullorja në këtë rast. E kemi pasur rastin dje dhe po që se kemi dashur t'i shmangemi, kemi mundur dje, e pse t'i shmangemi sot për të njëjtën çështje?

Prandaj, do të votojmë kundër po që se vihet në votim.

KRYETARI: Për Aleancën, deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADA-BUJUPI: I nderuar kryetar,
Edhe ne jemi kundër shmangies nga Rregullorja dhe po ashtu do të votojmë kundër.

KRYETARI: Kryetarja e Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët,
Duke aluduar në përfundimin e djeshëm që në ditën e sotme të votohet mocioni apo rezoluta, Grupi ynë Parlamentar insiston që të hidhet në votim dhe të mos votohet çështja e anashkalimit.

KRYETARI: SLS-ja?

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!
I SLS je za to da se danas glasa za predložene rezolucije.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”, Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: “6+” parlamenter grubu da bugün oylanmasında yanadır. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Ne e hedhim në votim. Tash është fjala vetëm e grupeve. Në fakt, e kemi mocionin nga grupi parlamentar dhe nga koalicioni. Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Unë kërkoj, pas kësaj situate të krijuar, dhe po shihet qartë se këtu më tepër po tentohet të manipulohet me vullnetin dhe të luhet me emocionet e qytetarëve, se sa të debatohet dhe të diskutohet për t’i kontribuar zhvillimit apo mbarëvajtjes së punës.

Ne kemi debatuar dje për një çështje shumë të rëndësishme, një ditë të tërë, e kur vjen puna e votimit të rezolutave bëhen lojëra. Prandaj, unë në emër të Grupit Parlamentar, kërkoj një pauzë prej 10 minutash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Neni 52 i Rregullores: “Parashtrimi i mocioneve përmbajtjesore, paragrafi 2”, po e lexoj për hir të opinionit, që të mos luajmë me ndjenjat e tyre.

“Mocioni përmbajtjesor, nëse është rezolutë, i dërgohet Zyrës për Propozime dhe Parashtrës, jo më vonë se 8 ditë pune para debatit në mbledhje, përveç kur është një çështje urgjente. Zyra për Propozime dhe Parashtrës e përkthen mocionin në gjuhët zyrtare të Kuvendit, e bën redaktimin dhe ua dërgon deputetëve jo më vonë se 5 ditë pune para debatit në mbledhje”.

Kështu shkruan Rregullorja dhe unë dje e kam respektuar këtë rregullore. Kujt nuk i pëlqen, le ta ndërrojë. Do të thotë, këto çështje janë si jemi marrë vesh dhe demokracia është respektimi i procedurave për të cilat jemi marrë vesh.

E ke bërë kërkesën për 10 minuta, unë ua jap 15 minuta pauzë!

* * *

(Pas pauzës, mbledhja e vazhdoi punën.)

KRYETARI: Sekretaria e verifikon praninë. Të pranishëm janë 53 deputetë. Të pranishëm fizikisht, ngase kanë harruar t'i heqin kartelat. Ashtu janë 93. Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryetar, faleminderit!

Tash nuk po di proceduralisht si të shkojmë, se po shihet që shumica po mungon. Mirëpo ne e kemi pasur një kërkesë qysh më herët, javën e kaluar, nga Grupi i Grave Deputete. Sot fillojnë punimet e Samitit të Gruas dhe në Kosovë vijnë personalitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe besojmë që angazhimi ynë aty është i domosdoshëm, sepse veç e kemi konfirmuar pjesëmarrjen. Prandaj, kërkojmë që seanca të shtyhet për ditën e hënë, duke marrë parasysh që punimet fillojnë sot, do të jenë nesër gjatë gjithë ditës dhe të shtunë, rrjedhimisht na mbetet që të propozojmë shtyrjen e seancës për të hënë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne kërkojmë që vërtet të respektohen procedurat. Unë Rregulloren e kam këtu, po ne atë po e interpretojmë kush si të dëshirojë. Është e vërtetë se me Rregullore parashihet që mocioni duhet të dorëzohet 8 ditë para fillimit të debatit. Nuk dua të lëshohem më se çfarë shkeljesh kemi bërë. Ne kemi rënë në kundërshtim edhe me shumë ligje të tjera, të cilat i ka votuar ky Parlament, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Megjithatë, ne jemi për t'i respektuar procedurat. Do ta presim afatin e nevojshëm ligjor prej 8 ditëve, e atëherë, kur të përmbushet ky afat ligjor, ne do ta votojmë mocionin e kërkuar dhe pastaj do të procedojmë me pikat e rendit të ditës apo me seancat tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju lexojeni Rregulloren në tërësi, e interpretuesi i saj në seancë është kryetari, ose kryesuesi i seancës. Është mirë ta lexoni Rregulloren në tërësinë e saj.

Ne e kemi një kërkesë, por nuk mund të marrim vendim se 54 deputetë i kemi në sallë.

Për vazhdimin e seancës do të vendosë Kryesia të hënë. Sot mund të zhvillohet pika jashtë rendit të ditës. Ju e dini se me 40 deputetë mund ta mbajmë këtë pikë të rendit të ditës, e nëse ka të interesuar për këtë, unë mund ta bëj. Fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Për hir të korrektësisë dhe për hir të opinionit, është shumë e qartë që mungon Grupi Parlamentar i PDK-së, shumica kuptohet, pjesa dërrmuese, e ky është bojkotimi i radhës që i bën këtij Parlamenti, është hera e dytë, dhe u vërejt kërkesa që të shkelet procedura ose tentimi t'i imponohet këtij Kuvendi se si duhet të punohet. Është shumë e qartë dhe normalisht ne e çmojmë shumë këmbëngulësinë tuaj që të respektohet Rregullorja. Dhe, dje, kështu kemi vepruar, prandaj edhe kemi qenë që sot të mos shkelet Rregullorja dhe që të vazhdojë seanca.

Por, po shihet shumë qartë që Grupi Parlamentar, përkatësisht deputetët e PDK-së, por edhe të tjerët, të koalicionit, me përjashtim po them të tre kolegëve të nderuar që janë këtu, me marrëveshje shihet që e lëshuan sallën e nuk janë këtu dhe ky Kuvend nuk mund të marrë vendime të plotfuqishme, por le të dihet kjo. Dhe, kërkesa e zonjës Donika Kadaj-Bujupi mund të vijë pas kësaj, të dihet se për çka është realisht ndryshuar renditja, sepse po dihet tash që kjo seancë nuk mbahet për shkak të mospjesëmarrjes së deputetëve të koalicionit, e jo për shkak të kërkesës së zonjës Donika Kadaj-Bujupi. Kjo të dihet për opinion dhe këtu s' duhet të ketë mjegulli.

Vërtet, edhe unë po pajtohem me atë që e tha dje deputeti Limaj. T'i lëmë këto pallavra, mos t'i gënjejmë njerëzit tash se po bëhet kjo e kjo. Është shumë e qartë se sot po bojkotohet kjo punë e Kuvendit.

Ne jemi, zoti kryetar, që të vazhdojë puna në deklaratimet jashtë rendit të ditës. Për këtë nuk ka nevojë të votohet dhe ne jemi që të vazhdojë seanca. Faleminderit!

KRYETARI: “Vetëvendosja”, Visar Ymeri, kryetar i Grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm një qartësim mendoj se duhet të bëhet këtu, që u bë edhe nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kërkesa e Grupit të Grave Deputete, siç unë e kuptova, është që të ndërpritet seanca në momentin kur të fillojë samiti, që është në orën 14:00, e jo të ndërpritet tash. Ne do të mund ta vazhdonim seancën deri në atë kohë dhe atëherë ta ndërpresim seancën për shkak se do të na mungonte pastaj një grup i konsiderueshëm i deputeteve, të cilat do të merrnin pjesë në atë samit. Pra, ne do ta kishim përkrahur këtë, por në këto rrethana tash, meqenëse nuk e kemi pjesën më të madhe të deputetëve të pozitës, të cilët e lëshuan sallën, atëherë mendojmë se duhet të vazhdojmë me këto deklaratimet jashtë rendit të ditës, madje-madje konsideroj se edhe me pyetjet parlamentare do të mund të vazhdonim, nëse edhe Qeveria nuk është duke e bojkotuar seancën. Po, siç po shihet edhe ajo po e bojkoton, por ta qartësojmë edhe këtë. A është edhe Qeveria pjesë e këtij bojkoti, apo Qeveria thjesht ka përtuar të kthehet?

KRYETARI: Aleanca! Kush e do fjalën, se kryetari i Grupit Parlamentar nuk qenka këtu? Deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Normalisht se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka arsyetimin dhe beson që arsyetimi është fin dhe fisnik i Grupit të Deputeteve të Grave në Kuvendin e Kosovës, por e vërteta që duam ta themi tepër qartë dhe e kam thënë edhe një herë, sepse kjo po përsëritet: Vërtet mirë po duket Kuvendi pa PDK-në, se kjo është hera e dytë që po ndodh saktësisht e njëjta gjë.

Por, e vërteta është se Kuvendi po kthehet në një adresë të gabueshme. Për problemet tuaja të brendshme i keni adresat ku t'i adresoni, mos e ktheni edhe Kuvendin, sikurse i keni kthyer edhe institucionet tjera, në probleme të brendshme që po vazhdojnë ta futin Kosovën në rrethe tjera të krizave.

Kjo praktikë nuk është bojkot. Kjo është ikje dhe këtë qytetarët e Kosovës duhet ta dinë. PDK-ja, në këtë rast, me përjashtim të dy deputetëve të saj, ka ikur nga seanca. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse problemet, që janë shtruar në Kuvend, janë probleme të brendshme të Partisë Demokratike, unë mund të tërhiqem nga ato. Po unë po ju them juve dhe opinionit që asnjë çështje nuk e kam ngrehur për problemet e mia personale, as të brendshme. Kam ngrehur probleme në interes të qytetarëve dhe nuk është mirë që ju t'i adresoni çështjet gabimisht.

Edhe një herë po them: Nëse çështjet që i kam ngrehur dje janë çështje të mia personale dhe është interesi im personal, unë tërhiqem nga ajo që e kam thënë, por unë jam i bindur që ajo që e kam thënë është në interes, jo vetëm të të sotmes, por edhe të së ardhmes së demokracisë në Kosovë.

Prandaj, nuk është mirë t'i jepni një kah që nuk ekziston. Edhe një herë, për hir të opinionit, nuk janë çështje të interesave të ngushta. Këto janë çështje parimore për fatin e demokracisë në Kosovë. Sepse është shumë lehtë ta shohësh gabimin dhe të keqen te tjetri, është goxha burrëri për t'i parë defektet brenda vetvetes, e është mirë çdo parti politike në Kosovë t'i shohë problemet brenda vetvetes, se sa është demokratike dhe sa i respekton procedurat e demokracisë. Mendoj që këtë duhet ta shikojë çdo subjekt politik.

Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po ndiej nevojë në këtë situatë t'u drejtohem kolegëve deputetë që janë këtu, atyre që nuk janë këtu, por edhe opinionit.

Është hera e dytë brenda një kohe kaq të shkurtër, prej disa javësh, që mazhoranca e lëshon Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky është problem përtej një partie. Nuk është ky problem i Partisë Demokratike të Kosovës, por është problem i Kuvendit dhe raportit të Kuvendit me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ose të Kuvendit me mazhorancën aktuale. Se ju e patë vetë, kishte parti të vogla që janë në koalicion, që ishin këtu, dhe iu urdhërua e ikën shpejt e shpejt, e dolën nëpër dyert anësore. Ky është një diktat, zotërinj.

Kjo është një lojë e hyrjes në diktat, ku Parlamenti po bëhet servis i Ekzekutivit. Kjo është shumë më shumë se mosprania e një partie në Kuvend, e cilësdo qoftë, qoftë e mazhorancës, qoftë e asaj që quhet pakicë. Dhe, ju e dini që te ne, për shkak të sistemit zgjedhor, shumicë e votës popullore është pakica, por ne jetojmë me një Kushtetutë dhe me një sistem zgjedhor më të çuditshëm e më pa lidhje përfaqësues në botë.

Edhe një herë po kthehem: Ne kemi mbajtur mbledhje në Kryesi. Unë, në Kryesinë e Kuvendit, i kemi këtu anëtarët e Kryesisë të të gjitha grupeve dhe kryetarin Krasniqi, këtë problem e kam diskutuar gjer e gjatë në këtë formë. Dhe u jam drejtuar kolegëve të mi: “O zotërinj, nëse ju caktoni rend dite, siç është ky i sotmi, me konsensus, mos gaboni më të lëvizni në banka, siç po bëni, dhe ta ndërroni rendin e ditës në banka”, e më është thënë atje, midis tjerëve, nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe i mazhorancës: “Jo, ne më s’do ta bëjmë atë punë”. Janë letrat, janë gërmat. Shkoni, merrini, shihni! Veçse kanë pritur të zbresin poshtë dhe të bëjnë obstrukcion, i cili më nuk është obstrukcion parlamentar, është rrënim i Parlamentit. Shumica e sotme nuk ka të bëjë veç me PDK-në, mos e thjeshtësoni. Kjo ka të bëjë me të gjitha partitë që janë në mazhorancë. Ato s’duan ta bëjnë hesap më Kuvendin. Ata thonë: “E pranojmë ne Kuvendin, përderisa na shërben t’i mbulojmë vendimet me vota formale. Kur s’na shërben, ne nuk vijmë”. Ky është problemi sot në Kosovë. Kjo është hyrja në vdekjen e parlamentarizmit, që i bie hyrje në autoritarizëm. Është edhe një shprehje edhe më e fortë, unë gjithë e lë të fundit, s’po e them të parën, por të gjitha shenjat janë të këqija. Ne, ose do të kthehemi në demokraci, ose do të rrënohet ajo që është ndërtuar deri tash. Kaq! Faleminderit!

Sa për punën, le të vendosë vetë kryetari. E ka të drejtën në këtë situatë, të drejtën totale, se a të vazhdojë seanca, apo jo? Sa për mua, mund të diskutohet për pikat ku nuk kërkohet shumica e deputetëve, nëse jo, jo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, unë mendoj që sot nuk kemi kushte për punë. E vazhdojmë seancën në javën e ardhshme. Për këtë, Kryesia do të marrë vendim të hënën.

Vazhdimi i mbledhjes plenare më 11 tetor 2012

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar, Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 3 dhe 4 tetor 2012, të caktuar për sot, në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 8 tetor 2012.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 99 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Për këtë seancë, e kemi një pikë të rendit të ditës:

1. Procedimi i mocionit për procesin e privatizimit në Kosovë, i propozuar nga grupet parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të “Vetëvendosjes” dhe AAK-së, dhe i rezolutës për procesin e privatizimit në Kosovë, i propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare më 3 tetor 2012.

Në pajtim me nenin 52, pika 2 e Rregullores, mocioni për procesin e privatizimit, i propozuar nga grupet parlamentare LDK, “Vetëvendosje” dhe AAK, si dhe rezoluta për procesin e privatizimit, e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, u janë shpërndarë deputetëve më 4 tetor 2012.

Meqë këto dy dokumente janë pranuar për procedim, atëherë në pajtim me nenin 58, pika 4, të njëjtat duhet t’i hedhim në votim.

Të pranishëm janë 108 deputetë. Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

E kam një çështje, që dua ta ngre për rendin e ditës. E kam këtu Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, pran në njëfarë mënyre e kam këtu Kushtetutën procedurale dhe po e lexoj një pikë, që mendoj se i përgjigjet situatës në të cilën jemi.

Ky është neni 40, pika g), që thotë: “Pas diskutimeve, propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtësor ka të drejtë ta marrë fjalën. Kryetari i Kuvendit i mbyll diskutimet dhe kërkon deklarinimin e deputetëve për projektligjin, ose mocionin përmbajtësor”.

Në bazë të kësaj pike, kryetar, asnjë person nuk ka të drejtë tjetër të shtrojë mocion, përveç kërkuesit të debatit dhe, rrjedhimisht, kërkoj që sot të votohet vetëm mocioni, i cili është paraqitur në Kuvend nga kërkuesi i debatit, që jam unë, së bashku me deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, mocion ky të cilin e kemi dakorduar edhe me dy grupe tjera parlamentare, me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Po ashtu, në këtë legjislaturë, në këtë Kuvend, ne e kemi edhe një precedent sa i përket kësaj çështjeje. Ju kujtohet fort mirë, në kohën kur e kemi debatuar përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka paraqitur edhe një rezolutë alternative karshi asaj që ishte paraqitur nga grupe tjera, dhe ju atë nuk e keni hedhur fare në votim për shkak se jeni thirrur në Rregullore. Prandaj, unë sot insistoq që Rregullorja të përfillet në përpikëri. Është e rëndësisë jetike që kjo Rregullore dhe procedurat e saj të përfillen edhe sot dhe në vazhdim në Kuvend për shkak se në këtë mënyrë Kuvendi vetëm sa po e degradojmë tutje. Pra, është jetike që procedurat t’ia

garantojnë Kuvendit autonominë dhe lirinë nga arbitrariteti i Qeverisë dhe disa deputetëve të dyshimtë këtu që janë në përkrahje të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Ne i kemi dy dokumente. Grupi Parlamentar i PDK-së ka qenë, është dhe do të mbetet gjithnjë besnik i respektimit të procedurave, rregullave dhe ligjeve që i aprovojmë, sepse ne jemi të përcaktuar drejt dhe qartë për shtet ligjor funksional. Por, lidhur me këtë, unë e kam edhe transkriptin e mbledhjes së fundit të Kryesisë, ku është debatuar dhe është marrë vendim dhe ju e keni marrë rendin e ditës, që sot duhet të procedohen në votim dy dokumente, mocioni dhe rezoluta e Grupit Parlamentar të PDK-së, e mbështetur nga AKR, LSI dhe “6+”.

Prandaj, po ashtu duke u mbështetur në nenin 58,5, unë kërkoj nga seanca që të procedojmë më tutje dhe t’i hedhim në votim të dy dokumentet, e ai që merr shumicën e votave është legjitim dhe vazhdojmë tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën, replikë.

VISAR YMERI: Kryetar!

Së pari, në pikën së cilës iu referova unë, pra në nenin 40 thuhet “mocioni”, e jo “mocionet”, që nënkupton se nga një debat parlamentar sipas kësaj pike nuk mund t’i kemi dy mocione, ose dy rezoluta. Mund ta kemi një dhe atë, siç thuhet në Rregullore, e shtron propozuesi. Natyrisht që të tjerët kanë të drejtë të marrin pjesë në modifikimin dhe amendamentimin e rezolutës, mirëpo është e drejtë e propozuesit të debatit ta hedhë dokumentin në fund në votim dhe të kërkojë nga deputetët që t’i marrë votat.

E dyta, çfarë kemi këtu sot, çfarë dëgjuam nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së është që ta shkelim Rregulloren, duke u bazuar në transkriptin e mbledhjes së Kryesisë. Rregullorja, duhet ta dimë të gjithë, është mbi transkriptin e mbledhjes së Kryesisë. Është dokument i cili e definon punën tonë në Kuvend dhe është dokument ekskluziv që merret me këtë çështje.

Prandaj, rregullorja është e nivelit ligjor juridik, më lart se transkripti i mbledhjes dhe më lart se vendimet e Kryesisë së Kuvendit. Rrjedhimisht, unë prapë insisto që kjo pikë të respektohet në përpikëri, ta votojmë vetëm mocionin e propozuesit të debatit. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci përsëri!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Jemi në shekullin XXI dhe demagogjia nuk zë vend. Vërtet, kjo që po kërkohet sot sikur të ishte paraqitur me kohë, do të ishte votuar vetëm rekomandimi a mocioni i propozuesit.

Meqë kjo nuk ka ndodhur, merreni lexojeni rregulloren edhe një herë dhe kuptojeni qartë - tetë ditë para debatit është dashur të paraqiten rekomandimet apo mocioni. Prandaj, atë ditë nuk ka pasur. Prej seancës kanë dalë, e të drejtë propozimi kanë të gjitha grupet parlamentare. Këtu janë paraqitur dy dokumente. Ne kemi bërë përpjekje dhe kemi qenë të gatshëm t'i harmonizojmë dhe të dalim me një qëndrim. Kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, ne kërkojmë që këto dy dokumente të hidhen në votim dhe të vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Grupet tjera, nuk doni të prononcoheni?

(Ndërhyrje - reagim)

Shikoni, ne nuk jemi të obliguar, as si deputetë, të vrapojmë pas shtypit të verdhë në Kosovë dhe duhet ta presim sistemin e drejtësisë. Ju e dini shumë mirë që shtypi ynë është ashtu siç është, dhe është mjerim. Ndoshta më mjerim se sa jemi ne këtu brenda. Prandaj, të mos merremi me shtypin, po me diçka tjetër.

Ju lutem, ne nuk jemi as prokurori, as hetuesi, as gjyqësi. Ai është një sistem tjetër. Kush ka çka të dëshmojë, le të shkojë të dëshmojë.

E vërteta është se ne kemi diskutuar për kërkesën e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe kemi diskutuar për privatizimin mbi bazën e asaj kërkesë. Për rezolutën nuk kemi diskutuar. Kryesia në mbledhjen e vet u ka dhënë hapësirë të dy dokumenteve. Edhe propozimit të Grupit të “Vetëvendosjes”, të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, edhe rezolutës së propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Unë nuk di nëse është në praktikën parlamentare që prej një kërkesë të një grupi parlamentar apo një debati, të dalin dy dokumente. Neni 40 e thotë atë që e thotë, por propozuesi nuk e ka bërë kërkesën sipas rregullës 52, pika 2. Kryesia ka vendosur për këtë rend dite për këtë seancë. Dhe, realisht jemi në dilemë... Por, megjithatë, ne po shkojmë sipas rendit të ditës. Vota është ajo që e përcakton. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

E mora fjalën për procedurë.

Është e vërtetë që çështjen e debatit, të interpelancës, ne nuk e kemi përpunuar sa duhet dhe praktika jonë është e mangët. Pa u kthyer në ato që konstatuat ju, debati mund edhe të përfundojë me një akt, mund edhe të mbetet pa një akt, varet prej propozuesit. Por, një mangësi në debatin që e kemi pasur edhe herën e fundit, edhe më parë, është kur paraqitet një akt, një rezolutë, një përfundim, një vendim, një deklaratë, praktikohet që vërejtjet e deputetëve, sidomos kur janë amendamente, të diskutohen dhe të inkorporohen në ato që konsiderohen se janë të pranueshme. Dhe, në këtë mënyrë arrihet harmonizimi i qëndrimeve, ose bëhet një grup punues, ose bëhet një tentativë, që më vonë qëndrimet të harmonizohen.

Në praktikën tonë, kjo ka munguar. Prandaj, edhe deputetët, jam i sigurt, janë në vështirësi si të votojnë. Ka ndonjë pikë, të cilën e votojnë te një dokument, ka një pikë tjetër, që është e votueshme te dokumenti tjetër. Në rast të harmonizimit, ata s'do ta kishin këtë vështirësi. Unë e kam këtë dilemë, prandaj edhe dua ta deklaroj së pari votën time. Në raste të tilla, unë s'mund të votoj dhe detyrohem ta zgjedh variantin më të keq, abstenimin.

Nuk ia sugjeroj askujt, por kam propozuar gjatë debatit, po propozoj edhe tani, që të krijojmë mekanizma, që në raste të tilla t'i shterojmë mundësitë për t'i përafuar qëndrimet, për t'i harmonizuar qëndrimet së paku për çështjet për të cilat kemi qëndrim të përbashkët.

Unë jam i bindur që për shumicën dërmuese të materies ka bazë për harmonizimin e qëndrimeve. Po të shtrohej çështja, ta zëmë në komisionin përkatës, për mendimin tim, do të duhej të ishte një komision i posaçëm për çështjen e privatizimit, se është një çështje e rëndësisë së veçantë, e ky ka qenë propozimi im, atëherë çështjen do t'ia bartnim komisionit dhe atje, pa politizim, pa ndikimin e medieeve, e tjera, do të mund të provohej dhe, jam i bindur, do të arrihej që të ndërtohej një konsensus. Na duhet një qasje e tillë, që ndërton konsensus.

Unë, prandaj, do të propozoja, meqë çështja nuk është e sqaruar, nuk është provuar të ndërtohet, të provohet edhe një herë që të harmonizohen qëndrimet dhe ne të dalim me një qëndrim unik. Besoj, që do të ishte në të mirë edhe të procesit të përgjithshëm, edhe të funksionimit të këtij trupi. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Urdhëro! Fjalën e ka zëvendëskryeministri Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!
Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,
Të nderuar deputetë,
Besoj, nëse mund të ndihmoj me një sqarim.

Sqarimi kryesor besoj që të gjithë ne që e lexojmë Rregulloren del kështu: propozuesi i debatit, në cilindo rast, duhet të bashkëngjitë, përveç kërkesës dhe arsyetimit, edhe mocionin. Dhe, në atë rast do të ishte debatuese dhe do të ishte në fund të atij debati, ose të përplotësohet, ose të ndryshohet, ose të votohet kundër.

Në rastin konkret, të dyja, edhe mocioni edhe rezoluta, e kanë bazën e njëjtë juridike. Janë propozuar në të njëjtën ditë, janë propozuar në të njëjtën kohë dhe e kanë plotësuar afatin kohor prej 5 ditë punësh, apo tetë ditëve të javës. Dhe, mendoj që në këtë rast, ose duhet që ai debat të përfundojë fare pa rezolutë, pa mocion, ose duhet të vihen sot në votim të dyja se janë të njëjta dhe të barabarta. Faleminderit!

KRYETARI: Visar, e ke fjalën.

VISAR YMERI: Kryetar!

Kjo që tha zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë nuk qëndron fare, për shkak se në Rregullore shumë qartë përcaktohet se kush ka të drejtë në debat që të sjellë mocion. Po pajtohemi që ka të drejtë propozuesi i debatit të mos sjellë mocion fare dhe të përfundojë debatin pa mocion, mirëpo kur e sjell propozuesi, ai do të jetë mocion i votuar. Pra, ose votohet, ose nuk votohet. Natyrisht, askush nuk mund të paragjykojë se si do të votojë seanca për një mocion të caktuar, mirëpo nuk ka kurrkush të drejtë tjetër, po e përsëris, sipas Rregullores, që asnjë grup apo deputet tjetër, të sjellë një mocion tjetër në një debat, të cilin nuk e ka ftuar vetë. Ka të drejtë Grupi Parlamentar i PDK-së, natyrisht, ta thërrasë një debat tjetër për privatizimin dhe aty ta paraqesë një rezolutë çfarëdo, që këtyre ua merr mendja që duhet të votohet dhe ta kërkojnë votën e deputetëve. Kjo e drejtë nuk i mohohet askujt. Mirëpo, në këtë rast, këta nuk kanë të drejtë sipas Rregullores.

Po e përsëris, secili që po i referohet Rregullores, duhet ta lexojë atë me vëmendje.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, replikë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Ymeri! Besoj që po e lexoni pjesën e Rregullores, që ka të bëjë vetëm me debatin, dhe aty keni të drejtë. Por, Rregullorja duhet të lexohet në tërësi. Lexojeni aty ku flet për mocionin. Dhe, thotë: mocioni duhet të dorëzohet 5 ditë. A është ashtu? E, ju nuk e keni dorëzuar. Dhe, ditën që ka filluar debati, shikoni, ju e realisht e keni filluar atë pa mocion. Dhe, atë ditë rezultati i fundit, edhe për ju, edhe për tërë të tjerët, janë dy propozime, dhe tani është procedurë krejt e re. Ju e keni pasur një mungesë të juristëve, se juristët e mirë është dashur të ju mësojnë juve, të ju thonë 'bashkëngjitjani mocionin' dhe ne pastaj kishim diskutuar mbi bazën e tij.

Rregullorja dhe ligji nuk lexohen si filmat ose romanet, veç parathënia ose pasthënia. Duhet lexuar krejt nenet. Lexoje nenin për mocionin, e sheh që nuk e ke respektuar procedurën.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Deputeti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryetar!

Veç sa për t'i kontribuar debatit për sqarime të mëtutjeshme.

Mendoj që sa i përket kësaj që e tha zoti zëvendëskryeministër, sa u përket të dy kërkesave, të dy mocioneve - ajo jona është shtyrë pikërisht për shkak të asaj që e tha zëvendëskryeministri, në rregull paska qenë e paligjshme, mirëpo është shty në afatin kohor, që të bëhet e ligjshme. Kjo është shumë e rëndësishme. Pra, është shtyrë që të kalojnë aq ditë sa për t'u bërë e ligjshme. Kurse, dallimi me mocionin tjetër është që prej

fillimit, edhe me të gjitha ditët që kanë kaluar, prej fillimit është i paligjshëm dhe në kundërshtim me Rregulloren.

Ky është argumentimi juridik, që po mundohemi ta shpjegojmë ne dhe mbi këtë bazë mendoj se duhet të debatohet.

Ky po mundohet t'i barazojë të dyja për nga ditët dhe t'ua heqë legjitimitetin të dyjave. Mirëpo, unë mendoj se 5 ditët kanë kaluar për të dyja mocionet, por i tyre prej fillimi nuk ka qenë në përputhje me Rregulloren.

Tash, nëse duam të vendosim diçka kundër Rregullores, atëherë unë po them se ajo është antikushtetuese.

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Konjufca, keni të drejtë kur thoni se atë ditë e keni propozuar pa ligjshëm, dhe mirë që po e pranoni.

Por, ajo çka dua të them - një fakt, shikojeni dhe lexojeni Rregulloren. Rregullorja thotë “çdo grup parlamentar ose numri i caktuar i deputetëve ka të drejtë të propozojë mocione ose rezoluta”, dhe nuk është me rëndësi koha.

Shikoni, Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar një rezolutë dhe e ka vënë në Kryesi të Kuvendit, ajo e ka miratuar dhe e ka futur në rend dite.

Absolutisht, edhe nga fuqia juridike, si e juaja, si e jona, është e njëjtë. Ju e keni humbur atë ditë afatin. Sot, ose duhet të vihen të dyja, ose asnjëra.

KRYTARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë konsideroj se ky debat u zgjat shumë tepër, për shkak se jemi kapur për një çështje që nuk ishte dashur fort të orientohemi sot. Është pra çështja e procedurave.

Nëse e analizojmë përmbajtjen, mendoj se problemi do të thjeshtësohej shumë.

Ne e kemi një mocion dhe rezolutë. Rezoluta e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës thotë gjithmonë - “të vazhdojë, të vazhdojë, të vazhdojë”. Do të thotë, i ngarkon institucionet ta vazhdojnë faktikisht atë që e kanë bërë deri sot. E kjo është të mbahet gjendja e pandryshueshme. Mirë apo keq, nuk po e paragjykoj. Por, thjesht, qëndrimi është ky.

Mocioni i opozitës, po e thjeshtësoj, është për ta ndryshuar këtë gjendje. Prandaj, unë mendoj se ky Kuvend duhet të votojë - a do ta ndryshojë këtë gjendje nga kjo si është, apo jo. Dhe, në këtë rast, votohet mocioni i opozitës, e edhe nëse nuk kalon, atëherë po

pajtohemi që të jetë kjo gjendje dhe faktikisht shkon rezoluta e PDK-së. Sepse, në rezolutë thuhet çdo institucion ta vazhdojë punën që e ka bërë deri më sot. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Po e hedhim në votim mocionin e “Vetëvendosjes”. Realisht, rezoluta nuk ka nevojë të votohet, sepse nëse nuk fiton e para, s’ka pse të votohet e dyta.

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 45 vota për, 53 kundër dhe 3 abstenime, nuk miratohet mocioni i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Me këtë po e përfundojmë seancën e sotme dhe mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë